


LIBËR ISLAM

PËRMBLEDHJE  
TREGIMESH  
ISLAME

 LIBRI 1

[www.islamieshtedrit.com](http://www.islamieshtedrit.com)

Ilaz & Merjem Salihi



## Reth Librit

### **Titulli I Librit:**

Përmbledhje Tregimesh Islame Pjesa 1

### **Përgatitën:**

Ilaz dhe Merjem Salih

### **Materialet marur nga:**

Forumi Islamieshtedrit Rubrika Tregime islame

### **Përgatitja Kompjuterike:**

Ilaz Salih

Ndalohet kopjimi,botimi I këtij libri për përfitime material.

Të drejtat e rezervuara vetëm për:

[www.islamieshtedrit.com](http://www.islamieshtedrit.com)

## PËRMBAJTJA

1. Këshillat e Bilbilit.....	5
2. Uji i Parajsës.....	7
3. Voglushja dhe televizori.....	8
4. I kaloi namazi, e ndëshkoi veten dhe fitoi.....	9
5. Shoku i vërtetë.....	10
6. Lutësi në Haremin e Qabes.....	12
7. Tregim i cuditshëm rreth Imam Malikut.....	13
8. Krishteri dhe Muslimani.....	14
9. Më varosni me çërape.....	15
10. Djaloshi që mësoi atë që nuk mund të mësohej.....	16
11. Egoisti.....	17
12. A është bërë padrejtësi?.....	18
13. Je i devotshëm provohesh por prap gëzohesh.....	19
14. Dita e Pendimtarëve.....	21
15. Përfitoi nga Duaja e Babait.....	24
16. Selim ibën Abdullahu dhe Kalifi.....	25
17. Ah, sikur të mos martohesha.....	26
18. E ke parë Zotin?.....	30
19. Si e mposhti dijetari (sunnit) dijetarët shi'itë ?.....	32
20. Dhurimi pa kufi.....	33
21. Mjekësia nuk e shëroi por u shërua.....	35
22. Nxënësi që lexonte tërë Kuranin për çdo natë.....	36
23. Plaku i mençur.....	37
24. Një djal i vogël pyet Plakun: Cila është gjëja më e fortë në botë?.....	38
25. Boshllëku-Humbja e zemrës.....	39
26. Tregtari musliman dhe blerësi hebre.....	40
27. Floriri është vetëm për shëmtaraqet!.....	41
28. Nuk do të vije në xhami?.....	42
29. Berberi i devotshëm dhe humbesi i kuletres.....	43
30. Fëmiju I lindur në varr.....	44
31. Shërimi i Shpirtit.....	45
32. Sëmundja e zemrës dhe lëmosha.....	46
33. Njeriun të cilin Pejgamberi s.a.v.s. e përgëzoi me Xhennet përmes ëndrrës.....	48
34. Drita e Udhëzimit.....	50
35. Kush e blen Nënë time?.....	52
36. Malik bin Dinar në treg.....	53
37. Amaneti i mbretit.....	54
38. Hoxhën e devotshëm që nuk mundi ta prishë shejtani e prishi një grua!.....	55
39. Dijetari dhe student.....	58

40. Pse qante Enes ibn Maliku?!	59
41. Qëndrim i veçantë.....	60
42. Hoxha dhe papagalli.....	61
43. Plaku i urtë dhe udhëtarët e trenit.....	62
44. Plaku dhe djali i tij i burgosur.....	65
45. Ekstremisti dhe Dijetari.....	66
46. Mbreti dhe veziri (këshilltari).....	67
47. Ateisti “besimtar.....	68
48. Voglushi me te meta por i lumtur!.....	69
49. Blersja me nikab dhe kasierja në supermarket.....	70
50. Mbështetja e sinqertë në Allahun e madhëruar.....	71
51. Burri im ke frikë Allahun!.....	72
52. Tre vajzat dhe njeriu i cili pa ëndër babain e tyre duke u dënuar!!.....	73
53. Si ti kuptoj gjuhët e kafshve pyet një njeri Musën a.s?!.....	76
54. Mbreti dhe piktori.....	78
55. Biseda telefonike.....	79
56. Shko N’Xhehenem Aty S’ka Musliman.....	80
57. Djaloshi i pasur!.....	81
58. Prej kishës në xhami dhe prej xhamisë në varr!.....	82
59. Droga m'a shkatërroi jetën.....	83
60. Zoti na ruajt nga më e keqja.....	86
61. Femi i Parisit.....	87
62. Besa e myslimanit.....	88
63. Mbreti që i takojë lëmosha!.....	92
64. Tregimi i gruas që vdiq në sexhde.....	94
65. Biri keqbërës.....	95
66. Fëmiu dhe beriberi.....	96
67. Imami (hoxha) dhe Emiri (udhëheqësi).....	97
68. Xhamia që kushtojë një pikë uji.....	98
69. Ai është Pranë nesh mbështetju Atij.....	100
70. Dhurata e bukur e maturantit.....	102
71. Rreze drite në errësirën e shpellës.....	103
72. Milingona, Bretkosa Dhe Sulejmani Alejhi Selam.....	104
73. Një tregim i bukur me engjullin e vdekjes!.....	105
74. Përgojimi – thashethemet.....	106
75. Pikë për pike.....	107

## Tregim Tri këshillat e bilbilit



Një gjuetar kishte kurdisur një kurth dhe e kishte kapur një bilbil. Sapo e mori bilbilin në grusht, bilbili filloi të flasë dhe i tha gjuetarit:

“O gjuetar, ti qe sa kohë ke ngrënë dele e qengja. Nuk je ngopur me to dhe do të ngopesh me mishin tim që nuk bën as tri kurush? Të lutem, liromë se do të jap nja tri këshilla të mira për këtë nder. Njërën prej këtyre këshillave do ta them në grushtin tënd, të dytën në çatinë karshi dhe të tretën në drurin pranë”.

Gjuetari u pajtua dhe i tha: “Si urdhëron...”

Bilbili ia dha këshillën e parë: “Mos i beso asaj që nuk bëhet, kushdo që ta thotë atë!”.

Gjuetari, për ta dëgjuar këshillën e dytë, e liroi bilbilin. Ai hipi mbi çati dhe ia tha edhe këshillën e dytë: “Mos u mërzit për gjërat që të kanë kaluar. Mos u dëshpëro për rastin që të ka ikur. Dija vlerën kohës në të cilën jeton. Mos humb kohë duke u penduar...”

Pastaj shtoi:

“O gjuetar, në barkun tim kam një inxhi (perlë) që kushton 100 lira. Këto do të kishin mjaftuar për ty dhe për pasardhësit tu. Sa keq, e humbe rastin... Paska qenë kësmet për dikë tjetër... Në botë nuk ka perlë tjetër sikurse kjo”.

Gjuetari filloi të dëshpërohej e të qajë duke thënë: “Ahh! Çfarë bëra unë që të lirova?”

Atëherë bilbili ia ktheu: “More zotëri, pse po qan e mërzitësh? A nuk të këshillova të mos mërzitësh për gjërat që të kanë kaluar e të mos dëshpërohesh për rastin që të ka ikur? Pastaj, a nuk të thashë të mos i besoje asaj që nuk bëhet dot, kushdo që ta thotë? Unë vetë nuk bëj tri kurush, e si paska mundësi që në barkun tim të ketë një perlë prej 100 lirash?”

Gjuetari u mbush mend. Iu drejtua bilbilit të mençur që i rrinte karshi dhe sikur po tallej me të: “Mirë, po ç’ ishte këshilla jote e tretë? Thuama këtë dhe pastaj ik..!”

Bilbili e tejkaloi murin dhe u ul në dru. Me një gjuhë tallëse iu drejtua gjuetarit: “Pasha Zotin, ti i mbajte dy këshillat e para dhe të mbeti e treta pa e mbajtur? Lëre këtë punë, mos ma merr kohën...” – dhe fluturoi lart e lart i lirë.

Gjuetari mbeti i shtangur nga kjo që i ndodhi.

## Uji i Parajsës



Përgjatë jetës së tyre prej nomadësh, Harith Beduini dhe gruaja e tij Nafisa e ngulnin çadrën e tyre të mjerë aty ku mund të gjenin ndonjë palmë hurmash, ndonjë degë të thatë për gamilen e tyre, apo ndonjë pellg uji të njelmët.

Kishte vite të tëra që bënë një jetë të tillë, e çdo ditë, Harithi kryente të njejtat veprime: nëpërmjet kurtheve, zinte minj shkretëtire për t'u marrë lëkurën, të cilën e ndërthurte me fijet e palmave, bënte litarë, dhe ua shiste karvaneve që kalonin andej.

Një ditë, gjithsesi, ai pa të teptiste nga rëra e shkretëtirës një burim. Harithi e ngjoi ujin me buzë dhe iu duk si ujë parajse. Ai ujë, që ne do ta gjykonim si tmerësisht të njelmët, ishte në të vërtetë shumë më I ëmbël se uji që ai ish mësuar të pinte. Është e domosdoshme t'ia jap taprovjë ndokujë që ia di vlerën”, tha me vete Harithi.

Kështu, u përudh rrugës që e çonte në Bagdad, drejt e tek pallati I kalifit Harun El-Rashid, duke u ndlaur vetëm për të përtypur ndonjë hurmë. Kishte marrë me vete dy shakuj me ujë: njërin për vete, kurse tjetrin për kalifin.

Mbas disa ditësh udhëtimi, Harith Beduini arriti në Bagdad dhe shkoi fill e te palallti. Rojet e dëgjuan rrëfimin e tij, dhe duke mos ditur ç' të bënin tjetër ky ishte zakoni e çuan në sallën e pritjes së njerëzve, ku gjendej kalifi.

-Prijësi I besimtarëve, tha Harithi, unë jam një beduin I varfër dhe i njoh të gjithë llojet e ujrave të shkretëtirës, paçka se prej gjërave tjera marr vesh shumë pak. Sapo kam zbuluar këtë Ujë Parajse, dhe menjëherë mendova të ta sjell, sepse, në të vërtetë, është një dhuratë e denjë për ju. Haruni, I Sinqerti, ngjëroi ujin e , meqë dinte t' I kuptonte nënshtetasit e tij, I urdhëroi oborrtarët ta rehatonin beduinin në pallat, e ta mbanin aty derisa ai, kalifi, të merrte një vendim lidhur me këtë çështje. Mandej thirri kapitenin e rojeve, dhe I tha:

-Ajo çka për ne është asgjë, për atë është gjithçka. Në të error, shoqërojeni jashtë pallatit. Kini kujdes që të mos e shoh lumin e fuqishëm Tigër; shoqërojeni deri tek çadra e tij, dhe mos e lejoni të pijë ujë të ëmbël. Mandej jepni njëmijë monedha ari, bashkë me falenderimet e mijapër shërbimet e tij. I thoni se e kam emëruar roje të Ujit të Parajsës, e se këndeje e mrapa duhet t'u ofrojë të pijnë ujë në emrin tim të gjithë udhëtarëve që do kalojnë aty.

Ky rëfim titullohet edhe: “Historia e dy botëve”. Është rrëfyer nga Abu El-Atahijja, I fisit Aniu, bashkëkohor me Harun El-Rashid. El-Atahiyya është quajtur “babai I poezisë së shenjtë arabe”. Vdiq në vitin 828.

### **Vogëlushja dhe televizori**



Pasi e vëren se televizioni i shtëpisë nuk punon, zonja e shtëpisë e thirr mjeshttrin për ta rregulluar.

Mjeshtri vjen ne shtëpi dhe e hap televizionin, brenda tij gjen copa buke. Menjëherë e kuptuan se kush e kishte bërë, nuk mund te ishte dikush tjetër pos vajzës së vetme katër vjeçare.

Para se ta qortoj, zonja e shtëpisë vendos ta dëgjoj vogëlushen pse e kishte bërë këtë gjest. Pasi e kuptoi shkakun, e shtrëngoi fort dhe filloi të qaj.

Vogëlushja në televizion kishte shikuar një emision dokumentar me fëmijët e Afrikës. Ende pa mbaruar, ajo kishte marrë disa copa buke dhe i kishte futur nëpër vrimat e televizionit, për ti ushqyer fëmijët e uritur.



## I kaloi namazi, e ndëshkoi veten dhe fitoi



Një grua kujdesej shumë që ta falte rregullisht namazin, porse një ditë prej ditësh i kaloi namazi pa dëshirën e saj.

U brengos aq shumë, sa që filloi të ndiejë dhimbje dhe shtrëngim në zemër nga merak. Nga pikëllimi i madh që ndiente që i kaloi ky ritual madhështor vendosi ta ndëshkojë veten. Kështu që, vendosi të qëndrojë mbi sexhaden e saj gjatë gjithë ditës. Kur shkoi burri i saj në punë e la atë të përulur në faltoren e saj. Kur u kthye nga puna e gjeti sërish në të njëjtin vend duke qarë dhe duke u lutur. Atëherë, bashkëshorti i saj ra për të pushuar, por edhe pasi u zgjua gruaja e tij ende qëndronte në po atë vend, pa lëvizur fare, e frikësuar dhe e përulur para Zotit të saj!

Pas namazit të akshamit, bashkëshorti i saj e puthi dhe e përqafoi fort gruan e tij dhe tha me zë të lartë:

"Për Zotin, kurrë nuk do të shkoj më tek ajo!"

"Për Zotin, kurrë nuk do të shkoj më tek ajo!"

Burri e kishte fejuar një grua tjetër pa dijen e kësaj (të parës) dhe kishte vendosur që po atë ditë të bënte kurorë me të, por kur e pa sa shumë po vuante gruaja e tij mendoi se ajo po e bënte këtë gjë për shkak të mërziisë që burri i saj po martohej edhe me një grua tjetër. Kështu që, atij iu zbut zemra dhe u betua se kurrë nuk do të martohej edhe me ndonjë grua tjetër!

Kur e dëgjoi këtë ngjarja, gruaja u çudit tej mase!

Atëherë mu kujtua hadithi i të Dërguarit të Allahut: *"Kushdo që e ka dert ahiretin (botën e përtejme), Allahu do t'ia zgjedhë problemet e kësaj dunjaje dhe do t'i japë pasuri në zemër, kështu që kurrë nuk do të shohë varfëri dhe do t'i vijë dunjaja, të cilën Allahu i Madhërishëm ia ka shkruar."* (Hadith Sahih)

Namazi është shtylla e fesë, pa të nuk bën kurrsesi!

Sa të nevojshëm jemi që zemrat tona t'i ujisim me iman-besim.

Vallahi, po t'i mbushnim zemrat tona me dashuri ndaj Allahut, kurrë nuk do ta braktisnim Atë e as që do të shqetësoheshim nga brengat!

Fillimi i përmirësimit tonë duhet të bëhet në këtë mënyrë: Përmirësimi i gjendjes sonë me Namaz, meqë ne kemi nevojë për frikërespekt ndaj Allahut, duke medituuar Kur'anin dhe duke

vlerësuar të drejtat e Allahut.

**O Zoti im, më bëj mua dhe pasardhësit e mi prej atyre që e falin namazin.** (Ibrahim 40)

## SHOKU I VËRTETË



Na ishin një herë nja dy shokë. Njëri ishte i ngathët, i drejtë dhe i qetë, kurse tjetri shumë i shkathtë, i zgjuar dhe i lëvizshëm. Një ditë ky i shkathtëti shkon te shoku i vet dhe i thotë se ka probleme në punë dhe lyp prej tij para. Shoku i sinqertë nuk ia prish dëshirën dhe pa një pa dy ia jep të gjitha paratë që kishte. Ky i merr paratë dhe e rregullon situatën e vet. Pas një kohe, i shkathtëti vjen sërish te shoku i vet dhe i thotë që të hiqte dorë nga vajza me të cilën ai ishte i fejuar dhe priste martesën, duke i thënë se ky e donte shumë këtë vajzë, pra të fejuarën e shokut të vet. Shoku u habit tej mase. Nuk dinte çfarë t'i thoshte. Mirëpo, midis tyre ekzistonte një dashuri aq e madhe dhe e fuqishme, saqë nuk mund t'i thoshte shokut “Jo”. Si pasojë ky heq dorë nga e fejuara.

Me kalimin e kohës, këtij të ngathëtit nuk i shkojnë punët mbarë dhe përnjëherë i vjen ndërmend shoku i vet. Shkon te vendi i punës së shokut duke menduar se do t'i ndihmonte pasi që edhe ky i kishte ndihmuar atij kur ai kishte qenë ngushtë. Kërkon prej tij që t'i gjente vend pune në punëtorinë e vet, mirëpo ai nuk i gjeti dot. Kthehet prapë i mbushur plot dëshpërim e pendesë. Mirëpo, prapë, nuk mund të zemërohej me shokun që kishte.

Një ditë, duke ecur rrugës, atij i afrohet një plak i sëmurë. I thotë djaloshit se ishte i varfër dhe se nuk mund t'i blinte ilaçet. Djaloshit i dhimbet fort plaku, shkon ia blen ilaçet, e çon në shtëpinë e vet, e shtrinë në shtrat për t'u qetësuar dhe vazhdojnë të bisedojnë për një kohë... Pas disa ditësh djaloshi merr vesh se plaku kishte ndërruar jetë... Plaku kishte qenë shumë i pasur dhe gjithë mallin e tij ia kishte lënë trashëgim djaloshit të ngathët.

Ky i ngathëti, me pasurinë që i kishte lënë plaku, dhe paksa me zemër të thyer ndaj shokut të vet, shkon dhe blenë një shtëpi karshi punëtorisë së tij... Një ditë, vjen një lypëse plakë dhe i troket derës së djaloshit. Plaka i thotë se është shumë e uritur dhe kërkon prej djaloshit t'i jepte diçka për të ngrënë. Djaloshi, pa menduar fare, e merr plakën brenda dhe ia ngop barkun me ushqim të ngrohtë. Ky dëgjon prej saj se ajo ishte e vetme, ndaj i thotë se edhe ky ishte i vetmuar fare. I thotë plakës që nëse ajo donte, mund të rrinte bashkë me të, t'i bënte punët e shtëpisë dhe të përgatiste ushqimin... Gruaja plakë, pa menduar fare, e pranon menjëherë propozimin e djaloshit.

Pas një kohe, plaka i drejtohet djaloshit të ngathët duke i thënë se duhej të gjente një vajzë të

përshtatshme dhe të martohet me të. Djaloshi i thotë se nuk dinte si ta gjente dhe nuk dinte a kishte dot ndonjë të tillë. Plaka i thotë se ajo e njihte një dhe se nëse ky donte mund ta takonte me të... Dhe pas shumë takimesh me vajzën, këta dy të rinjtë vendosin të martohen. I përgatisin dhe i shpërndajnë ftesat për dasmë... Djaloshi edhe pse me zemër të thyer, përsëri nuk kishte mund ta harronte shokun e vet të ngushtë. Andaj edhe atij i dërgon një ftesë.

Dhe ja, dita e dasmës erdhi... Në sallonin e mbushur plot mysafirë, djaloshi e merr mikrofonin dhe fillon t'u tregojë mysafirëve krejt atë çfarë i kishte ndodhur në jetë: "Dikur kam pasur një shok të cilin e doja shumë fort. Një ditë, kur s'i shkonte mbarë, erdhi dhe më kërkoi para borxh. Ia dhashë të gjitha që kisha. Një herë tjetër më tha se e pëlqente shumë të fejuarën time dhe kërkoi prej meje të hiqja dorë prej saj. Me zemër të thyer e të përgjakur, e braktisa edhe të fejuarën... Thjesht nga arsyeja se ne ishim shokë të vërtetë. Nuk kisha dëshirë t'ia prishja qejfin shokut... Kur më vonë mua s'më shkonte mbarë, shkova te punësoria e tij dhe e luta të më gjente punë. Mirëpo ai nuk më dha punë. U dëshpërova shumë. Mirëpo, prapëseprapë, nuk jam i zemëruar me shokun tim. Sepse ne ishim shokë të vërtetë."

Me të dëgjuar këto fjalë, shoku i shkathtë nuk duron dot dhe e merr mikrofonin në dorë dhe fillon edhe ky të flasë: "Edhe unë dikur kam pasur një shok të vërtetë që e doja fort. Kur nuk më shkoi mbarë, kërkova prej tij para. Ai m'i dha të gjitha paratë që kishte... Më vonë ia kërkova të fejuarën. I dëshpëruar dhe i brengosur, ai e braktisi edhe të fejuarën. Mirëpo, arsyeja pse kërkova të ndahej nga e fejuara ishte se ajo vajzë nuk meritonte të bëhej grua e tij. Meqë shoku im ishte i ngathët dhe s'e kuptonte dot këtë, unë vetëm në këtë mënyrë mund ta shpëtoja... Kur ishte ai në zor, erdhi tek unë dhe kërkoi ta punësoja, mirëpo unë nuk mund ta shihja shokun tim më të ngushtë të punonte nën komandën time. Për këtë arsye dhe nuk i gjeta punë... Plakun që ai e takoi në rrugë, ishte babai im. Ai ishte pranë vdekjes. Atë unë e dërgova te shoku im dhe unë i thash atij që gjithë pasurinë t'ia linte trashëgimi atij... Gruaja plakë që erdhi të lypte te porta e tij ishte nëna ime. Unë e dërgova atë te shoku që ai të jetonte më mirë e më lehtë... Kurse gruaja me të cilën ai sot po martohet, është motra ime më e vogël. Unë e binda atë që të martohet me shokun tim..."

Mysafirë të nderuar, ja, kjo është miqësia dhe dashuria jonë."

## LUTËSI NË HAREMIN E QABES



Muhamed Hasani -Allahu e ruajt- thotë: vAllahi, këtë raste e kam parë me sytë e mi, rast i prekshëm, kam parë një njeri nga Jemeni në haremin e Mekës. Unë po shkoja në Haremin e Qabes dhe kur hyra në oborr, pas disa hapave që bëra pashë në anën time të djathtë një njeri i cili kishte ngritur duart e tij aq lart sa që shihej edhe nënsqetulla e tij. I kishte ngritur duart, e zbukuronte lutjen e tij tek Allahu me një mënyrë të përlurur, të nënshtuar dhe po qante. Shikova drejt ti dhe u dridha, veç sa nuk më doli zemra nga vendi, u afrova me qetësi ashtu qe mos ta pengoj dhe t'ia ndërpresë lutjen. Qëndrova një hap mbrapa në anën e tij të djathtë, i fala dy rekate namaz dhe u ula po shikoja drejt tij, njëherit po qaja për gjendjen që kishte ai me Allahun.

Njeriu duart i mbajti të ngritura gjatë. Paspak pash një bamirës prej vëllezërve tanë të Haramejnit , në të njëjtën gjendje në të cilën unë isha pak më parë, eci disa hapa dhe shikoi, pastaj prapë e shikoi edhe njëherë dhe i dha selam , mirëpo njeriu ishte i nxënë me duanë që ia bënte Zotit të tij. Njeriu bamirës futi dorën në xhep dhe nxori një shumë të madhe parash. Unë nuk e njihja atë person( bamirësin), i hodhi ato para në prehrin e atij që lutej dhe u largua, ndërsa ky as që shikoi se çka u hodh në prehër, vazhonte te lutej tek Allahu , dhe nuk e di a i vërejti paratë apo jo. Pas një kohe uli duart dhe kokën e tij, shikoi parat në prehër dhe buzëqeshi. Filloi te qajë dhe përsëri filloi të lutej tek Allahu me përlulësi derisa mbaroi nga lutjet.

Shkova drejt tij dhe e përshëndeta me selam , ia putha kokën dhe i thashë: Më falë, të lutem për Allahun më trego çka është puna jote, çka the dhe me çka u furnizove? Kam dëshirë të mësoj, më mëso”.

Lutësi buzëqeshi dhe më tha: “Po ti çka ke?”

I thashë: Më falë, më thuaj dhe pasha Allahun do të më tregosh dhe fillova të qajë.

Më tha: Pasha Allahun o biri im, kam ardhur dhe askush pos Allahut nuk e ka ditur brengën dhe dhimbjen e madhe që kam në zemër. Askujt prej njerëzve nuk ju kam lutur asnjëherë, përveç Allahut.

Erdha në shtëpinë e Tij dhe i thashë :”Unë jam në shtëpinë tënde , të lutem Ty dhe nuk kam lutur askënd pos Teje, a thua vallë do të më zhgënjesh, a thua valle do të më humbësh?”

Më tha: vAllahi o biri im, më ka dhënë shumë herë më shumë se sa kam kërkuar , jo dy herë po tri herë më shumë.

Shejhu thotë: Allahu e dinë se sa para kishte. O të dashurit e mi, ai që mbështet tek Ai, i mjafton. Ai që kapet për Atë, shpëton. Ai që i dorëzon çështjen Atij, udhëzohet.

“ O robërit e mi, të gjithë ju jeni te uritur, përveç atyre qe i kam ushqyer Unë, pra kërkonit t’ju

ushqej dhe Unë do t'ju ushqej! O robërit e mi, të gjithë ju jeni të zhveshur përveç atyre që Unë i kam veshur, pra kërkoni veshje nga Unë dhe Unë do t'ju vesh...” Hadith Kudsij

### Tregim i cuditshëm rreth Imam Malikut



Në kohën e imam Malikut në Medine, dijetarët thanë që nuk I lejohet kujt të jap fetua, sa është imam Malik gjallë dhe kjo ka ngjarjen e saj. Në Medine vdiq një grua, të afërmit e saj morën një tjetër grua që ta lajnë xhenazen. Kur ajo po e lante tha: “Lavire që ke qënë tek Allahu do ta shohësh se çfarë ke për të pësuar.” – dhe në atë moment, dora e saj që fërkonte trupin e pa jetë të gruas, I ngjiti sipër saj. Ajo tentoi disa herë që ta hiqte dorën e saj, por ishte e kotë, dora nuk u shkulte.

Njerëzit qëndronin pas dere duke pritur përfundimin e larjes se xhenazes, por kur filloi të kalojë ora njerëzit kujtuan se gruaja kishte vdekur brenda. Kur u futën njerëzit për të parë, panë që dora e gruas kishte ngjitur sipër trupit të pajetë, provuan dhe ata ta shkëpusnin por ishte e kotë. Menduan të shkonin tek dijetarët dhe ti pyesin për këtë ndodhi dhe se si mund të vepronin, por ata nuk I dhanë asnjë përgjigje.

Njëri prej tyre tha: “Le të shkojmë një herë tek imam Malik se ndoshta na jep ndonjë përgjigje rreth kësaj çështjeje.” Shkuan tek imam Malik dhe I drejtuan atij pyetjen që kishin. “O imam, kështu është çështja, çfarë të bëjmë.” Imami ju përgjigj: “Pyetni një herë atë grua, çfarë po mendonte ajo kur po e lante atë xhenaze.” Marrë përgjigjen e imam Malikut, njerëzit shkuan tek gruaja dhe e pyetën se çfarë po mendonte ajo kur po lante trupin?

Ajo I tha: “Jo nuk po mendoja, por po thoja lavire që ke qënë...” – po ti a e ke parë atë me sytë e tu- jo tha ajo – nuk e kam parë. Shkuan tek imami dhe I treguan se çfarë I kishte thënë gruaja. Imami I tha: “Goditeni me 80-shkopinj sepse vërtetë ka shpifur” Kur filluan ta godasin 1, 2, 3, ... deri kur arritën tek 79, 80, gruas ju shkit dora. Atëherë thanë: “Sa të jetë Imam Malik gjallë nuk I lejohet kujt të japë fetva.”

Kini kujdes vellezer nga shpifja rreth njerezve se me te vertete ajo eshte nje gje e rende.

## Krishteri dhe Muslimani



E ftoi krishteri një musliman në shtëpinë e tij, dhe pasi i shprehu mirëseardhje ia ofroi një pjatë me rrush. Muslimani e falënderoi dhe filloi ta haj rrushin.

Pas pak u ngrit krishteri, e mori një gotë, e mbushi me verë dhe e vendosi para muslimanit. Kur e pa muslimani këtë i tha: “Më fal, por kjo për mua është haram.”

Ndërsa krishteri ia ktheu: “Është e çuditshme me ju muslimanët e lejoni (këtë) rrushin, ndërsa e ndaloni këtë (verën). Edhe pse kjo (vera) është nga kjo (rrushi)!”

Me të dëgjuar këtë, muslimani e pyeti: “A ke grua?”

“Po”, ia ktheu krishteri

“A mund ta ftosh këtu?”, i tha muslimani

U ngrit krishteri e ftoi... dhe ajo erdhi.

Pastaj muslimani i tha: “A ke vajzë?”

“Po”, tha krishteri “Një vajzë të vogël!”

“Mirë na e sjell këtu”, tha muslimani

U ngrit i krishteri dhe e solli vajzën e cila ishte duke luajtur në dhomën tjetër!

Atëherë muslimani i tha: “A nuk e sheh se Allahu ta ka lejuar këtë (gruan), kurse ta ka ndaluar këtë (vajzën), edhe pse kjo është nga kjo!!

Atëherë i krishteri mbeti i shtangur dhe tha: “Dëshmoj se nuk ka Zot pos Allahut. Dëshmoj se Muhamedi është profet i Tij, dhe nga sot unë jam musliman.”

## Më varrosni me çorapë



Kur një njeriut të ngritur dhe pasanik iu afrua vdekja, i ftoi dy djemtë e tij dhe ua dorëzoi dy shkresa të mbyllura. U tha atyre: Letrën e parë do të hapni pasi që të vdes dhe para së të më varrosni, ndërsa të dytën, pas varrimit. Pas vdekjes së babait, mblidhen djemtë dhe e hapin letrën e parë, të shohin testamentin e shkruar nga i ati. Në të thuhej:

*“O fëmijë të mi të dashur, kur të vdes me jepni gusëll, më mbështillni me qefin dhe mi vishni çorapet. Assesi të mos më varrosni pa mi veshur ato!”*

Vëllezërit filluan të diskutojnë. Më i riu tha se duhet të përmbushin dëshirën e babait, derisa më i vjetri tha se asnjë nga muslimanët nuk varroset me çorapë kështu që as babai i tyre nuk do të varroset. Dhe kështu ndodhi, ata e varrosën babanë e tyre pa çorape.

Pas varrimit ata hapën edhe letrën e dytë që të shohin se çfarë testamenti u ka lënë babai i tyre. Në të shkruante:

*“Fëmijë të dashur! Isha shumë i pasur dhe shikoni së në këtë dynja kam pasur çfarë të dëshiroj, ndërsa në varrë as çorapët nuk i mora!”*

## Djaloshi që mësoi atë që nuk mund të mësohej



Një herë e një kohë, ka jetuar në Basra një burrë I vejtër, I cili kujdesej shumë për djalin e tij të vetëm, që e donte shumë. Plaku I moshuar të gjitha kursimet e veta I shpenzoi që t`I jepte të birit një arsimim të shkëlqyer në atë kohë dhe për këtë arsye e dërgoi te mësues të njohur. Djaloshi u largua dhe shkoi në shkollat më të mira dhe te mësues it e dijetarët më të mirë të shkëlqyer në atë kohë dhe për këtë arsye e dërgoi te mësues të njohur. Djaloshi u largua dhe shkoi në shkollat më të mira dhe te mësuesit e dijetarët më të mirë të kohës.

Erdhi dita që ai të kthehej nga studimet e tij dhe babai I moshuar doli ta priste në derën e shtëpisë. Kur erdhi djali dhe u takua me babanë, ai e pa në sy dhe ndjeu një zhgënjim të madh. “Çfarë ke mësuar biri im?” tha ai: “Unë kam mësuar atje çdo gjë që ishte për t`u mësuar baba”, tha ai. “Por a ke mësuar atë që nuk mund të mësohet?” pyeti babai. “ Shko, djali im dhe mëso atë që nuk mund të ëmsohet”, I tha babai I moshuar. Djaloshi I rritur kthehet te mësuesi I tij më I mirë me qëllimin që të mësojë atë që nuk mund të mësohet. “Merri këto 400 dele dhe shko në mal. Kur të bëhen 1000, eja këtu te unë”, I tha mësuesi.

Djaloshi shkoi në mal dhe u bë bari. Për herë të parë ai kuptoi çfarë është heshtja. Ai nuk kishte me kë të fliste. Delet nuk e kuptonin gjuhën e tij. I dëshpëruar ai bisedonte me to, por ato e shikonin sikur të thoshin me vete “sa budalla qenka”.

Ngadalë ai nisi të harronte dijen e mësuar në shkollë, por edhe egoizmin, smirën dhe cilësitë e këqija. Ai u bë I qetë si delet dhe e kaploi urtësia dhe përulësia. Në fund të dy viteve, kur numri I deleve kishte arritur në njëmijë, ai u kthye te mësuesi I tij dhe e nderoi siç e meritonte. “Tani ke mësuar atë që nuk mund të mësohet”, I tha mësuesi.

Është interesnate të përmendet se disa të Dërguar të Allahut në jetën e tyre, para se t`u vinte shpallja, kanë qenë barinj dhe janë kudjesur për delet.



## Egoisti



Njëherë e një kohë, jetonte një egoist. Ai dëshironte që gjithçka të ishte e tij. Nuk donte t'i ndante sendet e veta me askënd, as me miqtë e as me të varfrit.

Një ditë ai humbi 30 monedha ari. Ai shkoi në shtëpinë e mikut të tij dhe i tregoi se i kishin humbur monedhat. Vajza e mikut kishte gjetur 30 monedha dhe ia kishte dorëzuar babait. Atëherë babai ia ktheu paratë shokut të tij.

Pasi i numëroi paratë, egoisti tha se kishte pasur 40 monedha dhe se vajza e shokut të tij i kishte vjedhur 10. Por djali dhe vajza thanë se nuk kishin gjetur më shumë para. Egoisti shkoi në gjykatë dhe i tregoi gjykatësit se çfarë kishte ndodhur.

Gjykatësi kërkoi që të thërrisnin vajzën dhe babanë e saj, dhe kur ata erdhën, gjykatësi e pyeti vajzën se sa monedha kishte gjetur. Ajo i tregoi se kishte gjetur vetëm 30.

Pastaj gjykatësi e pyeti egoistin se sa monedha kishte humbur. Ai u përgjigj se kishte humbur 40. Atëherë gjykatësi i tha egoistit se monedhat nuk i përkisnin atij, duke qenë se vajza kishte gjetur 30, ndërsa ai kishte humbur 40 monedha.

Prandaj, i tha vajzës t'i merrte monedhat dhe nëse ndokush kërkonte 30 monedha që i kishin humbur, dhe t'ia jepnin. Në atë çast egoisti rrëfeu se kishte humbur 30 monedha, por gjykatësi nuk e dëgjoi.

## A është bërë padrejtësi?



**Kaluan disa vite dhe pronari i firmës e gradoi Fisnikun duke e bërë përgjegjës kryesor për hyrje-dalje të mallrave...**

Pas diplomimit të tyre, Besmiri dhe Fisniku filluan të punonin në një firmë tregtare. Kaluan disa vite dhe pronari i firmës e gradoi Fisnikun duke e bërë përgjegjës kryesor për hyrje-dalje të mallrave derisa Besmirin e la si punëtor të thjeshtë.

Kjo gjë e frustroi aq shumë Besmirin sa deshi ta linte punën. Shkoi te pronari i firmës dhe u ankua se ai nuk i vlerësonte ata që punojnë me seriozitet dhe u jep poste atyre që i bëjnë lajka atij.

Pronari e dinte se Besmiri punonte me seriozitet gjatë tërë këtyre viteve, mirëpo për ti ndihmuar ta kuptonte dallimin në mes tij dhe Fisnikut, kërkoi prej tij që të shkonte në treg dhe të shihte nëse ka aty ndonjëri që shet shalqinj. Besmiri u kthye me nxitim dhe i tregoi pronarit se kishte shitës të shalqinjve.

Pronari e pyeti: “Sa ishte çmimi i kilogramit?”

Besmiri, që nuk e kishte pyetur shitësin, nxitoi të shkonte përsëri në treg që të pyesë dhe u kthye pas pak tek pronari duke i treguar se çmimi i një kilogrami kushtonte 30 cent.

Pronari i tha Besmiri, se të njëjtën pyetje do t’ia bënte edhe Fisnikut. Shkoi Fisniku në treg dhe pas disa minutave u kthye e i tha pronarit: "Zotëri, është vetëm një person në treg që shet shalqinj, kilogrami kushton 30 cent, nëse merr 100 shalqinj, e merr me 20 cent kilogramin, në depo ka 400 shalqinj, kurse në treg 60 shalqinj, dhe secili përafërsisht peshon 15 kg. Këta shalqinj vijnë nga Shqipëria, janë të freskët dhe me farë të ëmbël. Shitësi është në gjendje të na furnizojë deri në 1000 shalqinj pas një jave dhe me çmim edhe më të volitshëm".

Besmiri u befasua nga këto informata kaq precize që Fisniku i mori për një kohë kaq të shkurtër. Vendosi që të mos largohet nga firma por të mësonte më shumë nga Fisniku.

Urtësia e tregimit

Para se të shpallësh se të është bërë padrejtësi, mendo pak në këtë çështje e pastaj fol.

Sepse shumica pretendojnë që janë më të mirët, por nuk mundohen ta vërtetojnë këtë gjë.

### **Je i dëvotshëm provohesh por prap gëzohesh**



Një prindë ishte shumë i devotshëm rrugës së tij po shkonte edhe i biri. Kur iu afrua momenti të vdiste babai e këshilloi të birin. Ndër mësimet që i kishte dhënë ishte. Biro asnjaherë mos u beto nëse njeriu tregon të vërtetën apo gënjejë. Mirpo njerëzit e pa ndërrë e kuptuan këshillimin që i kishte lënë babai dhe përmbajtja që ia bëntë djaloshi gjithashtu i dëvotshëm. shkuan dhe i than se babai yta na ka pasur borxh. Ai kishte mjaftë oasuri dhe kush shkonte me këtë shptehje ia jepte pa r pyetur derisa e hargjoi pasurin dhe mbeti i varfër.

Vendosi që të largohet nga ai vendë së bashku me gruan dhe dy djemtë e tij.

Hipen me një anije por dallgët e detit u trazuan dhe anija u thye. Të gjithë udhëtarët u shpërndanë në luftë për shpëtimin e vetvetes. Tre anëtarët e familjes së këtij djaloshi u larguan u ndanë njëri nga tjetri po me gjithatë shpëtuan. Buri i dëvotshëm ishte duke u mbajtur për një dërrase dhe valët e sollën tek një ishull. pas pak derisa po shkelte në tokë nga gjendja tmerruese hutuese e ujit dëgjoi një zë: O njëri i mirë që je sjellur mirë më prindërit e tu Allahu don të të japë një thesarë dhe e ke në këtë vendë. Shko e merre.

Burri gjeti thesarin dhe kë e takonte e ndihmonte duke i dhënë pasuri. U hapë lajmi se në një ishull është një njeri bujarë. Vinin shumë njerëz të banonin aty te ai ishull u popullua. Të gjithë e pranuan këte bujarin që të jetë mbret i tyre.

Kalun disa vite dhe të dy djemtë e këti të pari të ishullit vinë në këtë ishull për të kërkuar punë. U punësuan në një vendë si roje të prijësit të ishullit por asnjëri tjetrin nuk e njihte.

Pas një kohe vije edhe gruaja e tijë me një të afërm të sajë i cili e len gruan në varkë dhe shkon tek prijësi për ti dhënë dhurata. Prijësi i ishullit e priti mirë dhe e ftoi që të flejë në tembullin e tij. Mirëpo kusheriri i gruas së tij tha. Nuk mundëm sepse kamë një grua të afërt me vete që e kam lënë në varkë. Prijësi i tha. I dërgojë unë dy roje tek varka e jote dhe do ta ruajnë.

Të dy rojet shkuan tek varka dhe derisa qëndroni zgjyar gjatë natës filluan t'i tregeojnë njëri tjetrit nga ndhitë e jetës personale sapër ta kaluar kohën.

Vëllau i madhë filloi tregimin e dhimbshëm të jetës së tij. Së bashku me nëne babain dhe një vëlla timin që quhej kasmik u nisëm me një anije për të migruarë. Por dallgët e detit na fundosën, dhe nuk e di a kanë shpëtuar apo jo. Kasmia ia ndërpreu tregimin. Po si quhej babai yt? Derisa i tegoi bashkëpunatori i rojës për këtë. Kasimi iu hodhë në qafë. Pasha Allahun ti je vëllau im dhe unë jam vëllau yt. U përqaftuan e u çmallën pasiqë kishin kaluar shumë vite që nuk ishin parë dhe nuk e njihnin njëri tjetrin. Gruaja që qëndronte në varkë po dëgjonte bisedën e tyre dhe nuk mundi të qëndroi dhe doli. Pasha Allahun edhe unë jam nëna e juaj. Gëzimi nuk kishte kufij. I luteshin Allahu që ta gjenë edhe babain e tyre përqaftonin njëri tjetrin nga malli i madhë. Nëna përqaftonte bijët e dashur që i kishin humbur. Kështu qëndruan deri natën vonë derisa i zuri gjumi dhe fjetën të tre bashkë.

Kusheriri i sajë që ishte musafir i mbretit kur vajti të nesërmen tek varka i sheh fjetur të tre bashkë dhe mendon keq për ta. Kthehet tek mbreti për t'iu ankuar. Mbreti urdhëroi që të tre të vijnë para tij. Duke u bërtitur si ishte e mundur të gjinden ashtu në dtyrën e tyre të rojtarit.

Derisa djali i madh po tregonte ngjarjen, deri tek njohja e vëllezërve. Mbreti bërtiti shumë fortë dhe kërcëu nga fronti i tij nga gëzimi. Pasha Allahun ju dy jeni djemtë e mi. Gruaja tha Pasha Allahun unë jam nëna e tyre. Me të vertetë Allahu ka mudnësi t'i bashkoi njërezit pasi që janë ndarë.

## DITA E PENDIMTARËVE



Xhamia, edhe pse ishte e madhe, u ngushtua për së tepërmi prej muslimanëve, të cilët i kishin drejtuar sytë te dijetari i tyre me famë - Malik bin Dinari. Ai u ul në vendin e tij, për një moment heshti, e pastaj e ngriti kokën, kur pa turmën e madhe të njerëzve, sa që më herët as që kishte parë një turmë të tillë, duke dëgjuar fikihun e Irakut dhe ligjëruesin e xhamisë së Kufes. Sytë iu kishin përplotur. Lotët i kishin arritur deri në mjekër, kur e pa atë turmë, e cila kishte ardhur sot për ta dëgjuar, pasi që një ditë më parë iu kishte lajmëruar për një çështje, të cilën kurrë nuk e kishin dëgjuar më parë, dhe ishte mirë që ta dëgjonin.

Imam Maliku fillon ligjëratën, ndërsa zëri i tij depërtonte thellë në zemrat e dëgjuesve dhe të dashurve të tij, sa që mendonin se zëri është duke iu ardhur nga një largësi e madhe. Ai e falënderoi Allahun, dërgoi salavate për Pejgamberin s.a.v.s., pastaj i ftoi dëgjuesit dhe xhematin për mirësi dhe falje gabimesh, sepse ata kanë mendim të mirë, dhe tha: “Dje ju kam thënë se sot do t’ju tregoj, me lejen e Allahut, për robin e varfër të Allahut i Lartmadhëruar, të cilin e dëgjoni, pra për veten time - Malikun. Unë di për veten time atë që ju nuk e dini, ndërsa ju keni mendim të mirë ndaj meje. Zoti jua shpërbleftë me të mira.

Unë si i ri kam qen polic kriminel, detyra ime ka qenë mbajtës i rendit në treg, dhe askush nuk ka mundur t’i ikë padrejtësisë sime, askush nuk ka shpëtuar pa e rrahur; sa e sa njerëz i kam keqpërdor, i kam maltretuar. Zoti më faltë! Dhe sa herë që i kujtoj, zemra më këputet, shpirti më dobësohet dhe po të mos kisha besim të mëshira e Allahut, do të isha tjetër njeri.

O vëllezër të mi, nuk ka të keqe që nuk e kam pas bërë. Kam pirë alkool, i kam maltretuar njerëzit, kam hyrë në punët e brendshme të tyre, edhe në shit-blerje; i kam ndihmuar edhe të padrejtit, vetëm pse kam dashur të tregoj se unë mund të bëj çka të dua.

Një ditë prej ditësh isha në treg, kur i pash dy njerëz që nuk pajtoheshin për një çështje: njëri ishte shitësi, e tjetri ishte blerësi. Shitësi e donte çmimin e caktuar, blerësi dëshironte ta blinte me çmim më të ulët. I bërtita blerësit, dëshirova t’i bija me shkop, deri sa diçka më pengoi. E çka ishte nuk e di, dhe u shmanga anash, kur pashë një njeri plak e të thinjur. Në fytyrën e tij shiheshin shenja të një njeriu të mirë, i cili ma tërhoqi vërejtjen me dorë, se para se të gjykoj, të mendoj mirë, dhe ma tregoi mënyrën e zgjedhjes së problemit. Kjo ishte hera e parë në jetën time që të hesht kur dikush tjetër flet. Ai e përfundoi bisedën me një hadithë të të Dërguarit të Allahut s.a.v.s., i cili ka thënë:

**“Kur ndokush nga ju shkon në treg dhe blen gjëra për t’i gëzuar bijat e tij, Zoti e shikon me mirësi atë njeri”.** Prandaj unë jam duke u kthyer nga një udhëtim dhe dëshirova që para se të shkoj në shtëpinë time të blej diçka e t’i gëzoj tri bijat e mija, e që Allahu të më shikojë me mirësi. - Tregon Maliku: Biseda e tij më impresionoi dhe ia bleva gjërat që dëshironte ai dhe ia dhashë, njëherazi e porosita që vajzat e tij

të luten për mua.

Kaluan ditë e ditë dhe biseda e tij zhurmonte në veshin tim, deri sa e pashë një robëreshë të bukur, e cila shitej në treg. Ajo më hyri në zemër, u dashurova në të, për këtë arsye e bleva dhe u martova me të. Pastaj me të kalova jetë të lumtur, pasi që ajo ishte bashkëshorte ideale, fillova të jem i devotshëm. Allahu më fali një vajzë të bukur, ndërsa, disa ditë pas lindjes së vajzës, gruaja ime (nëna e saj) vdiq, dhe vajza mbeti jetime. Disa vite jetova me të e nuk u martova, dhe nuk interesohesha për asgjë tjetër, pos që të përkujdesesha për bijën time, e cila ishte gjithçka në jetën time.

Një ditë, deri sa po kthehesha nga puna, pash se bija ime ndiente dhimbje e vuajtje, dhe fillova të kërkoja shërim te mjekët. Mirëpo, ishte caktim i Zotit që ajo të vdesë në gjoksin tim. E kam marrë dhe e kam shtrënguar në gjoksin tim, me shpresë se do të mbijetoj; e laga me lotët e mi dhe u luta për të, me frikë e me pikëllim dhe çështjen time përfundimisht ia lashë Allahut. E varrosa me duart e mia. Fillova të ikën nga vetvetja ime, jeta ime, realiteti im dhe fillova prapë me alkool të dehem, e ta mbizotëroj pikëllimin tim. E ndieja veten se nuk më ka mbetur asgjë dhe se çdo kush më ka fyer, andaj fillova t'i urreja njerëzit, sillesha ashpër me ta si hakmarrje ndaj tyre, thua se ata ma kanë grabitur gruan, vajzën time dhe ma kanë marrë lumturinë e jetës sime.

Deri sa një ditë kontrolloja tregun, e pashë një grua me ushqim në dorë, e dhunova aty për aty dhe as që mërzhitesha se pse qante e bërtiste, e as pse kishte fëmijë të vegjël. Atë natë shkova herët në mbrëmje dhe ishte mesi i muajit Shaban. Kam rënë në një gjumë të thellë, dhe deri sa isha në gjumë pashë një ëndërr, sikurse ndodhi Kijamet. Iu fry surit, u tubuan të gjitha krijesat dhe unë gjendesha në mesin e tyre. Pastaj dëgjova një zë trishtues, u ktheva në drejtim të atij zëri, kur pashë një gjarpër të madh e të zi, me gojë të hapur, i cili frynte flakë, me sy trishtues dhe më sulmoi me ashpërsi. Ika prej tij me të katërtat nga frika, sa që arrita te një plak i dobët dhe i thashë: “Më mbroj nga ky gjarpër, Zoti të mbroj edhe ty! Ai qajti dhe më tha: “Vrapo, ik, ndoshta Allahu të gjen zgjidhje e të shpëton.” Vrapova me të shpejtë deri sa arrita në maje të kodrës, ishte fundi i Ditës e Kijamet dhe gati sa nuk më zuri, dhe thirri me një zë duke thënë: “Kthehu se nuk e ke vendin këtu.” U ktheva nga aty prej frikës se mos më zë gjarpri dhe përsëri shkova te ai plaku dhe kërkova mëshirë dhe mbrojtje prej tij. E ai u arsyetua se është i dobët dhe nuk mund të më ndihmojë. Pastaj më tha: “Shko te ajo kodër, sepse aty janë fëmijët e muslimanëve. Nëse ke aty ndonjë fëmijë do të të ndihmojë”. Shikova në kodër, e cila shkëlqente prej argjendit, ndërsa perdet ishin të varura në çdo anë, të cilat ishin prej arit. Çdo perde ishte prej mëndafshi, e cila t'i merrte sytë dhe vrapova në atë drejtim. Ndërsa gjarpri më vinte pas, kur u afrova në atë vend, një melaqe tha: “Ngritni perdet dhe hapni dyert”. Pastaj pashë fëmijët si yje, ndërsa gjarpri mu afrua dhe më kërkonte mua. Disa fëmijë thanë, ngrituni që të gjithë së bashku se është afruar armiku, dhe filluan të vijnë fëmijët grupe-grupe, e në mesin e tyre ishte vajza ime, e cila më kishte vdekur e vogël. E shikova atë, e ajo qajti dhe tha: “Për Zotin, babai im! Pastaj mu mbështet në krah si shigjetë dhe e zgjati dorën e saj të majtë në krahun tim të djathtë dhe u mbështet në mua, ndërsa me dorën e saj të djathtë e largoi gjarpurin nga unë. Pastaj më uli, deri sa unë isha i lodhur e i rraskapitur, më përqafoi përzemërsisht, ndërsa mua lotët më shkonin për toke nga frika se mos do ta humbi edhe një herë. E zgjati dorën te mjekra ime dhe lozte me mua dhe më shikoi me dy sytë e saj të bukur dhe me ledhatim e dashuri, si dhe me mirësi e me sinqeritet më tha (ajetin kur'anor):

**“A nuk ka ardhur koha për besimtarët, që t'i zbutin zemrat e tyre me përkujtim ndaj Allahut, dhe me atë që e ka zbritur me të vërtetë”.**

Kur dëgjova këtë ajet fillova të qaja pandërprerë, dhe thuaja se për të parën herë e dëgjoja. E pyeta atë: Ju e dini Kuranin? Ajo mu përgjigj: “Më mirë se ju”. E pyeta: “Më trego çka ishte ai gjarpër, i cili donte të më gëlltiste?” Ajo mu përgjigj: “Ai është vepra jote e keqe, të cilën e ke zmadhuar dhe është ngritur kundër teje dhe dëshiron të të shpie në xhehenem”. Pastaj e pyeta: “Po ai plaku, kush ishte?” Mu përgjigj:

“Ai është puna jote e mirë, të cilën aq shumë e ke dobësuar dhe nuk mundi të të ndihmonte. Unë i thashë: “Oj bija ime, po çka bëni në këtë kodër?” Më tha: “Këtu janë të vendosur fëmijët e muslimanëve, që të qëndrojnë deri në Ditën e Kijametit, ju presim që kur të vini, të ndërmjetësojmë për ju”.

U tmerrova nga trishtimi dhe u zgjova nga gjumi. Isha bërë ujë nga djersitja, thuaj se kishte rënë shi mbi mua. E mora një thupër, i theva gotat e alkoolit dhe u pendova sinqerisht dhe me zemër te Allahu. Dhe disa ditë mbeta në shtrat. Nuk mund të lëvizja, dhe kësaj radhe kërkova falje prej Allahut. U pendova dhe kërkova mëshirë nga ai. Dhe që nga ajo ditë vendosa sinqerisht ta trasoj rrugën e Allahut, dhe në ditët e para e adhuroja Allahun dhe pendohesha vazhdimisht. Më dukej se në çdo moment do të më dalë gjarpri dhe do të më gëlltisë.

Në atë gjendje përplot frikë e trishtim jam izoluar nga njerëzit, dhe isha në një fazë kritike. Mirëpo atë vit ishte një thatësi e madhe, nuk binte shi. Edhe pse falnim namaz për shi, shiu nuk binte. Bimët u thanë, ishte uri e madhe. Një ditë mbeta i vetëm në xhami, dhe pasi të gjithë shkuan, iu luta Allahut. Kur papritmas hyri në xhami një njeri me këmbë të holla, bark të madh dhe e ngrit kokën lartë në qiell, dhe iu lut Allahut: “O Zoti im, deri kur robërve të tu nuk ua pranon lutjen, për deri sa Ti je Ai që nëse jep, nuk pakësohet asgjë te ti?!” Të përbetohem Ty, me dashurinë Tënde ndaj meje, na zbrit shi tani, dhe posa e përfundoi lutjen filloi të binte shi me të madhe. Ai njeri deshi të dalë nga xhamia, e unë shkova e i thashë: “A nuk po ke turp të thuash: ‘Për dashurinë Tënde ndaj meje, po ku e di ti se Allahu të do?!’”.

Ai mu përgjigj: “O ti, shiko punën tënde, po ku ke qenë ti kur Allahu më ka zgjedhur për ta adhuruar vetëm Atë, a nuk po e sheh që për dashurinë e Tij për mua tani po bie ky shi. A nuk e di ti se Allahu është Falës i Madh dhe i do robërit e tij. A nuk e ke dëgjuar fjalën e Zotit të Lartmadhëruar: **“Ai (Allahu) është, i Cili ju jep të mira juve dhe melaqet e tija, për t’iu nxjerrë juve nga errësira në dritë. Ai është i mëshirshëm ndaj robërve të Tij”**. Ai shkoi e unë mbeta i habitur, dhe prej atij momenti unë i lutem Allahut pa e ndier frikën e atij gjarpri.

Për një çast Malik bin Dinari heshti, pastaj me forcë dhe përkushtim tha: “O ju njerëz, vërtet Allahu është i mëshirshëm, përgëzohuni me mëshirën e tij, dhe përgëzoni të tjerët se Allahu ju do juve. Ah sikur ta dini, ah sikur ta dinit nuk do të bënit mëkate. O ju njerëz, a e doni Allahun? Atëherë ta dini se prej shenjave të dashurisë së Allahut është përkujtimi ndaj tij, sepse ai, i cili e do dikë, e kujton shpesh. Dhe kush nuk bisedon me Allahun dhe nuk i lidh raportet Allah-krijesë ai nuk ka dituri, dhe jeta e tij është e pavlefshme.

Pendohuni te Allahu o ju njerëz! U ngrit Maliku në këmbë, atëherë edhe tjerët u ngritën në këmbë, duke u penduar te Allahu me pendim të sinqertë. Kështu ajo ditë u quajt Dita e Pendimit.

## PËRFITOI NGA DUAJA E BABAIT



Tregon një hoxhë:

E kujtoj një burrë të dobët dhe të varfër që kujdesej shumë për babanë. Punonte dhe kur sillte paratë e fituara i linte në tavolinë ngase i vinte turp t'ia zgjaste babait dorën.

Kur e pyeta për këtë, më tha:

- Turpërohem ta zgjas dorën mbi dorën e babait e të bëhet fitimi im si bamirësi ndaj babait tim.”

Më tregon mua, ndërsa ai tani është dijetar i madh, se sa herë që e lija fitimin mbi tavolinë, babai lutej e thoshte:

- O Zoti im, furnizoje birin tim dhe dituri te Kur'anit dhe beje ithtar te tij!

Kaluan vite ndërsa unë isha neglizhent ndaj kësaj duaje derisa deshi Allahu dhe gjatë rrugës për në shtëpi e takova një dijetar të qytetit, i cili më tha:

- Çfarë je duke bërë o biri im?

- Punoj për të fituar bukën.

- A nuk do të vish tek unë një herë në javë për të mësuar? - më pyeti.

-Po, me gjithë dëshirë,- ia ktheva.

Kaluan dite dhe erdhi koha edhe ta mbroja doktoratën ne shkencën e Tefsirit. Kur prezantoi ne sallë, mësuesi u ngrit ne shenje respekti për te, meqë, sipas tij, ky student jo vetëm qe kishte arritur dituri, por kishte arritur edhe devotshmëri. Fillova te qaj ndërsa mësuesi me tha:

- Qan ndërsa ne te respektojmë ty.

- Nuk qaj për atë, por po qaj për duanë e babait tim, Allahu e mëshiroftë!

Mësimet e tregimit:

Bamirësia ndaj prindërve është njëra prej shkaqeve që të shpijnë në lumturi në këtë dhe botën tjetër,

Duaja e prindit për fëmijën pranohet, dhe

Me dituri njeriut i rritet fama.



## Selim ibën Abdullahu dhe Kalifi



Hisham ibën Abdul-Meliku në kohën sa ishte Kalif vendosi të shkojë në haxh. Posa hyri në Qabe e takoi Selim ibën Abdullah ibën Omerin (Allahu i mëshiroftë që të dy!).

Kalifi i tha atij: “Kërko nga unë çkado që të kesh nevojë!”

Selim ibën Abdullahu iu përgjigj: “Turpërohem nga Allahu që të kërkoj diç nga ndokush tjetër duke qenë në shtëpinë e Tij.”

Kur doli Selimi nga Qabja Kalifi i shkoi pas dhe i tha: “Tashmë dole nga shtëpia e Allahut, andaj më trego se për çfarë ke nevojë!”

Selimi e pyeti atë: Ke për qëllim nevojat e kësaj bote apo të ahiretit (botës tjetër)?

Kalifi ia ktheu: “Natyrisht, nevojat e kësaj bote.”

Atëherë Selimi i tha Kalifit: “Unë nuk e kërkova dunjanë nga Ai që e zotëron atë, e si ta kërkoj atë nga ai që nuk e zotëron?!”

## Ah, sikur të mos martohesha



Më erdhi me fytyrë të trishtuar, me gjoks të ngushtuar, shfronte dhe flaka veç sa nuk i dilte. I thash: Khajr inshaAllah?

Ma ktheu: Ah, sikur të mos isha martuar, do t'isha i qetë dhe pa brenga.

I thash: Po çka po të shqetëson nga martesja?

Ma ktheu: Ndoshta... diçka tjetër!

I thash: Ke përqellim gruan tënde?

Më tha: Po.

I thash: Çka po ankon nga ajo?

Ma ktheu: Thuaj çka nuk po ankoj në atë!

I thash: Mendon se gjërat çka nuk je i kënaqur prej saj, janë më shumë se ato gjërat që je i kënaqur?

Lëvizi kokën e tij pandërprerë, si mbështetje dhe pëlqim të saj që thash!

I thash: Ndoshta po ankohesh se ajo nuk po të nënshtrohet ty?

Më shikoi në sy dhe më tha: Po.

I thash: Derdhjen e lotëve të shumtë atëherë kur polemizon dhe debaton?

U shfaq tek ai çudia dhe tha: Po, po.

I thash: Edhe inatin e tepërt?

Edhe më shumë iu shtua çudia: Sikur ti të jetoje me ne!

I thash: Po e kthen kujdesin e saj për ty pas kalimit të disa muajve të martesës së parë?

Më tha: Sikur të ka folur për atë dikush, pos meje!

E vazhdova bisedën time, duke e pyetur: Po e kujton kujdesin e shtuar për ty pasi jeni furnizuar me fëmijë?

Më tha: Atëherë ti din gjithçka?!

I thash: Merre veten me të mirë, o vellau im dhe më dëgjo!

U qetësuan nga ai ndjenjat e hidhërimit dhe ngushtimit të cilat iu ishin shfaqur atij, dhe në vend të tyre iu zëvendësua dëshira e vërtetë dhe e qartë për të dëgjuar, dhe më tha: Urdhëro!

I thash: Atëherë kur blenë çfarëdo aparature, si e përdor atë?

Tha: Sipas të dhënave që gjinden në udhëzuesin që e ka përgatitur prodhuesi i saj.

I thash: Mirë, ku i gjenë këto të dhëna?

Tha: Në doracakun e vogël, që gjindet i bashkangjitur me aparaturën.

I thash: Kjo është e bukur. Sikur të supozojmë se një person ka blerë një aparaturë të rrymës, dhe në doracakun e vogël ka ardhur se ajo mund të përdoret vetëm në rrymën me 120volt, megjithatë konsumatori ka lidhur atë me rrymë në 240 volt. Ma ndërpreu dhe më tha: Digjet aparatura menjëherë...!

I thash: Le të supozojmë se një person dëshiron të marrë pjesë në garat e shpejtësisë së makinave me makinën e tij që ecën vetëm 180 km/h përballë makinave që arrijnë shpejtësinë deri në 300km/h .

Me shpejtësi më tha: Nuk do të fitoj në garë.

I thash: Po supozojmë se e kemi pyetur dhe na është përgjigjur se do ta shtypë gasin deri në fund, më tha: Kjo nuk do t'i bëj dobi, le t'i jep gas sa të dojë sepse shpejtësia nuk do të arrij më shumë se 180 km/h.

I thash: Pse?

U pergjigj: Kështu e ka projektuar, projektuesi i saj.

I thash: Edhe Allahu, azze ue xhel-le, kështu e ka krijuar gruan!

Tha: Ç'ke për qëllim, me këtë?

I thash: Ky është mentaliteti i gruas prej të cilës po ankohesh, atë ashtu e ka krijuar Allahu, azze ue xhel-le, dhe sikur të lexoje natyrshmërinë e gruas në doracakun e të dhënave për atë, nuk do të kërkoje nga ajo atë që e kërkon nga mashkulli!

Tha: Cilin doracak të të dhënave ke për qëllim?

I thash: A nuk e ke lexuar hadithin e Muhamedit, alejhi selam: “Dëgjoni porosinë time, ndaj grave bëjuni të kujdesshëm, sepse ato janë të krijuara nga brinjët. Briri anën më të lakuar e ka pjesën e epërme. Po deshe ta drejtosh, ai do të thyhet, e po e le ashtu siç është, do të ngelë i lakuar. Dëgjojeni pra porosinë time për gratë!”

U pergjigj: Gjithesesi, e kam lexuar.

I thash: Më lejo të të them se atë që po e kërkon nga bashkëshortja jote i përngjanë pronarit të makinës që shpejtësia e saj është e kufizuar në 180km/h.

Më tha: Kjo nënkupton se bashkëshortja ime nuk më pergjigjet mua, ashtu siç nuk i pergjigjet makina pronarit të saj, i cili ka shkelur gasin deri në fund që të tejkaloj shpejtësinë e kufizuar në 180km/h?

I thash: Përafërsisht.

Më tha: Çka nënkupton “përafërsisht”?

I thash: Përkujto hadithin e Muhamedit, alejhi selam, kur na ka lajmëruar se vërtet gruaja është krijuar nga brinjët, dhe ky bri është natyrshmëria e gruas, që nëse burri dëshiron ta drejtojë, dështon dhe e thyen bririn.

U pergjigj: Ashtu sikur digjet aparatura që është e prodhuar për rrymën 120volt, nëse e futë në

240volt.

I thash: E ke goditur.

Më tha: Kjo a nuk nënkupton se në gruan ka mangësi?

I thash: Mangësi në një anë dhe begati në anën tjetër, e kjo gjindet edhe tek meshkujt por me një fotografi të përfaqësues, mangësia e gruas krahasohet me bollëkun e burrit dhe bollëku i gruas krahasohet me mangësinë e burrit.

Tha: Ma shpejgo bollëkun dhe mangësinë në çka e ka?

I thash: Kthehu me mua tek briri për të cilin na ka lajmëruar Muhamedi, alejhi selam, dhe përpiqu ta paramendosh atë duke i dhënë gji foshnjës së saj me trup të drejtuar, apo duke e veshëmbathur e përqaftuar atë në gjoksin e saj.

U përgjigj: Kjo është e vështirë, nuk ka mundësi të paramendohet një gjë e tillë që fëmiju të thithë, përveçse duke qenë nëna me trup të lakuar, e as ta veshëmbathë apo ta përqaftoj në gjoksin e saj pa u përkulur.

I thash: Paramendo se çdo përkujdesje e nënës për familjarët nuk bëhet përveçse e përkulur.

U përgjigj: A ky është sekreti i krijimit të gruas nga briri?!

I thash: Po!

## E ke parë Zotin?



E ke parë Zotin?

Një ditë mësimi, një vajzë gjashtëvjeçare po qëndronte në klasë. Mësuesja, atë ditë, derisa shpjegonte teorinë e evolucionit, e pyeti një djalosh:

Kevin, i sheh ato pemë në kopsht?

Kevini: Po, mësuese.

Mësuesja: Kevin, e sheh barin aty jashtë?

Kevini: Po, e shoh.

Mësuesja: Dil jashtë dhe shiko kah qielli dhe më trego a e sheh atë(qiellin)!

Kevini: Mirë. (Pas pak kthehet) Po, e pashë edhe qiellin.

Mësuesja: Shumë mirë, po Zotin a e pe?

Kevini: Jo, nuk e pashë.

Mësuesja: Pikërisht këtë dua ta them. Zotin nuk e shohim, sepse Ai nuk është aty, Ai nuk ekziston.

Atëherë, vogëlushja kërkoi që edhe ajo t'ia parashtronte djaloshit të njëjtat pyetje. Mësuesja i dha leje, ndërsa ajo filloi të pyeste:

Kevin, i sheh pemët në kopsht?

Kevini: Po, i shoh.

Vogëlushja: Po barin, a e sheh?

Kevini: Pooo (u përgjigj i mërzhitur nga pyetjet e njëjta).

Vogëlushja: E sheh qiellin?

Kevini: Pooo.

Vogëlushja: Kevin, a e sheh mësuesen?

Kevini: Po, e shoh.

Vogëlushja: Mirë, po trurin e saj a e sheh?!

Kevini: Jo, nuk e shoh.

Vogëlushja: Atëherë, sipas asaj që mësuam sot në shkollë, ajo nuk ka tru.

## Si e mposhti dijetari (sunni) dijetarët shi'itë ?



Si i mposhti dijetari musliman (sunni) dijetarët shi'itë, me një pyetje të vetme ?

Ky tregim ka ndodhur në kohën e “shahut” të Iranit.

I ka ftuar Shahu dijetarët sunni dhe ata shi'itë, në mënyrë që t'i bashkojë ata mes vete dhe të shikoj se ku është dallimi mes tyre.

Dijetarët Shi'itë erdhën që të gjithë, ndërsa nga dijetarët Sunni nuk erdhi pos njërit, bile edhe me vonesë.

Pasi hyri tek ata, me vete kishte marrur edhe këpucët e tij nën sqetull.

Dijetarët Shi'itë shikuan drejt tij dhe thanë: “Pse hyn tek Shahu duke marrë me vete këpucët e tua?”

Dijetari Sunni u përgjigj: “Kam dëgjuar se Shi'ijat në kohën e Muhamedit, alejhi selam, kanë vjedhur këpucë!”

Dijetarët shi'itë thanë: “Në kohën e Muhamedit, alejhi selam, nuk ka pasur shi'ia!

Dijetari sunni tha: “Atëherë debati mbaroi, nga e keni sjellë shi'izmin e juaj?!”



## Dhurimi pa kufi



Kohë më parë gjendej një pemë e madhe molle. Pranë saj gjendej dhe një fëmijë i vogël, i cili luante me pemën çdo ditë. Ai ngjitej e luante mbi degët e pemës dhe hante prej frutave të saj... më pas shtrihej të flinte në hijen e saj. Fëmija e donte pemën shumë, por edhe pema e donte fëmijën dhe dëshironte të luante me të.

Kohët kaluan... dhe fëmija u rrit. Filloi të mos luante më me të si më parë. Dhe, një ditë prej ditësh, u kthye ky djalë tek pema, ndërkohë që ishte tejet i mërziur.

**Pema:** -Eja dhe luaj me mua!

**Djali:** -Nuk jam më i vogël që të luaj me ty. Unë kam nevojë për disa lojëra dhe nuk kam të holla që t'i blej ato.

**Pema:** -Unë nuk kam të holla, por t'i mund të marrësh të gjitha mollët që gjenden në degët e mia, shiti ato dhe me të hollat e mbledhura ble lodrën që dëshiron.

Djali ishte tejet i lumtur. U ngjit në pemë dhe i mblodhi të gjitha mollët që gjendeshin në pemë, dhe ashtu i lumtur shkoi e u largua.

Por djali më nuk po kthehej, ndaj dhe pema u brengos pa masë! Një ditë djali u kthye sërish, por tashmë ai ishte bërë burrë. Kur pema e pa se po kthehej tek ajo, u gëzua pa masë.

**Pema:** -Eja të luajmë bashkë!

**Djali:** -Nuk kam kohë të luaj, ia ktheu ai... tani jam bërë burrë dhe përgjegjës për familjen, dhe kemi nevojë për një shtëpi ku të mund të strehohemi, a ke ti mundësi të më ndihmosh?

**Pema:** -Sa keq! Unë nuk kam shtëpi, por ti mund të marrësh të gjitha degët e mia dhe me to të ndërtosh një shtëpi.

Burri i mori të gjitha degët që gjendeshin në pemë dhe u largua tejet i lumtur. Edhe pema ishte shumë e gëzuar që e shihte atë të lumtur...por ai nuk po kthehej më tek ajo.

Pema sërish u ndje e vetmuar dhe e kapluar nga trishtimi.

Në një ditë tejet të nxehtë vere, burri u kthye sërish, ndërsa pema si zakonisht ishte tejet e gëzuar.

**Pema:** -Eja luaj me mua, -i tha sërish pema.

**Burri:** -Tashmë jam thyer në moshë... dua të lundroj në çdo vend që të qetësohem.

A ke mundësi të më ndihmosh, -i tha ai, a mund të më japësh një varkë?

**Pema:** -Merr trungun tim dhe ndërto me të një varkë e lundro me të larg... gjeje kështu lumturinë.

Burri e preu trungun e pemës dhe ndërtoi me të një varkë, lundroi me të larg dhe humbi për një kohë të gjatë, por sërish u kthye.

**Pema:** E trishtuar i tha: -Më vjen keq biri im, nuk më gjendet diçka të të jap. Unë tashmë nuk kam më as edhe një mollë.

**Burri:** -S'ka gjë, mua s'më ka mbetur as edhe një dhëmb në gojë që mund ta brej atë.

**Pema:** -Por, unë nuk kam as degë që ti të ngjitesh e të luash.

**Burri:** -Tashmë jam kërrusur dhe nuk mund të ngjitem më.

**Pema:** -Unë tashmë vërtet s'kam asgjë që të mund të jap. Qante e thoshte: -Nuk më ka ngelur gjë tjetër veç disa rrënjëve pajetë.

**Burri:** -Ajo që më nevojitet tashmë, është një vend ku mund të mbështetem e të rehatohem, vërtet jam tejet i lodhur pas tërë këto viteve.

**Pema:** -Rrënjët e pemës plakë, janë vendi më i përshtatshëm për të pushuar, ndaj eja dhe ulu tek unë që të rehatohesh.

Burri u ul mbi rrënjët e pemës, ndërkohë që ajo ishte tejet e lumtur, buzëqeshte dhe lotët e gëzimit i mbushnin sytë.

A e di se cila është kjo pemë?!  
Ajo personifikon prindërit e tu.

Duaji prindërit e tu!

## MJEKESIA NUK E SHEROI POR U SHERUA



Në një dhomë me tre shtretër të bardhe një njeri me vetëdije të humbur qëndronte aty në mes duke mos ndier fare aparatet e frymëmarrjes, të të rrahurave të zemrës dhe aparatet tjera të mjekësisë. Plot një vit duke mos munguar as edhe një ditë të vetme, këtë të sëmurë e vizitonte një grua me një fëmijë 14 vjeç, të cilët ia ndërronin rrobat, pyesnin për shëndetin e tij dhe shikonin të dhënat e fundit për të por pa të reja; ai vazhdonte të mbetej në kome, dhe shpresa për shërimin e tij tashmë kishte përfunduar. Por, para se gruaja dhe fëmija të largoheshin nga spitali i ngrinin duart dhe e lutnin Allahun ta shëronte...

Kështu vepronte për do ditë dhe atë nga dy here. Kjo sikur cuditi pak mjeket dhe personalin e spitalit: Përse e viziton për çdo ditë kur gjendja e tij nuk ndryshon aspak. I folën se vizita e saj ishte e padobishme dhe ia thanë që të mjaftonte me një vizite javore. Gruaja nuk refuzoi dhe çdoherë përgjigjej: Tek Allahu mbështetemi! Një ditë, pak para se gruaja të vinte në vizite, njeriu lëvizti në shtratin e tij dhe nga njeri krahu u kthye në tjetrin, hapi sytë dhe e largoi pompën e oksigjenit nga goja dhe u ul në shtrat. Me pas e thirri infermierën dhe i tha t'ia largonte aparatet për ndihmë emergjente por ajo refuzoi dhe e thirri një mjek kujdestar, i cili së bashku me infermierën u mahniten kur panë njeriun në atë gjendje. Ia bëri disa kontrollime të shpejta dhe pa se njeriu ishte shëndoshë, kështu që urdhëroi largimin e aparaturës dhe pastrimin e vendeve të trupit, në të cilat ishin futur këto aparate. Koha e vizitës filloi. Hyri gruaja së bashku me djalin dhe posa e panë në bashkuan lotët e gëzimit, qarjes, buzëqeshjes dhe falënderimit për Allahun, i Cili e shëroi. Pasha Allahun, kam pritur se një ditë do të vijë dhe do ta gjej duke na pritur kështu në këtë gjendje- tha gruaja. Mjeku iu drejtua gruas: Ky shërim nuk është rezultat i mjekësisë dhe mjeket nuk kanë asnjë meritë në të por pashë Allahun më trego përse vijë nga dy here në ditë dhe çfarë beje? Meqë me bërë be në Allahun do të tregoj: Herën e pare e vizitoja burrin për tu bindur për shëndetin e tij dhe për tu lutur për të. Pastaj shkoja së bashku me birin tim dhe iu ndanim lëmosha fukarave të lagjes me qëllim që Allahu ta shërojë atë.

Allahu nuk e humbi shpresën dhe lutjen e saj kështu që nga vizita e fundit nuk u kthye në shtëpi vetëm me të birin por edhe me bashkëshortin, të cilin ia qumë e ka pritur shtëpia, që t'i kthehet asaj buzëqeshja dhe i zoti i saj... Mësimet e këtij tregimi:

Mbështetja e sigurtë në Allahun duke mos lënë anash edhe shkretëqet që të shpijnë në realizimin e qëllimit. Besa dhe mendimi i mirë për Allahun e Madhëruar.

Lëmosha me qëllim shërimi prej barërave me të mira për shërim. Roli i mjekëve dhe barërave assesit nuk refuzohet, ata janë shkaqe të shërimit porse nuk bënë të harrohet as Shëruesi i vërtetë, Allahu i Madhëruar.

## Nxënësi që lexonte tërë Kuranin për çdo natë



Imam Ahmedit i treguan se njëri nga nxënësit e tij gjatë natës e lexonte tërë Kuranin deri në mëngjes pastaj e falte namazin e sabahut.

Kur dëgjoi imam Ahmedi për të, deshi ta mësonte atë të meditojë gjatë leximit të Kuranit, ngaqë e dinte se Kurani nuk mund të meditohet po qe se lexohet me shpejtësi të madhe, kështu që shkoi tek ai dhe i tha: “Më kanë lajmëruar se ti vepron kështu e kështu...”

Nxënësi tha: “Po, o imam, është e vërtetë.”

Imam Ahmedi i tha atij: “Kur të vijë nata ngrihu dhe lexo Kuran, siç veproje edhe herëve tjera, mirëpo gjatë leximit paramendo sikur më ke afër dhe jam duke të të përcjellë dhe më trego të nesërmen se si ke kaluar!”

Të nesërmen erdhi nxënësi tek imam Ahmedi dhe i tha: “Kam lexuar vetëm 10 xhuza[1] (pjesë) të Kuranit.

Atëherë, imami i tha: “Sonte lexo sikur të jesh para Muhamedit, sal-laLlahu alejhi ue sel-lem!” Nxënësi shkoi dhe kur u kthye të nesërmen i tha atij: “O imam, nuk kam mundur ta përfundoj as xhuzin “Amme”!”

Atëherë, imami i tha: “Shko dhe lexo sonde sikur të jesh duke lexuar para Allahut të Gjithëfuqishëm!”

Nxënësi shkoi i habitur, kurse të nesërmen u kthye duke qarë.”

Imami e pyeti atë: “Çfarë ke o biri im?”

Nxënësi u përgjigj me lot në faqe: “O imam, pasha Allahun, gjatë gjithë natës nuk kam mundur ta lexoj as suren “fatiha” (elhamin)!”

## Plaku i mençur



Një njeri 92-vjeçar, i shkurtër e i pashëm për nga hijeshia sot është duke u shpërngulur në shtëpi të pleqve.

Gruaja e tij 70-vjeçare kishte vdekur këtyre ditëve, kështu që ai duhej ta lëshonte shtëpinë. Pasi që priti disa orë në paradhomën e shtëpisë së të pensionuarve, ai buzëqesh me butësi, meqë i thanë se dhoma e tij tashmë ishte gati për të hyrë ai në të. Përderisa po ecte ngadalë me bastunin e vet për tek lifti, unë po jua përshkruaj dhomën e vogël që iu dha me një çarçaf të varur te dritarja, i cili shërbente si perde.

"Më pëlqen tepër", – thotë ai me entuziazëm, sikur të ishte djalë 8-vjeçar të cilit i dhurohet një këlysh. "ztr. Gagné, pritni një moment se ende nuk e keni parë dhomën, pothuaj se arritëm!". "Nuk ka dert", – ia kthen ai. "Lumturia është ajo që unë e zgjedh paraprakisht. Mobiliet apo zbukurimet e dhomës nuk janë ato që më shtyjnë ta pëlqej atë, porse kjo varet në bazë të asaj se si vendos unë që ta shoh!", – vazhdoi edhe më tej plaku. "Tashmë kam vendosur në mendjen time se e dua dhomën dhe ky është një vendim që e marr sa herë që zgjohem!".

"Unë mund të bëj zgjedhje. Mund ta kaloj tërë ditën në shtrat duke i numëruar të gjitha vështirësitë që i kam me pjesët e trupit të cilat kanë filluar të mos funksionojnë si duhet, ose ndonjëherë zgjohem dhe shpreh falënderime për pjesët tjera që ende më punojnë mirë!".

"Çdo ditë është dhuratë në vete. E përderisa mund t'i hap sytë, do të përqendrohëm në ditën që është e re dhe në gjithë kujtesën time të lumtur që e kam ndërtuar përgjatë gjithë jetës. Për më tepër, mosha e vjetër është si llogari bankare. Pra, në jetën e pastajme, secili e tërheq apo e merr atë që e ka depozituar në këtë jetë! Së këndejmi, këshilla ime është që të depozitoni sa më shumë lumturi në llogarinë tuaj të kujtesës!".

Një djali i vogël pyet Plakun: Cila është gjëja më e fortë në botë?



Djali: Cila është gjëja më e fortë në botë? Plaku: Gjëja më e

fortë në Botë është hekuri, por atë e shkrin zjarri!

Djali: Atëherë gjëja më e fortë në botë qenka zjarri!

Plaku: Jo, thotë Plaku, sepse zjarrin e shuan Uju (apo shiu)

Djali: Atëherë uji qenka më i forti pasi që e shukja edhe zjarrin.

Plaku: Jo, jo ja pret Plaku.... Pasi që Uji nga nxehtësia avullohet dhe bëhet mjegull!!1

Djali: Eh po çka të them!!! Atëherë mos është mjegulla gjëja më e fortë në botë?!

Plaku: Jo jo, assesi, sepse edhe mjegullën e shpërndan era?!

Djali: E pra, e gjetëm qenka era më e forta në botë prishën dhe then çdo gjë!

Plaku: JO thotë Plaku, atë e ndalin malet!

Djali: Po mos është mali pra??

Plaku: Jo birë, sepse atë e pret njeriu!

Djali: Atëher pra më në fund e gjetëm qenka njeriu gjëja më e fortë në botë sepse përballon çdo gjë dhe prish dhe ndërton çdo gjë me duart e tij!!!

Plaku: Jo more birë, nuk është njeriu sepse atë e ndalën VDEKJA!!!

Djali: Qenka Vdekja pra?!

Plaku: I be shpatullave djalit duke i thënë mirupafshim në ahiret birë ja qëlllove tash!!

## Boshllëku-Humbja e zemrës



Adoleshenti vuri re se u përplas me diçka të butë, teksa po ecte në errësirë. Në çast, u përkul të shikonte. O Zot! Ç'të shihte! Në mes të këmbëve, kishte një zemër që ishte nxjerrë me mjeshtri nga thara e saj. Ishte tamam si në fotografi, e gjallë dhe me gjak. Kur e mori në duar, i shfarosur, sa s' çmend nga tmerri. Zemra rijtë dhe ishte e nxehtë.

Adoleshenti deshi të shpëtonte sa më parë nga ajo zemër, e cila iu ngjiti në duar si të merrte situatën e një organi tjetër, por ai u pengua nga ca ndjenja të cilat nuk i kuptonte. Pas pak u qetësua dhe për të gjetur të zotin e kësaj zemre, teologu në portën e shtëpisë më të afërt.

-A është e juaj kjo zemër?-pyeti vajzën e re që shikonte pas zinxhirit të derës.-Se gjeta pak më parë në rrugë.

-Unë zemrën time ia dhash një mirënjohësi që e njoha para tre muajsh,-u përgjigj vajza me një shprehje parajsë. Pyesni në shtëpinë pranë, mund të jetë e tyre.

Shtëpia që tregu vajza ishte një vilë marramendëse. Sherbetori që hapi derën, e mori djaloshin dhe e shoqëroi tek i zoti i shtëpisë në katin e sipërm.

-A është e juaja kjo zemër?-e pyeti djaloshi.-Ende rreh, prandaj...

Zotëria thithi një polemikë nga gota e kristaltë dhe me sytë që i betimin nga të paret, tha duke u marrëveshje:

-Unë zemrën time ia shira kësaj botë. Në shtëpinë bri jeton një nëndrejtorit, ai e di të zotin.

Andadoleshenti vrapoi menjëherë për të kasolla aty pranë me zemrën në duar, e cila nisi të ftohen dhe të ngadalësoje të rahurat.

-A është e juaja kjo zemër?-e pyeti.-Por shpejt ama, pothuajse po pushon së rrahuri.

I moshuari mbylli ngadalë Kur'fan që po lexonte.

-Unë zemrën time ia dhash Allahut, së bashku me çdo gjë tjetër që kisha.-tha ai duke buzëqeshur. Pronarin e asaj që ke në duar, pse nuk ua pyet nënës dhe babait tënd?!

-Që të dy janë plakur dhe lodhur,-tha duke sures djaloshi.

-Ngaqë kërkojnë mbikëqyrje si një fëmijë, bëra shakatë me ta para tri ditë dhe i braktis.

-I braktise, ë?-tha burri plak i mërzhitur.-Domethënë i braktise...

Adoleshenti dukej krejt i qetë nga kjo bisedë. Porse i moshuari e kishte marrë prej kohësh përgjigjen. Eci me hapa të sigurt drejt adoleshentit dhe e kapi me të dy duart nga këmisha, duke e shqyer atë në çast.

Në gjoksin e adoleshentit kishte një boshllëk të gjakosur në madhësinë e zemrës që mbante në dorë.

## Tregohet për një tregtar, një njeri nga të devotshmit.



Tregohet për një tregtar, një njeri nga të devotshmit.

I porositte punëtorët e tij në lokal, që klientëve t’iu tregojnë të metat e mallit, nëse eventualisht kishin ndonjë të metë. Një ditë prej ditësh erdhi një Jehudi dhe bleu një rrobë me defekt, ndërsa pronari i lokalit nuk ishte prezent.

Punëtori tha: Ky është Jehudi, nuk na intereson nëse ia japim me defekt.

Erdhi pronari i lokalit dhe e pyeti për petkun me defekt, e punëtori tha: “Ia shita një Jehudie për 3.000 dërhëm dhe nuk e njoftova për defektin e mallit”.

Pronari pyeti: Ku është ai?

U përgjigj: Ai u kthye me karvanin.

Pronari morri të hollat me vete dhe i shkoi pas karvanit derisa e zuri pas ditëve.

I tha Jehudit: O ti! Ke blerë një rrobë kështu e kështu, ndërsa ajo rrobë ka një të metë; merri paratë e tua dhe ma kthe rrobën.

Jehudi e pyeti: Çka të shtyu ta bësh këtë?

Tregtari i devotshëm i tha: Islami! I Dërguari ynë ka thënë: “Kush na mashtron nuk është prej nesh.”

Jehudiu ia ktheu: Dërhëmët me të cilat pagova ishin fals; atëherë merri 3.000 dërhëm origjinale, e po të shtoj edhe më shumë se kaq dhe tha: “Nuk ka Zot tjetër pos Allahut dhe se Muhammedi, alejhi selam, është i dërguar i Tij”.

Të kapurit për mësimet e fesë Islame është metoda më e mirë për përhapjen e tij, dhe përmirësimin e kuptimit të tij tek jo-muslimanët.

Kujdesu për amanetin dhe sinqeritetin me muslimanët dhe jo-muslimanët.



## Floriri është vetëm për shëmtaraqet!



Një herë e një kohë, një mbret francez nxori një dekret sipas cilit ndalohej veshja e stolive të floririt për të gjithë femrat. Ky verdikt u prit shumë keq nga popullata dhe reagimet qenë të ashpra. Të gjitha gratë refuzuan t'i binden këtij urdhëri të çuditshëm, madje, jo vetëm që nuk iu bindën, por i shtuan dhe më shumë stolitë e arta. Pakënaqësia dhe neveria pikasej menjëherë në fytyrat e tyre. Kjo situatë e tronditi mbretin i cili mbledhi urgjentisht këshilltarët e tij për tu konsultuar. Sigurisht, debati ishte shumë i nxehtë.

Njëri nga këshilltarët i tha me vendosmëri: "Lartmadhëri! Duhet të heqësh dorë nga ky vendim për hir të interesit publik."

Një tjetër ia priti aty për aty: "Jo, kjo do të interpretohej si dobësi dhe tregues frike. Ne duhet të përdorim qoftë dhe forcën për zbatimin e ligjit." Kështu, këshilltarët u ndanë në dy pjesë, mbështetës dhe kundërshtues.

I gjendur ngushtë, mbreti u tha: "Avash, avash! Mos u ngutni, por më sillni të mençurin e qytetit."

Me të mbërritur i mençuri i qytetit, mbreti ia qau hallin që e kishte zënë. I mençuri i tha: "Lartmadhëri! Njerëzit nuk do të binden nëse mendon sipas asaj që kërkon ti dhe jo sipas asaj që kërkojnë ata."

Mbreti e pyeti: "E ç' të bëjmë sipas teje?! Mos u dashka të heqim dorë?!"

I mençuri iu përgjigj: "Jo, por nxirr një urdhër tjetër i cili e ndalon veshjen e stolive të floririt për të gjitha gratë e bukura, të cilat s'kanë nevojë për xhingla mingla për tu zbukuruar. Mandej, nxirr një urdhër tjetër sipas të cilit u lejohet vetëm shëmtaraqeve dhe plakave të veshin stoli floriri, për të mbuluar shëmtinë dhe rrudhat e fytyrës."

Mbretit iu duk mendim i qëlluar ky dhe ashtu veprroi. Brenda pak ditëve pothuaj të gjitha gratë hoqën dorë nga stolitë e floririt dhe secila, kur dilte para pasqyre thoshte: E ku ka nevojë kjo bukuri e rrallë për xhingla mingla floriri!"

Atëherë, i mençuri i tha mbretit: "Vetëm kështu të binden njerëzit lartmadhëri. Vetëm duke menduar sipas mendjes së tyre dhe duke hyrë nga shtegu i ndjenjave mund t'i bësh për vete."

## Nuk do të vije në xhami?



Nuk do të vije në xhami?

Njeriu duke ecur rrugës e pa një mik të vjetër. Ishte dita e premte, thërriste ezani i xhumasë.

- Eja me mua në xhami, i tha.
- Është e xhuma dhe duhet të falemi.
- Ti e di se unë nuk shkoj në xhami, i tha kalimtari.

Njeriu e pyeti:

- E di, por cili është shkaku?

Ai tha:

- Nuk e di. Ndoshta pak ndikon rrethi, por gjithsesi më prishet hekurosja në pantallona gjatë namazit!

Njeriu i tha:

- Mos u mahit, për këtë nuk e fal namazin?

Ai tha:

- Jo, seriozisht. Kujdesem shumë për rrobat dhe e dua ngjyrën e gjelbër. Dhe vërtet kur e vërejti njeriu atë, e pa se kishte rroba të gjelbra të hekurosura bukur.

Njeriu e pyeti:

- A ke shkuar ndonjëherë në xhami?

Kalimtari tha:

- Po, vetëm kur kam qenë fëmijë me gjyshin tim, por tani nuk shkoj fare.

Njeriu u pendua që kishte filluar me të një bisedë të tillë. Por, dy muaj më vonë, njeriu dëgjoji se miku i tij kishte ardhur në xhami. Dhe vërtet miku i tij ishte në xhami para gjithë safëve dhe ishte i veshur me rroba të gjelbra.

Iu afrua ngadalë dhe me zë të ulët njeriu i tha:

- Ke thënë se nuk do të vish në xhami?

Miku nuk fliste fare. Ishte i shtrirë në tabut i mbuluar me mbulesë të gjelbër i përgatitur për t'ia falur xhenazen.... ☩

## Berberi i devotshem dhe humbesi i kuletres



Njërin prej të dashurve të Allahut e pyetën nëse kishte përjetuar ndonjë ngjarje që i kishte lënë shumë mbresa. Ai tregoi këtë ndodhi:

"Kur isha në Mekke-i Mukereme, humba qesen me para dhe ngela në vështirësi, por prisja ca para nga Basra, por nuk po vinin. Flokët dhe mjekra më ishin rritur goxha shumë. Vajta tek një berber dhe e pyeta: "A më qeth për hirë të Allahut, sepse nuk kam para?".

Në atë moment, berberi ishte duke qethur dikë tjetër, por menjëherë më bëri me shenjë një vend bosh dhe më tha: "Ulu aty". E la myshteriu të priste dhe filloi të më qeshte mua. Kur myshteriu, i cili po priste, filloi të bënte fjalë, berberi tha:

"Uli kerkoj ndjesë zotëri. Juve po ju qeth me para, por ky njëri më kërkoi ta qeth për hirë të Allahut. Punët që janë për hirë të Allahut, kanë gjithmonë përparësi dhe nuk kanë ndonjë interes material. Shpërblimin e punës për hirë të Allahut, njerëzit as nuk mund ta dinë dhe as nuk mund ta paguajnë!".

Pasi më qeth, berberi më futi në xhep me zor disa monedha ari dhe më tha:

"Këto i ke për nevojat më urgjente dhe ma bëj hallall, sepse kaq mundësi kam!".

Ditën e nesërme më erdhën paratë që i prisja nga Basra dhe ia çoca verbërit një qese me flori. Berberi tha:

Nuk i mar kurrë! Shpërblimin e punës për hirë të Allahut, robi nuk mund ta paguaj kurrë. Shkoni dhe vazhdoni rrugën tuaj. Allahu ju dhëntë paqe dhe mirësi!"

I kërkova hallallëk dhe u ndava me të, por tash e dyzetë vjet, çdo mëngjes bëj dua për të".

## FËMIJA I LINDUR NË VARR

(Ngjarje interesante në kohën e Omer Inb El Hatabit)



Një njeri dhe djali I tij kishin ardhur tek Emir El-Mu`minin (Komandanti I besimtarëve) Omer Ibn El-Hatab Allahu qoft I kënaqur me të, dhe ata dukeshin njëjloj si një. Omeri r.a ishte habitur dhe ai kishte thënë: Asnjëherë nuk kam pare diçka më mahnitëse se sot.

Nuk mund të them se cili është cili ndërmjet juve dyve, sikur jam duke shikuar në dy sorra (një shembull arab për dy gjëra që duken identike). Atëherë njeriu I tha: Çfarë do të dëshironit të dini? Se nëna e tij ishte e vdekur dhe e varrosur por e lindi atë prej varrit të saj.

Omeri r.a I pëlqente tregimet e çuditshme...

Njeriu I tha: Gruaja ime ishte shtatëzënë me këtë djalin dhe unë duhesha të udhëtoja larg prej saj, kështu që ajo më kishte lutur të mos e lë atë sepse ajo ishte shtatëzënë. Mos u brengos I kam thënë, pastaj e kam vendosur dorën time në barkun e saj dhe kam kërkuar (lutur) nga Allahu: O Allah e lë djalin tim në mbrojtjen Tënde, por harrova të përmend nënën e tij, sepse ishte fati I saj dhe u largova.

Kur u ktheva nga udhëtimi im, kushërinjtë e mi më rrethuan mua dhe më thane: Gruaja jote është e vdekur por ka diçka të çuditshme në lidhje me varrin e saj.

Unë thashë: Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehem. ....

Ata thane: Prej tij (varrit) çdo ditë del një tym... Atëherë thashë: E njoh gruan time shumë mire, ajo është lutur, ka agjëruar, dhe ka adhuruar Allahun me ndershmëri. Kështu që shkova tek varri saj dhe e hapa atë ajo ishte e vdekur, por ajo ishte e ulur në pozicionin e gruas që dëshiron të lindë (fëmijën) dhe ndëgjova një zë duke thënë: Ti I cili ia besov e djalin Zotit që të ta rruaj (mbrojë) mere djalin tend dhe kështu ki djal ka lindur.

Sikur ta kasha lutur Allahun ta ruaj edhe gruan time, ajo nuk do të kishte vdekur tani, por ka qenë kader I saj.

## SHËRIMI I SHPIRTIT TREGIM



Një njeri shkon te Ibrahim ibn Ed-hemi, i cili ishte mjek i zemrave dhe i thotë: “Unë po e teproj me veten time, më trego si të shërohem. Ibrahim i thotë: Nëse i përvetëson katër cilësi, nuk do të jesh mëkatar i madh. Njeriu, i cili kishte nevojë për këshilla tha: “Më këshillo cilat janë, o Ibrahim. I Thotë: “Nëse dëshiron për të mos e dëgjuar (respektuar) Allahun, atëherë mos ha prej furnizimeve të Tij”. Ai njeriu u habit dhe tha me hamendje: “Po çka po thua kështu o Ibrahim, po të gjitha furnizimet janë prej Allahut!?” – “Pasi që është ashtu e ti po e di, atëherë nuk është e drejtë ta shijosh furnizimin e Tij e të mos e dëgjosh, pra të mëkatosh?!” - (Ai përgjigjet) Jo.

- O Ibrahim a më jep këshillën e dytë?

Ibrahimi i thotë: “Nëse nuk dëshiron ta dëgjosh Allahun, mos jeto në vendbanimin e Tij”. Ai njeriu u habit më shumë se herën e parë, e tha: Çka po thua kështu o Ibrahim?! Të gjitha vendbanimet janë të Allahut. Ai i thotë: “Pasi që është ashtu, e ti po e di, - a është e drejtë edhe të jetosh në vendbanimit e Tij edhe të mos e dëgjosh, pra mos të mos mëkatosh?!”. - Jo.

- O Ibrahim më jep këshillën e tretë:

Ibrahimi i thotë: Nëse dëshiron të bësh mëkat, shko në ndonjë vend ku nuk të sheh askush.

- Po si po thua kështu o Ibrahim?! Po Allahu i di të gjitha të fshehtat (e sheh të fshehtën e të hapurën), e dëgjon të ecurit e buburrecit në mes të shkretëtirës, në errësirën më të thellë të natës!

Ibrahimi i thotë: “Pasi që është ashtu, atëherë pse bën mëkat?” Ai thotë: “Nuk do të bëj”.

- O Ibrahim më jep këshillën e katërt:

Ibrahimi i thotë: “Kur të vijë meleku i vdekjes për të ta marrë shpirtin thuaj: “Më jep edhe më afat”.

Njeriu i thotë: “Po çka po thua kështu o Ibrahim, kurse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: “Dhe kur ti vjen (njeriut) çasti i vdekjes, nuk mund ta shtyjë fare, e as nuk mund ta shpejtojë fare”. Atëherë i thotë: “Pasi puna është ashtu, atëherë si shpreson për të shpëtuar?!”. Thotë: “Po”.

- Më jep këshillën e pestë, o Ibrahim .

Ibrahimi i thotë: “Kur të vijnë melekët e xhehenemit të quajtur Zebanije, për të të marrë dhe për të të dërguar në xhehenem, ti mos shko”. Deri sa njeriu dëgjoji këtë të fundit filloi të qajë dhe t’i thotë: “Mjaftë më o Ibrahim, unë kërkoj falje prej Allahut dhe pendohem te Ai, dhe do ta adhuroj deri ne vdekje”.

## Sëmundja e zemrës dhe lëmosha (sadakaja)



Një prej Profesorëve tanë në Universitetin e Mensures është sprovuar me një sëmundje në zemër, kishte udhëtuar në Londër për shërim prej nga mjekët vendosën që ta operonin sa më parë.

Ai thot se kishte vendosur që të kthehej në vendlindje për t'u përshëndetur me familjarët dhe të afërmit, dhe për të lënë disa porosi. Por, para se të udhëton ishte duke qëndruar në zyrën e një shokut dhe përballë saj e shikonte një njëri i cili po shiste mish, ndërsa aty pran një plakë të moshuar e cila po mbledhte copat e rëna nga dhjami dhe kockat.

Thot, dola menjëherë dhe po e thërrisja gruan" Oj nënë, çfarë je duke bërë? Ajo tha ??

Kam gjashtë vajza dhe po mbledh nga copat e rëna në tokë pasi fëmijët ka më shumë se gjashtë muaj që nuk kan ndier erën e mishit.

Fillova të qaja sa gati nuk me doli zemra, kujtoja se si çdo ditë hedhim mish dhe ushqime, e jemi stërngopur dhe sëmurë nga të ushqyerit e tepruar.

Iu drejtova shitësit e i thashë, jepi sa të dojë nga mishi, pastaj ia pagova për një vit të plotë në mënyrë që të mund të vinte gruaja çdo javë dhe të merrte nga mishi aq sa i nevojitej.

Ajo ra në gjunjë, ngriti kokën dhe duart kah qielli, filloje t'i lutej Allahut xh.sh duke qarë.

Allahu xh.sh ia pranoje lutjet kësaj gruaje të gjerë e të devotshme.

Shejh Muhamed Hassan tregon se, i është betuar në Allahun xh.sh që ende pa kaluar një jave është ndier më mire, dhe vendosi të mos udhëtonte.

Familjarët insistituan për të udhëtuar në mënyre që të siguroheshin për shëndetin e tij.

Atje mjekun i cili ishte përgjegjës për kujdesin e shëndetin tim duke shikuar në analizat e mia, kthente shikimin nga unë, shikonte analizat dhe përsëri më shikonte mua duke më pyetur i habitur "A këto janë analizat tua"?

Po, iu përgjigja. Ndërsa ai vazhdonte të shikonte herë analizat dhe herë mua, derisa më nuk mundi ta përmbante veten, filloi të bërtiste, " Çka ke bërë?, Çka të ka ndodhur kështu?". "Unë nuk po shoh asnjë shenjë të sëmundjes tënde, çfarë ke bërë"??!.

Kam bërë tregti me Allahun xh.sh dhe ja më ka shëruar.

Thotë Muhamed Hassani, assesi mos e injoroni lëmoshën, assesi mos përqeshni mirësinë, assesi mos e nënçmoni mirësinë sado e vogël të jetë ajo. Dhe assesi mos e harroni fjalën e Pejgamberit a.s " **Shëroni të sëmurët tuaj me lëmoshë**".

Një grua ka hyrë ne zjarr për shkak të një mace, ndërsa një tjetër në xhenet për shkak të një qeni që i dha ujë pasi ishte tepër i etur, e Allahu xh.sh për këtë ia fali mëkatet e saj!

Njeriun të cilin Pejgamberi s.a.v.s. e përgëzoi me Xhennet përmes ëndrrës



Një nga thirrësit në Islam, nga Arabia Saudite, me rastin e shoqërimit me të rinjtë, e ka treguar një tregim, ndoshta ndër më të çuditshmit. Thirrësi tregon: “Njeriut të cilit i kishte ndodhur kjo ngjarje ma ka treguar rastin si më poshtë vijon... Një natë, thotë e pash në ëndërr Pejgamberin s.a.v.s. i cili më tha: “Të lutem shko tek filan personi, i cili jeton në filan qytet dhe në filan rrugën dhe i thuaj se do te jetë bashkë me mua në Xhennet”. Derisa Muhammedi s.a.v.s. ma sqaronte këtë, unë e pashë shtëpinë dhe rrugën ku jetonte ai. Kur u zgjova, i thash vetit se kjo është ëndërr, edhe një ëndërr në mesin e ëndrrave tjera. Megjithatë, e njëjta ëndërr, në të njëjtën formë në tërësi m’u përsërit edhe natën e dyte, të tretë dhe të katërt. E vërejta se është ne pyetje një gjë serioze.

E morra makinën dhe u nisa në drejtim te atij qyteti. Kur arrita, fillova ta kërkoj rrugën e cila m’u paraqit në ëndërr, dhe me të vërtetë kur kam hyrë në atë rrugë, pash se ishte e njëjta siç m’u kishte paraqitur në ëndërr. Pas një kërkimi të shkurtë, e njoha të njëjtën shtëpi të cilën e kisha parë në ëndërr. Trokita në derë dhe m’u paraqit një person. I dhashë selam dhe e pyeta a është kjo shtëpia e filan personit, ai mu përgjigj, po. Më pas e pyeta, a gjendet ai person në shtëpi, e ai m’u përgjigj: “Po, unë jam vet ai personi që kërkoni”.

E kam shikuar si i habitur atë njeri, ishte i rruar qel...., rrobat e gjata, ia kalonin zogun e këmbës, nuk më dukej si njeri i devotshëm, unë kisha pritur të takoja ndonjë shejh - dijetar, thirrës, por këtë lloj të njeriut, kurrë. Si do që te jetë i thash se kisha diçka për t’i thënë. Njeriu më ftoi ngrohtësisht në shtëpi, më dëshiroi mirëseardhjen dhe ma ofroi çajin. Kur u njoftuam pak më shumë, unë i thash: “Shiko vëlla i dashur, ersha nga larg për ta komunikuar një lajm. Disa net rresht kam par të njëjtën ëndërr. Ty, shtëpinë tënde në këtë rrugë, dhe çdo herë e kam ëndërruar edhe Muhammedin s.a.v.s., i cili më ka përmednur emrin dhe mbiemrin tënd dhe vendin ku jeton dhe më ka porositur që të përgëzoi “Se do jesh bashkë me te në Xhennet!!!”

Njeriu e uli kokën dhe filloi te qaj, u la i tëri në lot. Pas pak, kur erdhi ne vete tha: “Nuk e di se si e kam merituar këtë, pasha Allahun nuk e di, namazin e kryej Elhamdulillah, e falënderoi Allahun, por tani për tani nuk mund të them se kam diçka tjetër të veçantë nga Perëndia, nuk kam, me përjashtim, ndoshta se sa herë që kam fituar diçka, sepse unë jam një taksist, kthehem te fqinjët tanë të cilëve u ka vdekur kryefamiljari dhe bashkëshortja ka mbetur me dy fëmijë jetim,



dhe gjithnjë iu japë gjysmën e fitimeve për t'u ushqyer, përderisa gjysmën tjetër ua lë familjes sime, nëse nuk është kjo, atëherë nuk di çka mund të jete tjetër. "

Ka thënë Muhammedi s.a.v.s.: “Unë dhe ai i cili kujdeset për jetimët, do të jemi bashkë në Xhennet – dhe i ngriti dhe i tregoi gishtin tregues dhe gishtin e mesëm” (Sahijhu-l-Buhari)  
Mundohu të bëhesh si ky njeri!

## Drita e Udhëzimit



Derisa po vija nga një udhëtim i largët, Allahu kishte caktuar që ulësja ime në aeroplan të jetë afër disa të rinjve të shkujdesur të cilët ishin mjaft të zhurmshëm dhe pothuajse kishin mbuluar ajrin me tym duhani.

Nga urtësia e Allahut, aeroplani ishte plotësisht i mbushur dhe nuk munda ta ndërroj ulësen time. Përpjekja për t'u larguar nga problemet me anë të gjumit ishte e pamundur... Kur u bënë më të zhurmshëm fillova të lexoj çfarëdo nga Kur'ani butësisht. Pas pak, këta të rinj filluan të qetësohen. Disa nga ta filluan të lexojnë gazeta e disa nga ta ranë në gjumë.

Papritmas, me një zë pak më të lartë njëri nga ta më tha: "Mjaft! Mjaft!"

Mendova se e bezdisa atë për shkak se zëri im ishte pak i ngritur, kështu që i kërkova falje dhe vazhdova të lexoj vetëm sa veshët e mi dëgjonin. E pashë atë duke e mbajtur kokën me duart e tij, duke mos e zënë vendi vend; lëvizte shumë. Pastaj ngriu kokën dhe me inat më tha, "Të lutem, ndalo. Nuk mund ta duroj!!"

Pastaj ai u ngrit nga ulësja e tij për pak për t'u rikthyer prapë që ta përshëndet me selam dhe t'i kërkon falje. Ishte i qetë, nuk e dija ç'po ndodhte. Pas pak u kthye përballë meje me lot në sy duke më thënë: "Për tri apo më shumë vite nuk e kam vendosur ballin në tokë, por as që kam lexuar ndonjë ajet!"

Gjatë gjithë muajit jam në këtë udhëtim, dhe nuk ka vepër të keqe që nuk e kam kryer. Pastaj të pash ty duke lexuar Kur'an, dhe e gjithë bota ime u kthye në zyrtësi si dhe zemra m'u mbushë me dëshpërim. E ndjeja sikur dikush po më mbyt mua... e ndjeja se çdo ajet që lexonit vinte në trupin tim si kamxhik.

I thashë vetës sime; sa do të zgjasë kjo shpërfillje? Ku do të shpie kjo rrugë? Çfarë do të ndodh pas gjithë këtyre marrëzirave? Pastaj shkova në banjë; e dini pse?

Më erdhi një nevojë shumë e madhe që të qaj!

Unë fola me të rreth teubës (pendimit) dhe rikthimi tek Allahu. U ndje i qetë me këtë.

Kur ateroi aeroplani, ai më ndaloi dhe u duk sikur donte të rrinte larg shokëve të tij. Ai më pyeti shumë seriozisht: "A mendon se Allahu do ta pranojë pendimin tim?" I thashë: "Nëse je i sinqertë dhe serioz në pendimin tënd, atëherë Allahu do t'i fal të gjitha mëkatet tua".

Ai pastaj tha: "Megjithatë, kam bërë shumë gjëra të këqija?"

I thashë: "A nuk ke dëgjuar që Allahu thotë?:"

Thuaj: “O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime vetën tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, pse vërtet, Allahu i fal të gjitha mëkatet, Ai është që shumë falë dhe është mëshirues!” (Kur’an, 39:53)

E pashë pastaj duke buzëqeshur me gëzim si dhe sytë iu mbushën me lot. Pastaj më përshëndeti dhe shkoi. I lartësuar qoftë Allahu!

Pavarësisht sa e madhe është e keqja dhe mëkati i njeriut, në zemrën e tij ka një farë të mirësisë. Sikur të arrinim ta mbjellim ajo do të rritej dhe të bëhet frut, në dashtë Allahu.

Kjo farë e mirësisë gjithmonë lufton në zemrën e njeriut, edhe nëse është e mbështjellur me një shtresë të tekave dhe dëshirave. Kur Allahu dëshiron të mirën e robit të Tij, Ai bën që drita e udhëzimit të ndriçojë në zemrën e tij dhe e udhëzon atë në rrugën e atyre që janë të udhëzuar.

Allahu thotë në Kur’an: “Atë që Allahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për të pranuar Islamin. Atë që dëshiron ta lërë të humbur, zemrën e tij ia bën shumë të ngushtë sikur të ngjitej në qiell. (Kur’an, 6:125).

## Kush e blen Nënë time?



Në natën e martesës, nusja i flet dhëndrit në vesh që ai nënën e tij ta largoj nga podiumi (vend i ngritur si skenë), sepse nuk i pëlqente asaj!

Dhëndri e morri mikrofonin dhe tha: “Kush po e blen nënën time?”

U çuditën të pranishmit në sallë me sjelljen e tij, dhe këtë ai e përsëriti tri herë.

Pas kësaj e hodhi unazën dhe tha: “Unë e blej nënën time”.

U kthye në drejtim të nuses dhe i tregoj asaj se është e shkurorëzuar, dhe tha: Unë e blej nënën time, e morri atë dhe u largua nga salla.

Në vendin e tij u përhap tregimi për veprimin e tij.

Më pas erdhi një njeri tek ai dhe i tha: Unë nuk gjej burrë më të mirë se sa ti, për vajzën time, kështu që e martoi vajzën e tij me të, pa harxhime materiale.

O Allah bëji nënat tona nga banoret e Xhenetit. Amin

## Malik bin Dinar në treg



Një ditë Malik bin Dinari kalonte në treg dhe pa disa fiq të cilët i pëlqyen shumë, nuk e posedonte vlerën e tyre andaj kërkoi nga shitësi i fiqve që t'ia mundësonte pagesën e tyre më vonë. Shitësi e refuzoje këtë ofertë nga Maliku, kështu ai i ofroi lënien e kepuceve të tij derisa t'ia sillte pjesën tjetër të parave, por ja që shitësi edhe kësaj radhe e refuzoje ofertën e Malik bin Dinar-it.

Maliku u largua pa shtuar asgjë më shumë, ndërsa me të larguar të tij njerëzit nxituan për tek shitësi duke i treguar se kush ishte ai. Me të kuptuar këtë shitësi e mori të tërë shportën dhe përmes robit të tij ia dërgoi Malik bin Dinarit. E për të arritur deri tek pranimiti i dhuratës nga Malik bin Dinar, shitësi ia kishte kushtëzuar lirinë robit të vetë me pranimin e dhuratës, nëse Malik bin Dinar e pranon shportën me fiq atëherë robi i shitësit e fiton lirinë.

Djaloshi ishte entuziazmuar teje mase sepse ishte shumë e lehtë që të fitonte lirinë e tij andaj edhe do të jepte tërë mundin e tij për ta bindur Malik bin Dinarin që ta pranonte shportën me fiq në fitim të lirisë.

Me të arritur tek Maliku, djaloshi u çudit me vendosmërinë e Malik bin Dinar në refuzimin e dhuratës, dhe në përpjekje për ta bindur i tregojë edhe kushtin që i kishte vënë zotëria e tij, ndërsa Maliku i tha " Kthehu tek zotëria yt dhe thuaj se Malik bin Dinar nuk e hanë Fenë për Fiq, dhe se Maliku ia ndaloj vetës ngrënien e fikut deri në Ditën e Gjykimit". Ndërsa djaloshi ende po vazhdonte ta bindte andaj edhe i tha " Zotëri të lutëm merre sepse në të është liria ime".

Ndërsa Malik bin Dinar ia ktheu: "Nëse në të është liria jote, në të është po ashtu robëria ime", kjo sepse Malik bin Dinar e kishte kuptuar se qejfi i tij e kishte tradhtuar, egoja e tij donte ta robëronte dhe se stomaku i tij e kishte nënçmuar andaj edhe ia ndaloj vetës ngrënien e fiqve deri në Ditën e Gjykimit në mënyrë që ta edukonte dhe ta nënshtonte epshin e vetë.

Dobia nga tregimi: Si të mos e kemi ne këtë vendosmëri kur e dimë se e kemi pasuar shejtanin dhe na kanë tradhtuar e nënçmuar epshet tona. A thua si mund t'ia lejojmë vetës të jemi kështu të përulur e të mos ia zgjasim dorën e ndihmës dhe ta shpëtojmë vetën tonë nga moçali i turpit./mesazhi/

## Amaneti i mbretit



E para: Të mos e bartin kufomën time pos mjekët dhe askush pos tyre.

E dyta: Rrugës prej vendit të vdekjes-deri tek varrezat të hedhin copa ari, argjendi, diamante, elmaze të cilat i kam mbledhur gjatë gjithë jetës.

E treta: Kur ta ngrehni kufomën time lartë në tabut, m' i nxirrni dy duart e mia jashtë qefinit dhe të varura.

Kur mbreti mbaroi amanetin e tij, u ngrit gjenerali dhe puthi dy duart e tij, i afroi afër gjoksit të vet, e pastaj tha: Do të shkojnë në vend amanetet e tua dhe pa asnjë mangësi, por zotëria im, më trego enigmën e këtyre tre amaneteve?

Mbreti morri frymë thellë dhe u përgjigj: Dëshiroj që botës t' i jap një mësim që unë nuk e kam kuptuar deri më tani.

Sa i përket amanetit të parë: Dëshiroj që njerëzit e botës ta kuptojnë se kur vie vdekja nuk mund ta largojnë mjekët, të cilët kur (ne) sëmureshim iu drejtoheshim atyre, se jeta e shëndeti janë pasuri që nuk mund t' i dhuroj ato dikush nga njerëzit.

Sa i përket amanetit të dytë: Dëshiroj që njerëzit e botës ta kuptojnë se çdo kohë që kemi harxhuar në mbledhjen e pasurisë nuk ka qenë pos hi e pluhur, dhe se ne nuk marrim me vete as copëzat e arit.

Sa i përket amanetit të tretë: Dëshiroj që njerëzit e botës ta kuptojnë se ne kemi ardhur ne këtë botë duar bosh, dhe do ta lëmë ashtu, duar bosh!

Kjo është bota.

A ka kush mediton?!!!

## Hoxhën e devotshëm që nuk mundi ta prishë shejtani e prishi një grua!



Tregohet se në një vend paska jetuar një hoxhë i devotshëm i cili jetën e tij e jetonte në përputhshmëri me rregullat islame. Kështu që shejtani në fytyr të njeriut assesi ta mashtronte këtë hoxhë të ndershem. Shkurja dhe ardhja pa efekt e kishte lodhur shejtanin pa masë dhe ja kishte vështirësuar gjendjen.

Çuditërisht kalimin e shpesht të shejtani, e kishte vërejtur një grua, të cilës i kishte zgjuar interes kjo çështje, saqë që një ditë prejditëve, për ta shuar kureshtjen e ndal në rrugë njeriun e panjohur dhe e pyet se ku shkon dhe çka bënë që çdo ditë kalon këtupari?!

Atëherë shejtani i mallkuar i tregoi kësaj gruje kureshtare se në një lagje ka një hoxhë të devotshëm që askush nuk mundet ta mashtron edhe pse i ka përdorur të gjitha metodat dhe se kjo gjë e ka lodhur jashtme.

Gruaja kur dëgjoji këtë rast i tha kjo është shumë e lehtë për tu bërë dhe se u zotua se ajo do ta bënte një gjë të tillë pra do ta prishte hoxhën e devotshëm, nëse ai i premtonte diç të vlerave për kundërshtimin.

Pasi që shejtani i mallkuar i premtoj shumëçka si shpërblim, kjo grua mendjelehtë shumë shpejt e hartoi planin e prishjes së hoxhës dhe u vu në aksion pra shkoj për ta punuar atë plan të mallkuar. Mori me vetë djalin e vet të vogël një shishe alkooli dhe një gjin dhe shkoi të hoxha ta realizoi planin qëllimkeq.

Kur shkoi të hoxha i tha hoxhës se ka ardhur ta fryn djalin, kur hoxha e pranoi brenda ajo menjëherë me të afruar afër hoxhës nxjeri thikën dhe ja vendosi djalit të saj në fytyrë duke ju kërcnuar se do therte nëse hoxha nuk do ta pinte atë shishe alkooli!

Hoxha u mendua pak dhe tha sikur ta ther djalin do të bëhet me keq dhe zgjodhi atë me pak të keqe pra me e pirë atë shishe alkool dhe pastaj do të kërkonte Allahut xh.sh falje, mirëpo hoxha i pa shër nuk e dinte dredhinë e kësaj gruaje të mallkuar e cila priti që hoxha ta pinte shishen e alkoolit dhe sa e piu hoxha ajo e vepron atë që kishte menduar ta vepronte pra e theri djalin e vet për ta fajësuar hoxhën.

Pasi e theri menjëherë ja nisi të vajton dhe të bërtet e të thotë hoxha ma therri djali pasi që ishte i pime pra nën ndikim të alkoolit....

Të gjithë u habitshin me këtë fakt sepse e njihnin për të devotshëm e nuk u besonin syve e as veshve të tyre, të ngritur nuk e dinin dredhinë që kishte përgatitur ajo grua.

Shumë shpejt ja mriti edhe policia e cila hetoi rastin si dhe konstatuan se hoxha mesiguri është nën ndikim të alkoolit dhe pranuan akuzën e therrjes së fëmijës meçrast hoxhën e burgosën e turpëruar ndërsa, grua e cila bëri këtë dredhi humbi djalin duke shpresuar në shpërblimin e

shejtanit refuzoi dhuratën e Allahut xh.sh djalin e saj dhe humbi besimin u bë vrasëse.  
Kalonin ditë e netë kaloi periudhë e gjatë shejtani që ja kishte premtuar dhuratën nuk u duk më,sepse nuk kishte më nevojë,sepse detyrën që u ishte ngarkuar për prishjen e hoxhës ja kishte kryer kjo grua mendje lehtë dhe atë vullnetarisht.

Një ditë pas shumë kohë ,gati duke u harruar ngjarja,papritmas rruga e pruri tek kjo grua.Kur e pa e Fiore shumë u gëzua sa nuk fluturoi nga gëzimi,dhe i thiri nga kati i tret,bëri ku je ti që dje duk me ,ku e ke dhuratën e premtuar?!...Unë premtimin e çova në vend,mbeta pa djalë hoxhën e prisha dhe e çova në burg,ti ku je tash?!

Atëherë shejtani priti e tha a po kam dëgjuar,me fal kam harruar me ta pri dhuratën çetash ta bi sahora rri ku je.

Shkoj shejtani dhe shumë shpejt u kthy me një shkop shumë të gjatë ku e kishte vendosur dhuratën e çmuar e që ishin një parë opinga këpucë mbathje antike,dhe ja çoi gruas e cila e prite në katin tret të shtëpisë se saj.

Ia zgjati shkopin i cili ariti deri ku ishte ajo dhe i tha mere dhuratën e premtuar!

Kur e pa ajo ju ndal fryma dhe me gjysëm zëri i tha a për këtë dhuratë mbeta pa djalë dhe prisha dhe burgosa një hoxhë?!

Shejtani i mallkuar i tha pikerishtë për këtë,edhe ajo është shumë!

Gruaja i tha:Mirë po pse sma jep në dorë,po me këtë shkop të gjatë nga lartë?

Shejtani i tha:Pasi që ti ishe shumë me e rrezikshme se unë!,Unë shejtan nuk munda ta prish,ti e prishe!

Gruaja u pendua shumë,por pa dobi ngase ishte shumë vonë mbeti pa djal,pa shpërblim si dhe tek Allahu u bë me e keqe se shejtani dhe e pret dënim i dhimbshëm tek Allahu.

Andaj thonë gratë për një gjë me vlerë të vogël e bëjnë një sher të madh,sepse mendojn shkurt ngase kan flok të gjata mend të shkurta pak shaka.

Allahu na ruajt nga sherri i lloit të këtyre grave.



## Dijetari dhe student



Një dijetar e pyeti studentin e tij: Sa vjet u bën që më shoqëron mua?

Studenti: 33 vjet.

Dijetari: Çfarë ke mësuar prej meje gjate kësaj kohe?

Studenti: Kam mësuar tetë gjëra.

Dijetari: Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi!- tha i çuditur. Më kaloi jeta me ty ndërsa ti nuk ke mësuar më shumë se tetë gjëra.

Studenti: Nuk kam mësuar tjera dhe nuk dua te gënjejë.

Dijetari: Atëherë m'i thuaj ato tetë gjëra që paske mësuar prej meje!

Studenti:

1. Vrojtova dhe shikova me kujdes në krijesa dhe pashë se secili prej tyre ka nga një te dashur por kur të shkojë te varrezat i dashuri ndahet prej tij/saj, kështu që unë të dashur caktova veprat e mira që kur të hyjë në varr edhe ato të hyjnë me mua.

2. Analizova thënien e Allahut: E kush iu frikësua paraqitjes para Zotit të vet dhe ndaloi veten prej epsheve, 41. Xheneti është vendi i tij”. (en-Naziat, 40-41), kështu që dhashë mund e derdha energji për ta larguar epshin në mënyrë që shpirti im të përqendrohet në adhurim për Allahun.

3. Pashë se njerëzit që kishin gjera të çmuara dhe me vlere i ruanin ato që të mos humbnin. Pastaj meditova fjalën e Allahun: Ajo që e keni pranë vetes është e përkohshme, e ajo që është te All-llahu është e përjetshme...”. (en-Nahl, 96), kështu që sa herë që në dorën time binte ndonjë e mire e drejtoja kah Allahu që të ruhet tek Ai.

4. Shikova në krijesa kur ja pashë se tërë ata mburrëshin me pasuri, familje ose prejardhje, pastaj

shqyrtova fjalën e Allahut: ...e s'ka dyshim se te All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat), “. (el-Huxhurat, 13), kështu që iu qasa devotshmërisë që të jem i ndershëm tek Allahu.

5. Pashë se njerëzit fyenin dhe mallkonin njëri tjetrin dhe tërë këtë si shkak i zilise-smirës (hasedit). Meditova fjalën e Allahut: ... Ne kemi përcaktuar ndër ta gjendjen e jetës në këtë botë...”. (ez-Zuhruf, 32), kështu që e braktisa zilinë ngase u binda se ndarja e dhuntive bëhet nga Allahu i Madhëruar.

6. Pashë njerëzit duke u armiqësuar, bërë padrejtësi dhe luftuar njëri tjetrin. Shikova fjalën e Allahut: Djalli është armik i juaji, pra edhe ju konsiderojeni armik...”. (Fatir, 6), kështu që braktisa armiqësinë ndaj njerëzve dhe fillova të ushtroj armiqësinë time vetëm ndaj djallit.

7. Pashë se njerëzit për ta fituar idaren (furnizimin) bënë çdo gjë, madje edhe gjëra të paligjshme. Shikova thënien e Allahut: Nuk ka asnjë gjallesë në tokë që All-llahu të mos ia ketë garantuar furnizimin e saj...”. (Hud, 6), kështu që u binda se unë jam një prej këtyre gjallesave të shumta që Allahu ka përsipër furnizimin e tyre kështu që furnizimin tim që kam tek Ai e lashë (i bindur se do ta arrije atë në mënyrë të ligjshme).

8. Shikova krijesat dhe pashë se secili prej tyre mbështetej në një krijesë të ngjashme me të; ky për pasurinë e tij, ky për gjënë e humbur të tij, ky për shëndetin e tij, ky për qendrën e tij... Pastaj iu referova fjalës së Allahut: ...Kush i mbështetet All-llahut, Ai i mjafton atij...”. (et-Talak, 3), kështu që i ika mbështetjes në krijesa dhe punova në drejtim të mbështetjes vetëm në Allahun e Madhëruar!

## Pse qante Enes ibn Maliku?!



Transmetohet se sa here që është përmend qyteti i Testerit, një nga qytetet e fortifikuara të Persisë, Enes bin Maliku çdo herë qante.

Këtë qytet myslimanët e kishin rrethuar për plot një vit e gjysmë, më pas ky qytet ra në duart e myslimanëve dhe atyre iu mundësua realizimi i fitores dhe çlirimi i qytetit. Ky çlirim llogaritet si një nga çlirimet më të vështira të myslimanëve.

Nëse gjendja është kaq e bukur dhe kaq e shndritshme për myslimanët atëherë a thua pse vallë Enes bin Malik r,a qante çdo here kur ai e kujtonte çlirimin e Testerit ??

Porta e këtij qyteti ishte hapur në orët e hershme të mëngjesit, diku pak para se të agoi dielli, myslimanët zunë të futën në fortesë dhe një betejë e vrulltë ndodhi në mes të treqind mijë myslimanëve dhe njëqind e pesëdhjetë mijë persianëve, çdo çast në vete ngërthente vdekjen, çdo sekondë mund të kthehej në fatkeqësi dhe në katastrofë për ushtrinë çlirimtare të myslimanëve.

Gjendja ishte shumë e vështirë..... Një krizë prej më të rëndave..... Një situatë shumë e rrezikshme...

Por, në fund- Me mirësinë e Allahut xh,sh- myslimanët arritën fitoren, arritën një fitore të oshtimë mbi armikun e tyre, fitore kjo që erdhi pak çaste pas agimit të diellit.

Myslimanët e kuptuan se namazi i mëngjesit ju kishte kaluar në këtë ditë të tmerrshme !!

Myslimanët nuk kishin arritur që në këtë gjendje kaq të rëndë, në kohën kur shpatat ju fërfëllonin mbi kokat e tyre, në tmerrin brenda fortesës që të falnin namazin e sabahut në kohë !!

Enes bin Maliku r,a, qante sepse e kishte humbur namazin e sabahut, qante sepse kjo i kishte ndodhur për herë të parë gjatë gjithë jetës së tij, qante edhe pse ishte i arsyetuar, qante edhe pse ushtria e myslimanëve kishin justifikim, qante edhe pse ata ishin të preokupuar me luftën, qante edhe pse ata ishin në xhihad, qante sepse ajo që kishin humbur ka një vlerë të madhe...??!!

Enesi r,a thoshte: Çka po më duhet ky qytet, unë kam humbur namazin e sabahut? Për Allahun sikur të më jepej e bota me krejt çka në të nuk do ta ndërroja të at namaz që më humbi??!!

## Qëndrim i veçantë



Shejh Muhamed Gazali, rahimehullah, thotë:

“Një njeriut i cili ishte mësuar të pinte alkool i thashë:

A nuk pendohesh te Allahu, a nuk e braktisë këtë pije?

Më shikoi i thyer, i lotuan sytë e më tha:

Lute Allahun për mua.

Analizova gjendjen e këtij njeriut e mu zbut zemra...

Qarja e tij ishte manifestim i vetëdijes se sa ka gabuar karshi Allahut, mërzia, ishte i mërziur shumë për kundërshtimin e urdhrave të Allahut, kishte dëshirë të flaktë për tu përmirësuar...pra, qenka një besimtar me bindje, por ja, që Allahu e paska sprovuar!

Ky njeri synon shpëtimin nga kjo gjendje dhe kërkon ndihmë prej meje për të arritur në këtë synim...

I thash vetes: ndoshta edhe gjendja ime i ngjanë gjendjes së tij, ose ndoshta është edhe më e keqe. Vërtetë unë kurrë nuk kam pirë asnjë pikë alkool, por ambienti në të cilin kam jetuar, nuk e njihnte alkoolin, mirëpo ndoshta kam pirë alkoolin e neglizhencës, i cili më shkujdesi nga Zoti im dhe më bëri t’i harroj obligimet që i kam karshi tij... Ai qanë për mangësitë e tija, kurse unë dhe të ngjashmit me mua nuk qajmë për mangësitë tona... Mos vallë jemi mashtruar me veten tonë?!

Iu drejtova përsëri këtij njeriut, i cili kërkoi prej meje t’i lutem Allahut që ta lë alkoolin, e i thash: eja së bashku t’i lutemi Allahut për ne:

**“Zoti ynë, ne i bëmë të padrejtë (i dëmtuam) vetvetes sonë, në qoftë se nuk na falë dhe nuk na mëshiron, ne me siguri do të jemi prej të shkatërruarve!” (El-A’raf: 23).**

## Hoxha dhe papagalli



Një hoxhë i mësonte nxënësit e tij “Akide-Besim”, ua mësonte atyre fjalën La ilahe ilallah dhe ua komentonte.

Një ditë prej ditëve njëri nga nxënësit ia solli dhuratë hoxhës një papagall sepse ai ishte i dhënë pas ruajtjes së maceve dhe zogjve.

Hoxha filloi ta duaj papagallin dhe njëherit ta marrë me vete në mësimet e tij, derisa papagalli mësoi shqiptimin e fjalës La ilahe ilallah, dhe papagalli e përsëritte shehadetin-dëshminë, ditë e natë.

Një ditë kur erdhën nxënësit tek hoxha, e gjetën atë duke qarë, dhe kur e pyetën pse po qanë? u përgjigj: macja e ka mbytur papagallin.

Nxënësit i thanë: a për këtë po qanë?! Nëse dëshiron do ta sjellim një tjetër në vend të tij, edhe më të mirë se ai; ndërsa hoxha ia ktheu: Nuk po qaj për këtë, por kur macja e sulmoi papagallin filloi të britte dhe të lëshojë zë tjetër derisa ngordhi, edhe pse ishte nga ata që shumë shpesh e thoshte fjalën “La ila ilallah”. Kur e sulmoi macja, harroi shehadetin dhe filloi të britte, sepse ai e thoshte vetëm me gjuhën e tij, ndërsa zemra e tij nuk e ndjente e as nuk e dinte.

Pastaj hoxha tha: Frikohem se mos jemi sikurse ky (papagalli), e kalojmë jetën duke e përsëritur shehadetin me gjuhët tona, e kur na vjen vdekja e harrojmë sepse zemrat tona nuk e kanë njohur mirë.

Nxënësit filluan të qajnë nga frika e mos sinqeritetit me fjalën “La ilahe ilallah”.

Ne, a e kemi mësuar fjalën “La ilahe ilallah” si duhet, a i kemi mësuar kushtet, vaxhibitet dhe kuptimet e saja?

O Allah na forco me fjalën “La ilahe ilallah” në këtë botë dhe botën tjetër.

## Plaku i urtë dhe udhëtarët e trenit



Dr. Muhamed El-Arifi A e keni dëgjuar apo lexuar ndodhinë e "Plakut të urtë dhe udhëtarëve të trenit"? Nëse jo, atëherë lexojeni tani!! Është shumë ekspresive !! Shumë domethënëse !! Është shumë specifike për secilin prej nesh !! Unë, ti, ai dhe ajo sigurisht se na ka rastisur që ta përjetojmë këtë ngjarje për çdo moment.

Kjo ngjarje ka ndodhur në një tren udhëtarësh, një ditë kur kishte rënë bilbili që sinjalizoi kohën e nisjes dhe të gjithë udhëtarët kishin hipur në tren me përjashtim të plakut të urtë i cili arriti me vonesë por që fatmirësisht nuk e humbi trenin.

Plaku i urtë arriti që me vështirësi të hipte në tren dhe me të hipur pa se njerëzit kishin zënë vendet e tyre andaj u drejtua drejtë kabinës së parë në të cilën gjeti disa fëmijë që po loznin dhe tallshin ndërmjet veti. I përshëndeti me Selam, ata u gëzuan sapo e panë fytyrën e ndritur të plakut, fytyrën e cila po shndrite nga nuri i pleqërisë dhe flokët e thinjura të plakut ia shtonin edhe më shumë dritën këtij nuri në fytyrën e tij, i cili para tyre u shfaq me prestigj, urtësi dhe dinjitet. Mirë se vjen xhaxha, gëzohemi që të shohim, ishte përgjigjja e fëmijëve. Ndërsa plaku i pyeti se a e lejonin të ulej në kabinën e tyre? Një njëri si ti e bartim mbi kokat tona, u përgjigjen fëmijët, por... por... ne jemi fëmijë, jemi ende të vegjël, jemi ende duke u rritur dhe kemi dëshirë të lozim e të tallemi në mes veti andaj frikësohemi se mos po të pengojmë, mos po të shkaktojmë zhurmë dhe kjo të sjellë pakënaqësi, mandej vetë prezenca jote na bënë të ndihemi ngushtë dhe kjo na e kufizon lirin tonë për të luajtur. Andaj pse nuk shkon tek kabina tjetër, atje me siguri se të gjithë do të presin me gëzim prezencën tënde. Ky ishte arsyeimi i fëmijëve dhe plakut të urtë nuk i mbeti gjë tjetër vetëm se të drejtohet drejt kabinës së dytë në të cilën gjeti tre djelmosha që në dukje dukej të ishin nga fundi i shkollës së mesme, me vete kishin mjete llogaritëse dhe trekëndësha, ishin shumë të zënë me zgjidhjen e ekuacioneve matematikore dhe diskutimin rreth teorive fizike. I përshëndeti me Selam. Ah, sikur të shihje gëzimin në fytyrat e tyre, ishin shumë të lumtur me të parë plakun fytyrë-ndritur, e përshëndeten dhe i uruan mirëseardhje duke shfaqur shenjat e gëzimit, " Mirë se vjen njëri i urtë ", u shprehen djelmoshat.

Plaku i urtë u kërkoi leje për tu ulur, ndërsa djelmoshat ia kthyen " Është nder dhe kënaqësi për

ne por siç po e vëreni edhe vetë ne jemi të zënë me zgjedhjen e disa ekuacioneve dhe përgatitjen për provimet e fund vitit andaj kemi frikë se mos ndoshta mund të e humbim kontrollin dhe të ngremë zërin duke të bërë zhurmë e kjo nuk do të te le të qetë dhe nuk do të mund të ndiesh rehat e po ashtu edhe ne ndoshta do të ndihemi në siklet me prezencën tende dhe nuk do të mund të e shfrytëzojmë këtë udhëtim që të përgatitemi për provimet e fund vitit, por pse nuk shkon tek kabina tjetër se me siguri se do të gjeni vend pasi që çdo kush që e sheh këtë fytyrë nurë do të ketë nderë që të shoqërohej me të.

Plaku i mbështetur në Allahun xh,sh u drejtua për tek kabina tjetër në të cilën gjeti një burrë dhe një grua që dukej se ishin në muajin e mjaltit, pasi që dëgjohej fjalë romance, shprehje ndjenjash për dashuri, qeshje etj. I përshëndeti ata me selam dhe u kërkoi leje për tu ulur. Por arsyetimi ishte i njëjtë, dhe kështu plaku vazhdoi kërkimin e një vendi të lirë në tren derisa arriti në kabinën e fundit dhe në të gjeti një familje në përbërjen e të cilës ishin prindërit dhe fëmijët e tyre, i përshëndeti ata me selam dhe për çudi ende pa kërkuar prej tyre leje që të ulej babai i tha njërit prej djemve të tij që të ulej në prehrin e vëllait, ndërsa tjetrit që të e largonte çantën dhe të ulej në prehrin e nënës kështu që i liruan vendin plakut të urtë.

E falënderoi Allahun xh,sh që më në fund gjeti vend që të ulej pas gjithë asaj lodhje që pati duke kaluar sa në njërin në tjetren kabinë.

Treni u ndal në një nga stacionet e tij, në tren hipi një njëri i cili po shiste ushqime të gatshme, plaku e thirri dhe kërkoi që ta shërbente familjen me at që dëshironin për të ngrënë ndërsa për veti mori dy sandviçë me djathë. Familja mori at që dëshirojë, ndërsa të gjithë kishin mbetur të stepur, të gjithë thoshin në vetën e tyre se ai donte të ulej me ne por..., por nuk mbarojë me kaq...?? Plaku qerasi familjen edhe me pije, me pemë dhe me revista..., por çudia e mbërriti kulmin e saj kur treni ndaloi në një nga stacionet e tij e që ishte me ndryshe se zakonisht.

Stacioni ishte i stërm bushur me ushtarak, burrështetas, gazetarë, ishte i zbukuruar teje mase, treni ndaloi dhe në të hipi një gjeneral i cili kërkoi nga udhëtarët që të mos lëviznin derisa të zbriste mysafiri i mbretit pasi që mbreti vetë kishte dal në pritje të tij. Të gjithë ishin shtangur në pritje të mysafirit, dhe për çudinë e të gjithëve mysafiri i mbretit ishte pikërisht plaku të cilin nuk e lejuan të ulej në kabinat e tyre. Plaku i urtë nuk pajtojë që të zbriste vetëm se në shoqërimin e familjes e cila i bërë vend që të ulej në mënyrë që mbreti të i shpërblente vetë.

Mbreti u pajtua që ti nderonte, i mori dhe i vendosi në hotelin mbretërorë për tri ditë, familja u kënaq duke shijuar pamjet e mrekullueshme të kështjellës mbretërore, duke shijuar gostinë, dhuratat dhe mikpritjen mbretërore ndërsa njerëzit kishin humbur shumë, ata të cilët nuk deshën ta lejonin plakun që të ulej me ta kishin humbur shumë.

Tani, pasi u kënaqëm me shoqërimin e këtij tregimi mbresë lënës, dua të ju pyes se a e keni

kuptuar se kush ishte plaku i urtë apo jo?? Dhe pse në fillim ju thash se ky tregim është shumë specifik për secilin prej nesh dhe se të gjithë ne e kemi jetuar këtë ndodhi.

E dije se të gjithë ju e njohët atë, dhe e kuptuat qëllimin tim nga ky tregim. Plaku i urtë nuk është askush tjetër pos kësaj feje, dhe udhëtarët e trenit jemi të gjithë ne të cilët nuk kemi dëshirë të qëndrojmë afër fesë duke rënë kështu nën ndikimin e preokupimeve të kësaj bote dhe cytjeve të djallit të mallkuar i cili mundohet të na largojë nga kjo fe. Djalli sado që të mundohet të na largojë nga kjo fe, dhe sado që të mundohet të na bëjë këtë fe si të padobishme dhe jo të mirë, ai nuk do të mund të ia arrijë qëllimit nëse ne i mbështetemi Allahut xh,sh.

Ah, sa e mirë është përpikëria në fe por ja që ende janë fëmijë dhe duhet ti lëmë që të marrin nga kënaqësia e lojës dhe dëfrimeve në mes tyre e kur të rritën edhe pak atëherë do të i përmbahen kësaj feje !! Ah, sa e mirë është kjo fe por ja që ata janë student dhe janë të zënë me mësim dhe provime andaj leri vetëm të mbarojnë dhe mandej do të fillojnë të e praktikojnë këtë fe. Ah, sa e mirë është përpikëria në fe por ja që ne ende jemi në muajin e mjaltit dhe po sa ta përfundojmë do të i përmbahemi kësaj feje. Apo, jemi të zënë me planet jetësore, tani sapo kemi hapur biznesin dhe vetëm sa të forcohem pakëz dhe menjëherë do ti kthehem fesë dhe obligimeve të saj. Feja është shumë e mire dhe që nesër do të filloje të i përmbahem, por ne nuk po e realizojmë at që jemi obliguar të e përmbushim për këtë arsye ne po dështojmë në ndërtimin e të ardhmes në këtë botë e po ashtu edhe në të ardhmen. Jeta po kalon e ne ende jemi duke u menduar, nesër do filloje... do fillojë vetëm sa të mbaroje shkollën... do filloje me mbarimin e studimeve... ja vetëm të martohem dhe menjëherë do të filloje... vetëm të gjeje një pune dhe menjëherë do të filloje... vetëm sa... vetëm sa...

Jeta po kalon ndërsa ti ende po mendon, ende nuk po ja fillon...



## Plaku dhe djali i tij i burgosur



Një burrë i shtyrë në moshe jetonte vetëm, dëshiroi të mbjell patate në kopshtin e shtëpisë, por mosha e kishte bërë të veten, ai nuk mundej. Kështu ia dërgoi një letër djalit, i cili ishte i burgosur:

Djali im i dashur Ahmed!

Dëshiroja që ti të ishe me mua, të më ndihmosh ta punoja bahçen, e ta mbjella me patate. Nuk ka kush që më ndihmon.

Pas një kohë babai pranon letër nga djali:

I nderuari baba!

Të lutem, mos gabo që ta punosh bahçen, ngase unë kam lënë diçka shumë me vlerë. Kur të dal nga burgu do të tregoj se çka është. (djali juaj Ahmedi)

Nuk kaloi as një orë pasi që arriti letra në shtëpi, njerëzit e policisë, sigurimit të mosadit, ushtria çifute, e rrethuan shtëpinë, filluan të gërmojnë e gropojnë në bahçe, pëllëmbë për pëllëmbë. Nuk gjetën asgjë dhe më pas shkuan.

Ditën tjetër nga djali përsëri erdhi letra tjetër:

I respektuari baba!

Shpresoj që toka është punuar mirë (përgatitur), kjo ishte ajo që mundë të të ndihmoja. Nëse ke nevojë për diçka tjetër të të ndihmoj, më trego.

Ju kërkoi falje për mungesën time.

## Ekstremisti dhe Dijetari



RRËFIMI I SHEJH DR. MUHAMMED HASSANIT ME NJË

### EKSTREMIST

Ishim duke polemizuar me një të ri ekstremist, të cilin, në bisedë e sipër, e pyeta: A mendon se lejohet hedhja në erë e ndonjë lokali nate në ndonjë vend islam?

Po, si jo, hallall, vrasja e tyre është e lejuar – mu përgjigj pa hezitim.

Po, nëse ti i mbyl -vazhdova me pyetje- duke qenë ata ashtu në mëkate, çfarë mendon, cili do të jetë fundi i tyre? Xhehennemi, natyrisht – mu përgjigj. Po djalli i mallkuar, për ku vallë dëshiron t'i dërgojë ata? – e pyeta. Për në Xhehennem, sigurisht –u përgjigj. Atëherë ju dhe djajtë po ndakeni të njëjtin qëllim, pra futjen e njerëzve në ferr – i thashë. Ia përkujtova thënien e Muhammedit [alejhis salatu ves selam] me rastin e kalimit të një arkivoli me kufomën e një çifuti, e që e kishte bërë atë të qante. E pyetën se përse qante ndërsa ai iu tha: Shpirt, që më është përvjedhur për në zjarr! Ja, këtu qëndron dallimi juaj me Pejgamberin [alejhis salatu ves selam]; ai nxiton për t'i udhëzuar njerëzit dhe për t'i shpëtuar ata nga zjarri ndërsa ju për t'i futur në të.

Jeni në taborre të ndara me Pejgamberin [alejhis salatu ves selam]

## Mbreti dhe veziri (këshilltari)



Thuhet se nje mbret kishte urdheruar te mblidheshin 10 qen te eger dhe te pameshirshem. Detyra e tyre ishte te shqyejne cdo vezir qe i jep keshilla te gabuara. Pas disa pervojash teper dramatike, veziri i radhes i jep nje keshille te gabuar mbretit, por pasi i kishte sherbyer denjesisht per dhjete vite me radhe.

Menjehere mbreti urdheron te hiedhej tek qente. Para se ta marrin ushtaret, veziri i kerkoi nje nder mbretit: Ti jepej afat dhjete dite dhe mbreti ia lejoi kete privilegj.

Menjehere, veziri vajti tek kujdestari i qenve dhe i kerkoi nje nder: Tu sherbeje qenve te tij per dhjete dite. Edhe pse u cudit nga kjo kerkese, kujdestari e pranoi dhe u largua.

Per dhjete dite, veziri i ushqeu, i pastroi, i lau dhe u perkujdes maksimalisht per qente. Diten e ekzekutimit te urdherit mbreteror, veziri u fut ne kafazin perkates dhe mbreti dha sinjalin eleshimit te qenve.

Te dhjete qente u sulen drejt kafazit, por me te mberritur tek veziri filluan ti lepijne kembet dhe ti kercejne siper me dashamiresi.

Mbreti e pyeti me habi: Cfare u ke bere qenve keshtu?!

Veziri i tha: O mbret! Ketyre u sherbeva per dhjete dite dhe ma ditën per nder e nuk e harruan te miren.

Kurse ty te sherbeva dhjete vite dhe harrove gjithcka per nje cast.

Mbreti uli koken dhe urdheroi qe ti falej jeta vezirit.

Mos e harroni te shkuaren e bukur, thjesht per nje gabim te castit!

## Ateisti “besimtar



Një njeri shkoi te një hoxhë dhe i tha: Unë nuk besoj që ka Zot dhe se Allahu është Krijuesi!

Hoxha iu përgjigj me gjakftohtësi: Mirë, ngriti duart atëherë që të lutemi!

Për çka të lutemi? - pyeti njeriu.

Vetëm ngriti duart! - ia ktheu hoxha.

Njeriu ngriti duart, kurse hoxha filloi të lutej:

“O Allah, merrja shikimin këtij njeriu! O Allah, merrja dëgjimin këtij njeriu! O Allah paralizoje këtë njeri dhe godite me sëmundje e uri!”

Njeriu nuk mundi të duronte më shumë, kështu që tha: O hoxhë, po çfarë të kam bërë që po lutesh kaq shumë kundër meje?!

Në atë rast, hoxha ia ktheu: A nuk më the që nuk beson në Zot dhe se kjo gjithësi nuk ka Krijues? Pra, kundërshtimi yt ndaj këtyre lutjeve tregon besimin tënd në Zot.

Atëherë, njeriu filloi të besonte në Zot ashtu siç i takon një besimtar dhe e kuptoi që vërtet Allahu është Krijuesi i gjithësisë, kështu që dëshmoi se Allahu është i vetmi që meriton të adhurohet dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Tij, lavdërimi dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të.

## Voglushi me te meta por i lumtur



Nuk i hiqja dot sytë nga voglushi që ecte përpara meje, ose të themi më saktë, që mendohej të ecte. Me shumë vështirësi i ngrinte peshë pataricat që mbante në duar dhe me trupin që nuk e komandonte dot nga mesi e poshtë, lëkundej sa majta-djathtas. Dukej rreth të trembëdhjetave. Për shkak të mendimit që harxhonte për të ecur, trupi i vogël kishte ngelur kockë e lëkurë.

Duke e ndjekur nga pas atë, sikur u magjepsa dhe pashe të rrëzohej në çast. Njëra nga pataricat kishte hasur në kalldrëm duke bërë që fëmija të të rrëzohej.

I shkova pranë dhe u përpoqa ta ngrija në këmbë. Po qante pa zë.

-Mos u mërzit! -i thashë duke e përndjekur. -Gjëra që ndodhin.

-Nuk u mërzita! -m'u përgjigj. -Dhe në fakt nuk mërzitem shpesh.

-Por ti po qanë! -i thashë duke iafshirë lotët me dorë.

-Më dhëmbi shumë krahu, me siguri nga kjo, tha.

Ia pervesha mëngën e këmishës dhe i pashë krahun. Ishte i prerë që nga dora, prandaj dhe njëra nga pataricat ishte bërë specifike për këtë.

Me të kuptuar që ia dallova dorën, m'u drejtua:

-Ky rrëzim nuk ishte asgjë, më parë u rrëzova dhe më ngeli dora poshtë rrotave të makinës.

Nuk dija ç'ti thoja, por për ta marrë me të mirë, i thashë:

-Mos u mërzit, ka më keq se kjo.

-Nuk mërzitem, -përsëriti duke buzëqeshur. -Unë, në fakt, nuk mërzitem shpesh.

-Pak më parë the të njëjtën gjë, -i thashë. -Përse thua kështu?

Duke drejtuar me sa mundej trupin që i dridhej mbi paterica, më tha:

Sepse unë besoj në Allah! A nuk do të kenë një trup të përjetshëm ata që i vrapin Atij?! Madje një trup të fortë.

O Zot! Ç'po më dëgjonin veshët?!

Po shihja për herë të parë se një zemër kaq e vogël mbante një besim kaq të madh dhe trupi im që e pandehja të fortë, ndjeva të dridhej më tepër se trupi i tij i sëmurë.

U largua duke më falënderuar.

Duke e ndjekur me sy nga prapa atë hero të vogël, dashje pa dashje po mendoja se cili prej nesh ishte më i lumtur.

## Blersja me nikab dhe kasierja në supermarket



Kjo ngjarje është e vërtetë dhe ka ndodhur në Francë..

Një motër muslimane, e cila barte nikabin, kishte hyrë në një ka dyqanet e Francës për të blerë disa gjëra ushqimore. Me të përfunduar pazarin e saj, ajo drejtohet drejt arkës për të bërë pagesën e saj dhe për çudi, arkëtarja ishte me origjinë marokene, e cila nuk e pëlqeu fare klienten. Filloi t'ia llogariste gjërat që kishte blerë, ndërkohë i hidhte me forcë në anën tjetër të arkës, duke u mundur që ta nervozonte këtë motër muslimane. Teksa po arrinte nga fundi i llogarisë, e pa që motra nuk po nervozohej dhe ajo nuk durojë më shumë, andaj fillojë t'i bërtas dhe ta ofendojë atë dhe fenë e saj.

"Ne kemi mjaft probleme në Francë dhe veshja që ti bart është një prej problemeve tona. Ne këtu jemi për të bërë pazare dhe jo për të reklamuar fenë dhe historinë, e nëse ti je e interesuar për të praktikuar fenë, atëherë kthehu në vendin tënd dhe atje praktikojë fenë tënde ashtu siç keni dëshirë". Motra muslimane e mbuluar ndaloi për një çast nga futja e gjerave në qese, e shikoi arkëtarën, pa rreth e rrotull nëse kishte ndonjë mashkull dhe pastaj e ngriti nikabin dhe e zbuloi fytyrën e saj. Ajo ishte biondinë me sytë blu, iu drejtua arkëtares duke i thënë: "Unë jam franceze, Islami është feja ime dhe ky është vendi im. Ju e shitët fenë tuaj ndërsa ne e blemë atë".

## Mbështetja e sinqertë në Allahun e madhëruar



Një çift bashkëshortor po udhëtonin me anije, udhëtim ky që zgjati për ditë të tëra. Ishte udhëtim mbresëlënës sikur fundi të mos përfshihej nga erëra të fuqishme dhe valë të mëdha. Anija u mbush me ujë ndërsa frika kaploi të gjithë. Kapiteni shpalli gjendje alarmante duke thënë se vetëm ndonjë mrekulli nga Allahu i Madhëruar mund t'i shpëtonte.

Bashkëshortja frikësohej shumë. Filloi të bërtiste: ‘Çfarë do të bëjmë?’, ‘Si do të shpëtojmë?’ – i thoshte burrit. Të gjithë udhëtarët ishin të shqetësuar ndërsa për çudi, ndryshe nga gjithë të tjerët, burri i saj rrinte i ulur dhe dukej shumë i qetë. Kjo gjë e hidhëroi shumë atë dhe filloi ta akuzonte për person të ftohtë dhe antipatik. Burri e shikoi me fytyrë të mrrolur ndërsa nxori një hanxhar dhe ia ofroi tek fyti duke i thënë me zë të lartë:

A nuk ke frikë nga hanxhari?

Gruaja e shikoi burrin dhe i tha: Jo.

Po përse? – e pyeti burri.

Për shkak se hanxhari është në dorën e atij që kam besë në të dhe të cilin e dua shumë – tha gruaja.

Burri filloi të buzëqesh dhe i tha gruas: Kështu është edhe gjendja ime, besoj se këto dallgë janë në dorën e Atij që kam besë në Të dhe e dua shumë! E përse të kam frikë nëse Ai mbizotëron mbi çdo gjë?!

Nëse të kam lodhur dallgët e jetës dhe të janë vërsulur erërat e saj, mos ke frikë ngase Allahu i Madhëruar të do! Ai ka mundësi mbi çdo gjë, mbi çdo stuhi e furtunë, andaj mos ke frikë! Nëse e do, besoji Atij dhe dorëzoju ngase Ai të do. Allahu i Madhëruar thotë:

قَدْرًا شَيْءٍ لِّكُلِّ اللّٰهٖ جَعَلَ قَدْ اَمْرِهِ الْعُجْبَ اللّٰهٖ اِنَّ حَسْبَهُ فِهُوَ اللّٰهٖ عَلٰى يَتَوَكَّلَنَّ وَمَنْ

**... Kush i mbështetet All-llahut, Ai i mjafton atij, All-llahu realizon dëshirën e vet dhe All-llahu çdo gjëje ia ka caktuar kohën (afatin).” (et-Talak: 3)**

## Burri im ke frikë Allahun!



Hasan el Basri Allahu e mëshiroftë thotë:

U ndala tek një shitës në Meke për të blerë një rrobë, ai filloj duke e lavdëruar e duke u betuar, e tërhjeka afër vetës dhe i thash, nuk e meriton me ble diçka prej teje, dhe e blejta nga dikush tjetër.

Pastaj bëra Haxhin pas dy viteve, u ndala afër tij, por nuk e ndëgjoja duke e lavdruar pasurin e vet dhe duke u betuar.

I thash atij?

A nuk je ti njeriu (tregëtari) që u ndala tek ti para disa viteve?

Tha :Po

I thash: E çka të shtyri që të jesh në këtë gjendje që po të shofë? Nuk po të shof se po lavdron dhe po betohesh?

Tha: Kisha një grua, kur i sillesha të hyra të pakëta, nuk i lenin gjurm fare, e kur i siellsha të hyra të shumta, i pakësonte ato (nuk ia mbushnin syrin), pastaj ishte caktimi i Allahut dhe vdiq, u martova me një grua tjetër pas saj, e kur doja të dal nga shtëpia për në treg, më kapte për rrobat dhe më thoshte: o burri im, ke frik Allahu dhe mos na ushqe vetëm me atë që është hallall, nëse na vie me diçka të pakët e shumojm atë, e nëse nuk sjell asgjë atëher mundohemi të gjejë zgjidhje tjetër.

Sa ishin nënat tona të tilla, kur na ushqyern, sa jan motrat tona që ushqejn fëmijët e tyre, sa janë grat e tona, ndaj nesh, mbetet pyetje për çdo musliman, të edukojë, nënen, motren gruan me këtë edukat.

Allahu na mundërsuft të jemi shembull, sikur ata që ishin para nesh, të devotëshmit e këtij Umeti



## Tre vajzat dhe njeriu i cili pa ëndër babain e tyre duke u dënuar!!



Transmetohet prej Haris b. Nebehanit se ka thënë: Shkova deri te varrezat dhe gushllohesha me të vdekurit.

Mendoja dhe kërkoja mësim duke i shikuar ato. Ata ishin fqinj memecë të cilët nuk vizitohen! Barku i tokës është shtrati i tyre ndërsa sipërfaqja e saj mbulesa e tyre. I thirja: -O banorë të varreve, janë shlyer gjurmët tuaja në këtë botë por nuk është shlyer përgjegjësia juaj, keni banuar në Shtëpinë e sprovës kështu që këmbët ju patën enjtur. Pastaj, qaja shumë.

Duke u strehuar prej diellit nën kupën e një varri, kisha fjetur në flladin e saj. Thotë: Derisa isha në gjumë në afërsi të varrit ndjeva se si me një shkop të lakuar i mëshonin të vdekurit në varr. E shikoja. Prangë në qafë, sy të mavijosur, fytyrë të zezë dhe më tha: -Mjeri unë, çfarë do të ndodhë me mua! Sikur të më shihnin banorët e dunjasë, kurrë nuk do të bëheshin të padëgjueshëm ndaj Allahut. Pasha Allahun, i kërkova kënaqësitë e ato kënaqësi më mahstruan. Kam bërë mëkate, ndërsa ato më mbytën. A ka kush që ndodhë për mua apo që ta njoftoj familjen time për mua?!

Harisi mëtej thotë: U zgjova i frikësuar, zemra donte të më dal përjashta nga trishtimi që pashë. Shkova në shtëpi, rashë në gjumë duke menduar reth asaj që pashë. Kur u zgjova, thashë: Do të shkoj në të njëjtin vend, ndoshta do të takoj dikë e ta njoftoj për atë që pashë.

Shkova në të njëjtin vend, nuk pashë askënd, prapë rashë në gjumë. E pashë atë njeri në varr se si duke rrëshqitur me fytyrë, thotë: -Mjeri unë, çfarë do të ndodhë me mua! Puna ime në dunja ishte e keqe ndërsa jeta ime e gjatë, aq sa Zoti u hidhërua në mua. Mjeri unë nëse Zoti im nuk më mëshiron.

Harithi thotë: U zgjova ndërsa mendja e kishte mbajtur në mend se çfarë ka parë dhe dëgjuar. Shkova në shtëpi dhe atje fjeta. U ktheva të nesërmen te varri mos do të gjejë dikë e t'ia tregojë se çfarë kam parë. Më kishte zënë gjumi dhe e pashë atë njeri në varr, me këmbë të lidhura se si flet: -Pse më kanë harruar ata në dunja? Më është dyfishuar azabi, jam i pafuqishëm dhe pa ndihmë. Zoti është hidhëruar në mua, dyert më ka mbyllur. Mjeri unë nëse Zoti Dhurues dhe i Fuqishëm nuk më mëshiron.

Mëtej Harithi thotë: U zgjova i frikësuar.Deshta që ta lëshoj atë vend, kur pashë tri gra se si vijnë.U largova nga varri dhe u ndala të dëgjoj muhabetin e tyre.Më e reja iu afrua varrit dhe tha:-Esselamu alejkum baba.Si je në shtratin tënd?

Si është pozita jote në vendqëndrimin e ri?Ike prej dashurisë tonëSi është pozita jote në vendqëndrimin e ri?Ike prej dashurisë tonë?Nuk pyet më për ne!Ne kemi pikëllim të madh për ty!

Pastaj varrit iu afruan dy vajzat tjera dhe thanë: Ky është varri i babait tonë të dashur, i mëshirshëm ndaj nesh.Allahu të dhahstë shoqërinë e melekëve, ta largoft vuajtjen dhe azabin.O babai ynë, pas teje kanë ndodhur gjëra të cilat as që mund t'i paramendosh sikur t'i paramendosh sikur t'i dije, ato do të të pikëllojnë ty.Njerëzit na i zbuluan fytyrat të cilat ti na i mbulove.

Ju thashë:-Ka që tri ditë se si vizitohet këtë varr dhe dëgjoj zërin e prangave dhe të zinxhirëve. Kur dëgjuan fjalët e mia, thanë: Na gëzon lajmi për babain por na pikëllon vuajtja e tij, ne kënaqemi dhe ndërtojmë në dunja ndërsa babai ynë digjet në zjarr.Pasha Allahun tonë, nuk do të vendosim asgjë e as që do të kënaqemi në diçka para se të lusim Allahun të përkulura,që të na lirojë babain tonë dhe ta shpëtojë nga zjarri.

Harithi thotë: Shkova në shtëpi,fjeta dhe të nesërmen sërish u ktheva te varri.Sërish më kishte zënë gjumi.E pashë pronarin e varrit,të bukur dhe të disponuar, në këmbë kishte papuçe prej ari, me të qëndronin hyritë dhe shërbetorët.

Harithi mëtej tregon: Kam qarë kur dëgjova fjalët e tyre.Shpejtova, ju dhashë selam dhe ju thashë:-O Vajza, me të vërtetë veprat do të pranohen ose refuzohen atij që i bën.

Çfarë ka qenë vepra e babait tuaj në këtë varr që ia ka bërë gjendjen për të cilën jam pikëlluar dhe që më dhemb? Harithi thotë: Kur i dëgjuan fjalët e mia, i zbuluan fytyrat e tyre dhe thanë:-O njeri i mirë, çfarë ke parë.

-Kur ke parë gjendjen time dhe u ke treguar vajzave tona për këtë, ato tërësisht i janë dorëzuar Allahut, me fytyrë lëshuar për tokë, me shumë lotë e kanë lutur Zotin që të më mëshirojë.Ai më fali dhe më mëshiroi, m'i fali mëkatet dhe më nxorri nga zjarri, në Xhennet afër Muhammedit alejhi selam më ka vendosur.

Kur t'i shohësh vajzat e mia, thuaju për mua dhe për atë se çfarë ka ndodhur me muja, le të largohet prej tyre frika dhe pikëllimi.Thuaju se kam arritur Xhenentin, hyritë, moshusin dhe kafurin, s ekam shërbetorë dhe shtretër të rehatshëm dhe se Zoti mëshirues më ka falur.

Harithi thotë: U zgjova i gëzuar përshkak të asaj që dëgjova dhe pashë, u ktheva në shtëpi dhe fjeta.Herët të nesërmen shkova te varri, i takova vajzat afër varrit, ju dhashë selam dhe thashë: -

Gëzohuni, e pashë babain tuaj në të mira dhe në një vend të mirë, më tregoi se si Allahu kishte pranuar duatë tuaja, babain tuaj e kishte mbuluar me Mëshirën e Tij, falënderoni Allahun për këtë.

-Vajza më e re, tha: -O Allah, Ti i cili i qetëson zemrat dhe që i mbulon turpet, O Ti i cili i largon vështirësitë dhe i cili mëkatet i falë, o Ti që gjithëçka di në fshehtësi dhe te i cili arrijnë të gjitha shpresat, Ti e di shumë mirë se çfarë kam kërkuar prej Teje, kam dashur dhe të kam kërkuar falje Ty në vetmi, kam kërkuar strehim nga nënçmimi, jam turpëruar nga mëkati, vetëm Ti O Allah im i di dëshirat e mia, vetëm Ti i di njetet e mia, Ti je Zoti i jetës time, Ti më udhëheqë dhe je qëllimi im i kërkimit, shpresa ime në fatkeqësi, biseda ime në heshtje, i Vetmi të cilit ia drejtoj lutjet e mia: nëse kam treguar mangësi ndaj asaj që më ke urdhëruar apo kam bërë atë që më ke ndaluar, ndërsa me Butësinë Tënde udhëhiqem, me Mëshirën Tënde jam e ruajtur, me çfarë falënderimi të të falënderoj Ty, O Më i Mëshirshmi, Ti të cilit ia drejtoj të gjitha duatë, Zoti i Ditës së Gjykimit i cili di gjithëçka që bartin në vetëdijet tona dhe i cili rregullon punët e vogla e të mëdha, nëse ndërmjetësimin dhe lutjen time e ke pranuar për robin Tënd, më merr te Ti, me të vërtetë Ti mundesh gjithëçka.

Pastaj bërtiti dhe lëshoi këtë botë, mëshira e Allahut qoftë mbi të.

Pastaj u ngrit vajza e dytë dhe thiri me zë të fortë: -O Zoti im, më liro nga vuajtjet dhe pastro zemrën time nga dyshimet. O Ti, i cili më ke drejtuar, më ke shpëtuar nga zemërimi, më ke ruajtur nga humbja dhe më ke ndihmuar në momentet e vështira, nëse ke pranuar duanë time, nëse ke zgjidhur nevojën time dhe kërkesën time e ke plotësuar, atëherë më bashkangjit me motrën time.

-Ajo bërtiti fort dhe u nda nga kjo botë, mëshira e Allahut qoftë mbi të.

Pastaj u afrua vajza e tretë dhe ajo bërtiti me sa zë që kishte: -O Ti i Fuqishëm, i Fortë dhe Bujar, që e di edhe atë që hesht dhe atë që flet, Ty të takon e mira e madhe, pushteti i përhershëm dhe fisnikria, i madh është vetëm ai të cilin Ti e ke ngritur ndërsa i urrejtur është secili ai që Ti e ke bërë të urrejtur, me nam është ai të cilit Ti i ke dhuruar nam, i lumtur është ai të cilit Ti e bën të lumtur, fatkeq është ai të cilin Ti e cakton të tillë, i afërt është të cilin Ti e vendosë afër, i largët është të cilin Ti e ke larguar, nuk ka asgjë të cilit Ti nuk i jep, Fitues është vetëm ai të cilin Ti e dhuron ndërsa humbës është ai të cilin Ti e dënon. Të lutem me Emrin Tënd të Lartësuar dhe em Fytyrën Tënde Fisnike dhe me dijen absolute që është larg çdo akceptimi të mendjes, me emrin që e ke bërë që me të të vijë nata e të ndriçojë dita, që malet të qëndrojnë drejtë dhe që me të të lëvizin erërat, që me të qyejt të ngriten, zërat të ndëgjohen ndërsa melekët sexhxhde të bëjnë; O Allahu im, të lutem Ty, nëse ke pranuar duanë time dhe të kërkuarën time ma ke plotësuar, më bashkangjit te ato dy motrat e mia.

Pastaj bërtiti shumë dhe u nda nga kjo botë, mëshira e Allahut qoftë mbi ne dhe mbi to si dhe mbi të gjithë muslimanët.

Dhe këtu treguesi e përfundon këtë tregim sa interesant aq edhe trishtues e përgëzues. Allahu qoftë në mbrojtjen tonë dhe na mëshiroft

## Si ti kuptoj gjuhët e kafshëve pyet një njeri Musën a.s.?!



“Një burrë erdhi te Musai (a.s.) dhe i tha:

- O Musa! Më mëso gjuhën e kafshëve, që t’i kuptoj ato, të marr mësim nga gjendja e tyre dhe të kuptoj madhësitinë hyjnore!

Musai (a.s.) iu përgjigj:

- Hiq dorë nga kjo dëshirë dhe mos u mundo të mësosh ata që janë mbi forcën tënde! Nëse një milingonë mundohet të pijë ujë nga liqeni më tepër sesa duhet mbytet. Pra, mos i kalo kufijtë e dijes që të është dhënë, pasi ka edhe shumë rrezikshmëri! Ti përpiqu të marrësh mësim aq sa të takon nga urtësitë hyjnore të gjithësisë! Drejtoja zemrën Allahut! Ta dish se të fshehtat e dukurive hyjnore hapen tek një zemër e drejtë dhe e pastër!

Pas kësaj burri tha:

- Të paktën më mëso gjuhën e kafshëve shtëpiake me qenin roje që qëndron te dera!

Musai (a.s.) e kuptoi se çfarëdo që të bënte nuk do ta kthente burrin nga kërkesa e tij, por e paralajmëroi duke i thënë:

- Mblidhe veten dhe mos u mbyt në oqeanin e kësaj të fshehte!

Burri në mëngjes qëndroi te dera për të provuar nëse e mësoi me të vërtetë gjuhën e kafshëve apo jo.

Ndërkohë që zonja shërbyese po shkundte mbulesën e tryezës, një copë bukë e ndenjtur ra në tokë.

Gjeli që ishte aty vrapoi dhe e mori. Qeni tha:

- Ti na torturove! Ti mund të hash edhe një copë gruri, kurse unë nuk mund ta ha! Përse e hëngre këtë copë bukë?

Ndërsa gjeli ia ktheu qenit:

- Mos u shqetëso, nesër do të ngordhë kali i zotit të shtëpisë dhe ti do të hash shumë mish!

I zoti i shtëpisë, i cili mendoi se gjeli tha diçka të fshehtë, sapo dëgjoi këto fjalë e shiti menjëherë kalin, ndërsa gjeli u turpërua përpara qenit.

Kjo përleshje interesi e qenit me gjelin vazhdoi për tri ditë. Zotëria që mësoi nga fjala e gjelit se ditën e parë do të ngordhë kali, ditën e dytë mushka dhe ditën e tretë skllavi i tij ashtu sikurse shiti kalin para se të ngordhte, ashtu shiti edhe mushkën dhe robin duke menduar se po bënte diçka të zgjuar. Në këtë mënyrë, qeni nuk përfitoi asgjë nga ato që mendonte. Gjeli në të gjitha rastet u tregua më i zgjuar se qeni.

Gjeli i turpëruar nga ato që ndodhën për faj të tij më në fund ditën e katërt i tha qenit:

- E vërteta është se ai zotëria syhapur e ka hequr mallin e tij, por me këtë sjellje ai hyri në gjak. Tashmë ai vetë do të vdesë. Pasardhësit e tij do të vajtojnë. Do të pritet një ka dhe secili do të marrë prej tij edhe ne, edhe ti!

Vdekja e kalit, e mushkës dhe e robit ishte mburojë e fatkeqësisë që do t'i ndodhte burrit. Por ai nuk mendoi humbjen dhe dëmin e mallit të tij dhe hyri në gjak.

Burri i marrë hapi veshët më tepër ndaj fjalëve të gjelit. Mbuloi fytyrën përpara kësaj të vërtete që dëgjoi. Ra në një prush të tmerrshëm.

Siç ishte shkoi pranë Musait dhe filloi duke iu lutur:

- Ej Musa! Më kupto dhe më qetëso vuajtjen time!

Musai (a.s.) ia ktheu:

- Hyre në punë që shkojnë përtej gjykimit tënd dhe vërtitësh në rrugë pa dalje. A mendove se do të dalësh me fitim me shitjen e atyre kafshëve? Të thashë që mos insisto në të fshehtat e kaderit dhe kazazë.

Personit të mençur i shihet që në fillim ajo që do t'i ndodhë në të ardhmen, ndërsa injorantit në fund!

Por çdo gjë ka mbaruar. Meqenëse u bërë mjeshër në punët e tregtisë tani shite edhe shpirtin dhe shpëto! Pasi insistoi me përlulje Musai (a.s.) vijoi:

Tashmë shigjeta doli nga harku! Nuk ka mundësi që të kthehet prapa, por dëshiroj nga Allahu dhurues që kur të vdesësh të shkosh me besim!

Musai (a.s.) u strehua tek Zoti. Në këtë mënyrë nëpërmjet lutjes së tij burri ndërroi jetë me besim. Në mënyrë të veçantë kur Allahu iu drejtua Musait dhe i tha:

- O Musa! Nëse dëshiron, ta ringjall...

Musai (a.s.) iu përgjigj:

- O Zot! Falënderimet qofshin për ty! Ti atë ringjalle në botën tjetër, në atë botë të ndritshme dhe të lartë, pasi atje është i përhershëm.

Atje është vendi ku shfaqet fati!

Siç kuptohet edhe nga tregimi, njeriu ndonjëherë kërkon gjërat që nuk janë të dobishme për të, kurse në të vërtetë ajo që dëshiron do ta çojë atë në shkatërrim. Për më tepër njeriu që bie në një fund të

tillë edhe pse e kërkon me forcë atë, pendohet dhe vajton. Për këtë arsye, e rëndësishme është të kuptosh madhështinë hyjnore, të meditosh dhe të dorëzohesh për të fituar qetësi shpirtërore në këtë botë dhe lumturinë e përhershme në botën tjetër. Por as kjo nuk mjafton.

Nëse robi e kupton që nuk është asgjë, kjo është pasuria e pafundësisë.

Pra zgjidhja e vetme e fatit dhe e përcaktimit është t'i dorëzohesh Zotit, pasi liria dhe dorëzimi i shpirtit në mëshirën e Perëndisë përbën çelësin e lumturisë së përhershme.

## Mbreti dhe piktori



Një mbret çalaman dhe me një sy të verbër, u kërkoi një ditë piktorëve të vet që ta pikturojnë pa defektet fizike që kishte.

Të gjithë e kundërshtuan këtë kërkesë, me pretekstin se si do e pikturonin mbretin me dy sy, ndërkohë që ai kishte vetëm njërin! Si ta pikturojnë me dy këmbë të shëndetshme, ndërkohë që njëra ishte e çalë!

Në mesin e këtij refuzimi kolektiv, një nga piktorët pranoi ti bëjë mbretit një pikturë pa të metat e tij fizike, madje do të ishte një pikturë shumë e bukur.

Po si?!

Ai e pikturoi mbretin duke marrë nishan me çifte, e në këtë rast, i duhej patjetër ta mbyllë njërin sy. Gjithashtu, në këtë pozicion, atij i duhej ta përthyejë këmbën e tij të çalë.

Në fakt, fotoja e mbretit doli shumë e bukur dhe askush nuk i vuri re defektet e tij fizike.

Sa mirë do të ishte që edhe ne të krijojmë imazh të mirë për të tjerët, sido dhe sado qofshin të metat e tyre dhe kur këtë imazh t'ua përcillnim njerëzve, ti mbulonim këto të meta dhe gabime të tyre. E kush është ai person që nuk paska të meta në këtë botë?! Prandaj, le të marrim të mirat e të tjerëve dhe të heqim dorë nga të metat. Kështu, do të ndihemi rehat edhe ne edhe njerëzit.

## Biseda telefonike



Një djaloshi i cingëroi celulari.

Djaloshi u përgjigj, u dëgjua një zë i bukur femre, e pyeste për se si është.

Djaloshi nuk e njihte zërin e vajzës, dhe e pyeti:

- Më falni, kush jeni ju?!...- Vajza iu përgjigj:

- Unë jam një vajzë e bukur, e pasur, nga një familje e njohur dhe dëshiroj të njihem me ty...

- Djaloshi heshti për një çast e pastaj i tha:

- Biseda jonë përgjohet!...

- Ajo e çuditur pyeti:

- Nga kush? Përgjohet nga kompania ku punon?

- Ai iu përgjigj: Jo.

- A përgjohet nga shërbimi sekret?

-Jo, u përgjigj djaloshi!

-Vajza vazhdonte me pyetje: Përgjohet nga policia?

- Jo, i tha djaloshi. Biseda jonë përcillet nga Allahu, që nuk ka tjetër si Ai.

- Vajza menjëherë e mbylli linjën dhe nuk e kontaktoi djaloshin më asnjëherë!

Vallë sa duhen respektuar ata djelmosha, që e ruajnë fenë e Allahut dhe nuk i thyjnë ligjet e Tij..?!

## Shko N'Xhehenem Aty S'ka Musliman



(dialog midis dy edepsizave)

Biseda ka ndodhur në bordin e një aeroplani ndërmjet dy personave jomuslimanë.

Ata vërejtën në bordin e aeroplanit një musliman dhe deshën ta zemëronin atë. Njeri po i thotë tjetrit duke i shkelur syrin:

-Desha t'i kaloj pushimet në Afrikë, por vërejta se shumica e banorëve atje ishin muslimanë.

Pastaj m'u dha rasti të punoj në Arabinë Saudite, por refuzova sepse e gjithë popullsia atje ishin muslimanë.

Mendova të shkoj në Pakistan, por edhe aty po vlonte nga muslimanët.- Shoku i vet për ta ngacmuar i tha:

-Atëhere pse nuk po shkon në Evropë?- Ai iu përgjigj:

Edhe aty gjen muslimanë, sepse janë shpërndarë gjithandej, sa merr një rrugicë has në një musliman,- vazhduan kështu dhe me këmbëngulje dëshironin ta zemëronin muslimanin, e ai vetem sillte kokën duke dëgjuar dhe me gjakftohtësi në fund iu tha:

-Pse nuk po mendoni të shkoni në Xhehenem, sepse aty është vendi i vetëm, ku nuk do të gjeni muslimanë.



## Djaloshi i pasur!



Një ditë prej ditësh një njeri shumë i pasur vendosi që të dal në shëtitje me djalin e tij. Ai mori djalin dhe së bashku udhëtuan drejtë një vendi të varfër. Babai nuk donte që thjeshtë të shpenzonte të holla kot. Ai donte që këtë udhëtim ta shfrytëzonte edhe për t'i mësuar diçka birit të tij. Të shikuarit dhe të përjetuarit e varfërisë dhe mënyrës se si jetojnë të varfëritë, do të ishte mësimi më i mirë dhe nxitësi më i miri që djaloshi të kujdesej për ruajtjen dhe shtimin e pasurisë, së paku kështu mendonte babai.

Udhëtuan që të dy së bashku dhe u vendosën në fermën e një familjeje të varfër. Aty qëndruan disa ditë. Ndërsa gjatë kthimit, babai kureshtarë për të parë se sa kishte arritur të përfitojë i biri nga ky udhëtim, e pyeti: Si ishte udhëtimi biri im? Ndërsa djaloshi i përgjigjet se ishte një shëtitje fantastike? Babai kureshtarë përsëri pyeti: A e kuptove tani se si jetojnë të varfëritë? Djaloshi i përgjigjet me shumë thjeshtësi dhe modesti se ai kishte arritur që shumë mirë ta kuptojë se si jetojnë të varfëritë. Babain nuk po e kënaqte me këto përgjigje andaj edhe e pyeti drejtpërdrejtë që ti tregojë se çka saktësisht kishte përfituar nga kjo shëtitje. Djaloshi fillojë të përgjigjet: Kam parë se ne kemi vetëm një qen ndërsa ata kishin katër. Ne kemi një pus të ujit në mes të kopshtit, ndërsa ata posedonin lumenjë të pafund. Ne kemi vendosur drita për ta ndriçuar kopshtin tonë, ndërsa kopshtet e tyre i ndriçonin yjet. Hapësira e kopshtit tonë përfundon me përfundimin e kopshtit para shtëpisë, ndërsa kopshtet e tyre janë përtej kufijve. Ne posedojmë një hapësirë shumë të vogël për të jetuar, ndërsa ata jetojnë në hapësira të pafundme. Ne kemi shërbëtor që na shërbejnë, ndërsa ata janë në shërbim të njëri tjetrit. Ne blejmë ushqim, ndërsa ata ushqehen nga prodhimet e tyre. Ne rretohemi nga mure të larta të cilat na mbrojnë, ndërsa ata mbrojtjen e sigurojnë nga miqtë që i rrethojnë.

Babai ishte i tronditur nga këto përgjigje të birit të tij, ndërsa djaloshi përgjigjën e vetë e vazhdoi...: Të faleminderit shumë baba që më mundësove të kuptojë se sa të varfër jemi. Prandaj edhe të thashë se ishte një udhëtim fantastikë, a nuk mendon edhe ti ashtu baba?

Kurrë mos i përqesh gjërat që të tjerët posedojnë, pavarësisht se sa të pakta janë ato, sepse ndoshta një gjë edhe pse e pakët, ka vlerë shumë më të madhe se ajo që posedoni ju.

## Prej kishës në xhami dhe prej xhamisë në varr!



Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi ju!

U takuam me Shejhun në një hotel të Mekës së nderuar. Patëm shkuar ta bënim Umren. Filluam të bisedonim për shumë të krishterë që kohëve të fundit janë duke e pranuar Islam. Çdo njeri prej nesh fliste atë që e dinte apo kishte lexuar prej ngjarjeve të tilla.

Ajo që vlen për t'u përmendur në këtë kontest është se ky shejh na tregoi një tregim shumë interesant. Ishte takuar me një imam të Tarablus-it në Libi dhe e kishte njoftuar për tregimin në vijim:

Isha duke u përgatitur për ta falur namazin e sabahut kur jam mu afrua një njeri dhe me tha: Dua të bëhem musliman!

I thashë :Ti..Po kush je ti,nga je ti,si,çfarë,kur...

Dua ta pranoj Islam, a mund të më ndihmohet-ia ktheu njeriu.


I thashë: Në rregull. Thuaj dy shehadetet Eshhedu En La Ilahe Il-La Allah Ve Eshhedu Enne Muhammedun Resulullah ( Dëshmoj dhe deklaroj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe dëshmoj dhe deklaroj se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Allahut), pastaj ia mësova formën e pastrimit dhe i thashë : Shko pastrohu! Pasi që te pastrohesh dhe te marrësh abdes,eja që te falesh me ne. I thashë: Unë do te pres!

U fal namazi. U kthye imami por nuk e pa njeriun dot. Pasi u bën gati për të shkuar imami shikonte ta gjente njeriun kur ja në të dalë një djalosh e lajmëroi se një njeri i zi kishte rënë i vdekur në vendin e marrjes së abdesit. Kur shkoi imami pa se vërtetë ai ishte dhe kishte mbetur në vend i vdekur.

O Zoti ynë! Sa vdekje e mire... O Zoti ynë! Sa vdekje e mire...

Ky njeri i zi ishte i krishterë dhe punonte afër xhamisë. Ky tregim është i vërtetë dhe ka ndodhur në vitin 1974. Xhenazen e tij e kishin përcjellë shumë vëllezër muslimanë.

## Droga m'a shkatërroi jetën



Pasi që qetësia e natës kishte kapluar qytetin e bukur, babi vazhdoi të rrotullohej në shtratin e tij ku e gjeti nënën të zgjuar e cila ende nuk kishte fjetur. E pyeti për shkakun se pse nuk kishte fjetur. Ajo iu përgjigj duke thënë: Po mendoj për çështjen e djalit tonë të vetëm i cili ka arritur moshën 26 vjeçare dhe nuk është martuar akoma. Babai i tha: Mos i kushto rëndësi kësaj çështjeje se nesër në mëngjes do të bisedoj me të për këtë.

Në mëngjesin e ditës së nesërme kur ishin ulur në tavolinë, duke ngrënë mëngjesin, babai ia hapi çështjen e martesës (dhe

se me kë të martohet) djalit të tij i cili ishte i diplomuar për doktor. Djali nuk hezitoi por u pajtua me këtë shumë shpejt. Nuk kaloi shumë kohë dhe djali u martua.

Ishin një çift shumë i lumtur. Allahu iu dhuroi gjashtë fëmijë. Babai nuk ishte i angazhuar me diçka tjetër përveç punës. E merrte bashkëshorten dhe fëmijët e tij dhe shkonin në bregun e mrekullueshëm. Jetoj ditë të bukura me familjen e tij dhe lumturia e tyre kishte arritur kulmin. Por, shejtani me ushtrinë e tij e refuzonin këtë dhe punonin për shkatërrimin e kësaj familjeje të lumtur.

Një mëngjes u befasua me gjetjen e një punëtori të ri të cilin e kishin transferuar nga një qytet tjetër.

E pa që kolegu i ri qeshte dhe bënte shaka e nuk i kushtoi rëndësi kësaj por kolegu i ri planifikonte diçka të rëndësishme.

Pas një jave të punësimit të kolegut të ri, ai i ftoi të gjithë kolegët për darkë në shtëpinë e tij.

Pas darkës u larguan shumica e të ftuarve për në shtëpitë e tyre dhe nuk ngeli vetëm se ai dhe një grup tjetër prej mysafirëve të cilët si duket nuk ishin të atij qyteti. Nuk iu kushtoi rëndësi në fillim por më pas u befasua kur ata filluan të nxjerrin nga xhepat e tyre qese të bardha të cilat brenda kishin diçka të ngjashme me detergjentin. Ata vazhduan duke e thithur e ai u çudit me këtë pamje të çuditshme.

E pyeti kolegun e tij për këtë veprim. Ai i tha me zë të ngjirur: heroinë o i dashur heroinë. Këto fjalë në veshin e tij tingëlluan si vetëtima. I tha kolegut të tij: Por kjo është mbytëse! Kolegu ia ktheu me tallje: Është mbytës për të dobëtit si puna jote o fëmijë.

Fjala e fundit (o fëmijë) që si zjarr i ndezur para tij. Këtu ndikoi shejtani i cili i tha: Ai po tallet me ty, po të thotë fëmijë, duhet

që t'ia vërtetosh se je burrë duke pirë heroinë. Duke qenë i hutuar e zgjati dorën, e mori dhe e thithi qesen e heroinës, e më pas e kaploi një gjumë i thellë dhe nuk u zgjua deri në orën dhjetë të mëngjesit.

Gruaja e tij gati sa nuk u çmend nga merakosja për bashkëshortin e vet i cili nuk kishte fjetur jashtë shtëpisë asnjëherë prej kur ishin martuar.

Kur u kthye bashkëshorti i saj ajo hetoi te ai ndryshim të fortë dhe e pyeti për shkakun. Ai për herë të parë prej se ishin martuar i përgjigjet me zë të lartë: Nuk është çështje e jotja kjo?!

Largohet duke qenë e çuditur për atë që tha bashkëshorti i saj por megjithatë nuk i kushtoi rëndësi dhe tha në veteveten e saj:

Ndoshta ka qenë i lodhur. Ai në këtë gjendje vazhdoi tre muaj derisa iu keqësua shumë gjendja e tij. Nuk i kushtonte rëndësi çështjes së shtëpisë, fëmijëve dhe as punës së tij. Shkonte në punë me vonesë dhe dilte para kohës saqë kjo gjë shkaktoi largimin e tij prej punës.

Erdhi nata e mërzitshme ku akrepat e orës po afroreshin te ora pesë e mëngjesit kur u kthye në shtëpi. Mendonte për natën e dhimbshme dhe të lumtur. Në këtë natë kishte marrë sasi më të madhe të drogës se zakonisht.

Kur e ndaloi makinën iu parafytyrua se kishte njerëz duke lëvizur në dhomën e tij të gjumit, ndaloi duke menduar pak dhe mendja e tij e befasoi: Ndoshta në shtëpi gjendet një njeri i huaj, ndoshta bashkëshortja jote të ka tradhëtuar, ngjitu shpejt dhe sulmoje atë që gjendet brenda por ke kujdes se ndoshta njeriu i cili gjendet brenda është i armatosur kështuqë mere me vete çelësin e gomave të makinës që ta befasosh para se të të befasojë. Filloi të thirret ezani i sabahut, ai doli me të shpejtë nga makina duke e marrë edhe çelësin e gomave të makinës.

Duke u ngjitur në shkallët e shtëpisë iu duk sikur gruaja e tij po kërkonte prej burrit të huaj që t'u fshehte diku sepse po vjen burri.

E hapi derën e banesës me kujdes të madh, vendin e kaplonte errësira, iu parafytyrua se në dhomën e gjumit – ishte i sigurtë - e kjo nga droga që e kishte pirë se gruaja e kishte tradhëtuar, e hapi derën e dhomës me të shpejtë dhe e pa që ajo ishte duke rënë në sexhde duke falur namazin e sabahut.

U nis në drejtim të saj dhe e goditi me çelësin e hekurt, ajo filloi të bërtasë por ai e goditi edhe një herë tjetër e ajo ra përtokë.

Fqinjët u zgjuan nga e bërtitura e saj. Njëri prej tyre erdhi shpejt dhe i ra ziles por ai nuk i kushtoi rëndësi ziles se mendja e tij i thoshte që mos ta lërë të shpëtojë pa e vrarë këtë tradhtarë. E mori çelësin e hekurt dhe e goditi edhe një herë tjetër në kokë e asaj I shpërtheu gjaku si shadërvan. Pamje e trishtueshme, ajo vdiq.

Fqinjët e thyen derën e hyrjes e u befasuan nga pamja e trishtueshme. Gruaja e tij ishte e zhytur në gjak mbi sexhaden e namazit. U zgjuan fëmijët të cilët e panë shtëpinë të mbushur plot me burra dhe gra. U nisën për në dhomën e gjumit dhe kur e gjetën nënën e tyre pa shpirt, vazhduan të bërtasin të gjithë njëzëri. Njëri prej komshive bërtiti: kriminel, pse e vrave gruan tënde? Ai i tha: sepse është tradhtarë. Ata e hetuan se ai nuk është në rregull dhe kur iu afrua njëri prej komshive, ai deshi ta godasë, por komshiu ia mori çelësin e hekurit i cili ishte i përlyer me gjak të pastër dhe njëri prej të pranishmëve bërtiti: thirrreni policinë! Nuk kaloi shumë e erdhi policia dhe filloi ta qetësojë situatën.

Filluan ta pyesin se përse e kishte bërë këtë dhe pas një ore pasi që policia përfundoi me të dhënat që po i merrte prej pranishmëve, atij filloi t'i kthehej vetëdija, u befasuan kur ai filloi të bërtasë: çfarë ka ndodhur dhe kush ma ka vrarë gruan time.

Të gjithë të pranishmit e kuptuan se ky ka qenë i ndikuar nga droga dhe e pyetën se çfarë ka ndodhur. Ai u afrua te gjaku dhe duke qarë e bërtitur tha: Sherife, kjo është njeriu më i pastër që ekziston dhe u nis në drejtim të saj duke tentuar të bëj vetëvrasje por policia e ndaloi, e mori dhe e burgosi, ndërsa fëmijët i morën fqinjët sepse familja e saj jetonte në një qytet tjetër.

Pas një muaji u bë gjykimi me ekzekutim dhe me këtë përfundoi kjo katastrofë. Droga është koka e çdo fatkeqësie!

## Zoti na ruajt nga më e keqja



Tregohet se një burrë i moshuar, po udhëtonte me të birin drejt një qyteti të largët. Atyre u duheshin dy ditë rrugë për të mbërritur në destinacion. Me vete kishin gomarin dhe plaçkat. Here pas here, burri i moshuar pëshpëriste aq sa e dëgjonte dhe i biri:”Zoti na ruajt nga më e keqja.”

Teksa vazhdonin rrugëtimin e gjatë, gomarit i thyhet njëra këmbë mu në mes të rrugës. I moshuari tha:” Zoti na ruajt nga më e keqja.”

Të dy morën plaçkat në krahë dhe vazhduan rrugën. Pasi kishin përshkuar goxha udhë, të moshuarit i thyhet këmba dhe e kishte të pamundur të ecte. Ai u mbështet në supet e të birit, të cilit i pëshpëriste:”Zoti na ruajt nga më e keqja.”

Përveç se duhej të mbante të atin, djaloshit të ri i duhej të mbajë dhe plaçkat. Teksa vazhdonin rrugën, i riu pickohet nga një gjarpër. Ai u shtri përtokë nga dhimbja, sakaq i ati iu afrua dhe i tha:”Zoti na ruajt nga më e keqja.”

Këtu i biri se përmbajti dot veten dhe tha:”E çfarë qenka më e keqe se kaq?!”

Pasi u përmirësua pak, baba e bir morën udhën drejt destinacionit, sigurisht ishin vonuar shumë për shkak të peripecive. Kur mbërritën në qytet, ata u befasuan me atë që u shihnin sytë. Qyteti ishte goditur nga një tërmet i fuqishëm, i cili e kishte rrënuar të tërin. I moshuari, e pa të birin në sy dhe i tha:”O bir! Nëse nuk do na kishin ndodhur gjithë ato peripeci gjatë udhës, do të kishim mbërritur në kohë dhe, sigurisht, do na kishte ndodhur më e keqja, do ishim nën rrënoja tani.”

Morali:

Le të jetë ky interpretimi ynë për shumë ngjarje që na ndodhin në jetë. Kështu do të mund të triumfojmë ndaj stresit, ankthit dhe tensionit. Le të kemi opinion dhe pritshmëri të mira nga Zoti. Le ti mbështetemi Atij në çdo çështje të jetës tonë. Le të jemi të sigurtë dhe të bindur se nuk ka më të dhembshur dhe të urtë sesa Zoti. O Zot! Ti ke në dorë gjithçka në tokë e në qiej! Ty të lëvdojmë dhe të falenderojmë!

## Femiu i Parisit



Hyne nje femi ne nje xhami te Parisit dhe i thote imamit te xhamise, nena me ka derguar te mesoj tek ju.

Imami i thote: por une paraprakisht duhet te marr disa te dhena ne lidhe me nenen tende...

Femiu pergjigjet: ajo eshte ne rruge dhe nuk mund te hyje sepse nuk eshte muslimane. Doli imami i xhamise te sqarohet rreth birit te saj?!

Nena i thote: Une kam komshike nje muslimane dhe kur ajo dergon femijet e saj ne shkolle ia puthin duarte dhe lumtuaria asnjehere nuk e braktise ate familje.

O imam: Une nuk kam pare ndonje musliman ne kete qytet te vendosh prinderit e tij ne shtepin e pleqeve.

Merre birin tim dhe mesoje , me shprese se do te veproj me mua ashtu si veproni ju me prinderit tuaj.

## Besa e myslimanit



Dy të rinj vajtën tek kalifi Umer ibnul Hattab, Zoti qoftë i kënaqur me të. Për krahësh mbanin një burrë të panjohur nga shkretëtira. Me të dalë para Umerit, ky i fundit i pyeti: "Kush është ky? Pse e mbani për krahësh?"

Ata u përgjigjën: "Ky ka vrarë babanë tonë o Prijës i Besimtarëve."

Umeri e pyeti burrin: "A është e vërtetë që u ke vrarë babanë?!"

Burri u përgjigj: "Po, e kam vrarë."

Umeri e pyeti: "Si e ke vrarë?"

Burri: "Kishte hyrë me devenë e tij në parcelën time. I kërkova të dalë, por ai refuzoi. Kështu, e gjuajta me një gurë, i cili e goditi në kokë, e për rrjedhojë ra i vdekur përtokë."

Umeri tha: "Dënohesh me vdekje."

Ishte një ligj që nuk mund të tolerohej dhe të vihej në diskutim. Umeri, Zoti qoftë i kënaqur me të, nuk e pyeti mbi familjen e tij, as nga cili fis rridhte, as nëse i përkiste një familjeje të fisme dhe të fuqishme, as cili ishte statusi i tij në shoqëri. Të gjitha këto nuk i interesonin aspak Umerit, i cili nuk merrte parasysh askënd kur flitej për ligjet e Zotit. Askush s'qëndronte mbi forcën e ligjeve hyjnore, edhe sikur vrasësi të ishte vetë djali i Umerit.

I zënë ngushtë nga ajo që i dëgjuan veshët, burri i tha: "O Prijës i Besimtarëve! Të kërkoj që për hatër të Atij që ka krijuar qiej e tokë, të më japësh leje vetëm një natë. Dua të shkoj tek ime shoqe dhe tek fëmijët në shkretëtirë dhe tu tregoj se do të dënohem me vdekje për shkak të vrasjes. Pasha Zotin ata s'kanë njeri tjetër që kujdeset për ta përveç meje."



Umeri e pyeti: "E kush del garant për ty që do të kthehesh nga shkretëtira?!"

Burri uli kokën, sakaq të gjithë të pranishmit mbajtën frymën. Askush nuk e njihte atë person, as emrin, as ku e ka ngritur çadrën në shkretëtirë, as shtëpinë dhe as farefisën. Si mund të dilnin garant për të? Këtu nuk bëhej fjalë për garanci për një grusht parash, as për një rrip toke, as për një deve, por garanci për jetën. Nga ana tjetër, askujt nuk ia mbante ti kërkojë Umerit ta tolerojë, aq më tepër që bëhej fjalë për dispozitat hyjnore. Kush ishte ai burrë që të ndërhyjë në një rast si ky?

Askush nuk fliste. Umeri dukej i prekur nga ajo që po ndodhte, por nuk e lëshonte veten. Ai uli kokën dhe më pas iu kthye dy të rinjve, bijve të viktimës: "A pranoni ta falni vrasësin e babait tuaj?"

Njësëri u përgjigjën: "Jo. Kush ka vrarë babanë tonë, duhet të vritet para syve tanë o Prijës i Besimtarëve."

Mandej, Umeri iu kthye të pranishmëve: "Kush del garant për këtë të mjerë?"

Të gjithë ulën kokat dhe nuk folën, përveç Ebu Dher-it i cili, me kokën plot thinja e me trupin e ligsht tha: "Unë o Prijës i Besimtarëve. Unë dal garant për të."

Umeri, si për t'ia kujtuar, i tha: "Por, a e di se është vrasës!"

Ebu Dher-i: "Edhe pse është vrasës."

Umeri e pyeti: "Mos e njeh?"

Ebu Dher-i: "Jo, aspak."

Umeri: "E si del garant për të atëherë?!"

Ebu Dher-i: "Pikasa tek ai cilësitë e një besimtari dhe besoj se nuk do të gënjejë. Në dashtë Zoti, ka për të ardhur dhe do e mbajë besën."

Umeri i tha: "O Ebu Dher! Mos mendon se nëse vonohet mbi tri ditë, do të heqim dorë dhe do të shpëtosh?!"

Ebu Dher-i: "Më ndihmoftë Zoti o Prijës i Besimtarëve!"

Kështu, burri vrasës u la i lirë, pasi i kishte dhënë leje Umeri vetëm tre ditë, gjatë të cilave do u jepte lamtumirën fëmijëve dhe familjes, si dhe do ua linte amanet dikujt nga të afërmit.

Tre ditë më pas, Umeri i rikthehet çështjes. S'bëhej fjalë që ai të toleronte në gjëra të tilla. Ai i numëronte ditët një e nga një.

Ditën e tretë, pas namazit të iqindisë, ai mblodhi burrat në xhami. Pasi kërkoi Ebu Dher-in dhe ai doli para njerëzve, i tha: "Ku e ke personin për të cilin dole garant o Ebu Dher?"

Ebu Dher-i u përgjigj: "Nuk e di o Prijës i Besimtarëve." Mandej hodhi sytë nga dielli, i cili iu duk se e shtoi shpejtësinë e vet drejt perëndimit.

Të gjithë myslimanët dhe shokët e Profetit a.s kishin ulur kokat dhe askush s'pipëtinte. Veç Zoti e dinte sa të prekur ishin nga ajo që po ndodhte. Të gjithë e dinin dashurinë dhe respektin e Umerit për Ebu Dher-in, saqë ishte gati ti japë një organ të trupit të tij po ti nevojitej. Por këtu fjala bëhej për çështje të sheriatit dhe drejtësisë, ishin dispozita hyjnore dhe nuk i shkonte mendja ndokujt ti shkelë. Askush nuk i jepte të drejtë vetes të hapë një debat lidhur me vlefshmërinë e tyre, apo se duhen zbatuar në disa rrethana dhe nuk duhen zbatuar në rrethana të tjera, se duhen ekzekutuar me disa njerëz e jo me të tjerë.

Disa çaste para perëndimit të diellit, dallohet nga larg pluhuri që ngrinte galopi i një kali. Umerit i çeli fytyra dhe thirri: "Zoti është më i madhi!" gjë e cila u pasua edhe nga myslimanët e tjerë.

Me të mbërritur burri, Umeri e pyeti: "Pashë Zotin, më thuaj çfarë të solli të vritesh! Shumë mirë mund të kishe qëndruar në shkretëtirën tënde, e askush nuk do të gjente dot kurrë."

Burri ia ktheu: "Pasha Zotin o Prijës i besimtarëve, nuk erdha as për ty dhe as për ndonjë tjetër. Erdha vetëm për hir të Atij që di çdo të fshehtë. Kisha frikë se do të thonë njerëzit pas meje: "Ka humbur besa mes myslimanëve. Pasha Zotin i kam lënë fëmijët si zogj të vegjël në shkretëtirë dhe erdha të marr dënimin që meritoj."

Mandej, Umeri iu drejtua Ebu Dherit: "Po ti more i mjerë, ç'të bëri të pranosh e të hysh garant në një çështje kaq delikate dhe të rrezikshme?!"

Ebu Dheri ia ktheu: "Pata frikë se do të flitet anembanë për këtë ndodhi dhe do të thonë njerëzit: "Myslimanët nuk i zënë besë njëri-tjetrit."

Umeri u drejtua nga dy djemtë të cilëve u ishte vrarë i ati. Me lot në sy, ata thirrën: "E kemi falë, e kemi falë o Prijës i Besimtarëve."


Umeri i pyeti: "E keni falë?! Po pse pikërisht tani dhe jo më parë?!"

Dy djemtë i thanë: "Kemi frikë se do flasin njerëzit e do thonë se mes myslimanëve ka humbur morali i faljes dhe dhembshurisë."

Me lotët që i lagnin mjekrën, Umeri u tha: "Zoti ua shpërbleftë me të mira për aktin!" Mandej iu drejtua Ebu Dherit: "Zoti ta shpërbleftë me të mira edhe ty o Ebu Dher! I hoqe një barrë të rëndë këtij burri." Pastaj, iu drejtua burrit: "Edhe ty Zoti ta shpërbleftë me të mira, për besën dhe fjalën e mbajtur!"

Ne dhe çdo brez i kaluar e lusim Zotin që edhe ty o Prijës i Besimtarëve, të të shpërblejë me të mira për drejtësinë që vendose mes njerëzve./AO/

## Mbreti që i takojë lëmosha!



Ndoshta ndonjëri prej jush mund edhe të mos e besojë këtë tregim sidomos nëse mundohet që këtë të e krahasojë me kohën në të cilën ne sot po jetojmë, por ja që kjo është mase e vërtetë dhe se ky ishte me të vërtetë një nder mbretërit e shtetit Islam por që ishte i varfër dhe për këtë arsye i takojë që të ishte një nga ato kategori që në Islam kanë të drejtë të marrin lëmoshë.

Omeri r,a në kohën sa ishte prijësi i myslimanëve kishte kërkuar një regjistër me emrat e njerëzve të varfër në mënyrë që të bënte ndarjen e zekatit dhe të hyrave tjera të shtetit si ndihmesë për këta njerëz. Kur Omerit r,a iu dërgua kjo listë për banorët e Homsit, ai ishte befasuar kur në këtë liste kishte hasur edhe emrin e vetë udhëheqësit të këtij vend, emrin e prijësit të vendit që atë kohë ishte Seid Ibn Amir.

Omeri r,a ishte aq i habitur me këtë rast sa që thajse ishte gati të mos e besonte fare dhe për këtë kishte vendosur të pyeste banorët e vendit në mënyrë që të e qetësonte zemrën e tij. Ndërsa habinë edhe më shumë ia shtojte kur banorët i treguan se udhëheqësi i tyre tërë rrogën e tij e shpërndan për të varfëritë dhe skamnorët e vendit duke u arsyetuar se nuk ka zgjidhje tjetër pasi që ishte përgjegjës për ta dhe se para Allahut xh,sh do të merrej në pyetje, ai e bënte këtë edhe përkundër faktit se vetë ishte njëri prej varfanjakëve të vendit.

Ndërsa kur Omeri r,a i pyeti se a keni ndonjë vërejtje tjetër ndaj tij, ata iu përgjigjen se ndaj tij kemi gjithsej tri vërejtje:

E para: Ai nuk del për të kontrolluar njerëzit vetëm se në mëngjes?

E dyta: Ai nuk del natën asnjëherë për të qenë në shërbim të popullit?

E treta: Ai një ditë në javë nuk duket fare para njerëzve?

Ndërsa kur Omeri r,a e ftoi Seidin dhe e pyeti rreth këtyre vërejtjeve që populli i tij i kishin ngritur kundër tij, ai ishte përgjigjur se: Kjo është e vërtetë o prijësi i myslimanëve?!, ndërsa arsyet për këtë janë se unë nuk dal vetëm pas kohës së mëngjesit për arsye se më duhet të i shërbeje familjes dhe të ua plotësoje nevojat elementare pasi që nuk kam shërbëtorë dhe njëkohësisht gruan e kam të sëmurë, e sa i përket asaj se unë nuk

dalë natën këtë e bëjë sepse e kam ndarë ditën për nevojat e njerëzve ndërsa natën për të adhuruar Krijuesin tim, e sa i përket asaj se unë fshihem një ditë në javë kjo ndodhë për arsye se unë i pastrojë rrobat dhe me duhet të pres derisa të thahen pasi që nuk posedojë rroba tjera.

Omeri r,a fillojë të qajë dhe ndau për Seidin një shumë të hollash, e ndërsa ky nuk pranojë të shkonte në shtëpi derisa nuk ua ndau këtë pasuri varfanjakëve dhe skamnorëve të qytetit.

Ndërsa sot, a thua vallë ku janë prijësit tanë prej këtyre shembujve..

## Tregimi i gruas që vdiq në sexhde



Një plakë që kishte mbushur të 80-at ishte ulur me disa gra dhe ndiente se ato po e humbnin kohën në atë çka ka ndaluar Allahu, dhe në atë çka nuk ka dobi...

U largua nga ato dhe u vetmua ta përmend Allahun, e vendosi sexhaden dhe filloi të falet. Po atë natë, djali i vetëm i saj që ishte edhe respektues i madh ndaj nënës, dëgjoi zërin e saj dhe nxitoi drejt dhomës ku nëna qëndronte.

Rrëfen: Shkova dhe nënën e gjeta në pozitën e sexhdes dhe më thoshte: O biri im, për momentin nuk më lëviz asgjë pos gjuhës time.

I thash: Të dërgoj në spital?

U përgjigj: Jo, më lërë në këtë vend.

I thash: Për Allahun do të dërgoj në spital. (sepse ai ishte shumë respektues ndaj saj) Mjekët dhanë gjithë mundin e tyre, por kush është ai që mund ta ndryshoj caktimin e Allahut!

Nëna më tha: Të lutem për Allahun më kthe në dhomën dhe sexhaden time.

Djali e mori dhe e ktheu në shtëpi, e vendosi në dhomën e saj, e ajo mori sexhaden dhe menjëherë filloi të falej...

Pak para namazit të sabahut më thirri: O biri im, të lë nën kujdesin e Allahut, dhe tha: Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër pos Allahut që meriton të adhurohet, dhe Muhammedi (alejhi selam) është i dërguari i tij. Mori frymën e fundit dhe ndërroi jetë.

E pastruan ndërsa ajo ishte në formën e sexhdes; e qefinosën, e ajo ishte në të njejtën gjendje; e dërguan tek varrezat, e ajo kishte të njejtën gjendje; dhe e futën në varr duke qëndruar në formën e sexhdes.

Mos harroni se dyert e pendimit janë të hapura, mos e humbisni këtë rast; pendohuni tek Allahu se Atë do ta gjeni bujar dhe falës.

O Allah, na mundëso të vdesim duke bërë adhurim ndaj Teje. Amin

## Biri keqbërës



Ishte një djalë që nuk e respektonte nënën e tij. Ai ishte keqbërës dhe kështu që një ditë prej ditëve vendosi ta mbyll çështjen me nënën e tij të moshuar njëherë e përgjithmonë.

E mori nënën, e vendosi mbi shpinën e tij dhe e dërgoi drejt një mali. Rrugës duke ecur në mes të malit kalonin mbi degë që i pengonin, kurse nëna i thyente degët ndërsa fletët i hidhte në tokë.

Kur arritën, djali keqbërës e braktisi nënën e tij në mes të malit dhe duke u kthyer i vetëm drejt shtëpisë humb rrugën dhe mbetet i habitur, dhe nuk di nga t'ia mbaj.

E thërret nëna e tij me zë të mallëngjyer: “O biri im nga frika se do ta humbësh rrugën gjatë kthimit, unë kam thyer degët e pemëve dhe fletët e tyre i kam hedhur në tokë ashtu që të orientohesh në bazë të tyre dhe të kthehesh i sigurt.”

Lotët filluan të rridhnin nga sytë e djalit keqbërës, por e mblodhi veten për një çast, u kthye e mori nënën e tij dhe e ktheu në shtëpi.

Për çudi, biri mendonte për vdekjen e saj ndërsa nëna për shpëtimin e tij.

Nëna gjithëherë ka zemër madhështore dhe të butë. O Allah, na bëj prej atyre që i respektojnë prindërit.

Allahu ka thënë: **“Thuaj: Zoti im! Mëshiroi ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël.” (Isra, 24)**

## Fëmiu dhe beriberi



Berberi i pëshpëriti një myshterie në vesh; ky fëmi, është fëmiu më i marrë në botë. Prit pakë dhe unë do ta vërtetoj këtë.

Berberi vendosi 3 euro në njëren dorë të fëmiut, ndërsa në dorën tjetër 10 euro.

Fëmiu mori 3 euro dhe shkoi.

Berberi ia ktheu: A të thashë që ky fëmij nuk mëson asnjëherë, dhe gjithmonë e përserit të njejtën.

Pasi myshteriu doli nga lokali, takoi fëmiun duke dalur nga një shitore e ëmbëlsirave, dhe u bë kureshtar ta pyes atë.

I'u afrua dhe e pyeti: Pse ~do herë merr 3euro dhe jo 10?

Fëmiu u përgjigj: Sepse në momentin që i marr 10euro mbaron loja!

Atëherë...

Mos shpejto në gjykimin e të tjerëve dhe mos beso se ti je më i zgjuari i njerëzve, sepse mund të jesh në gabim.



## Imami (hoxha) dhe Emiri (udhëheqësi)



Tregohet se një udhëheqës ishte falur mbrapa një imami që e kishte zgjatur namazin. Pas përfundimit, udhëheqësi ngritet dhe e qorton imamin para masës duke i thënë: “Mos lexo në një rekat më shumë se një ajet.”

Ndërkohë, imami ua fali namazin e akshamit dhe pasi mbaroi Fatihanë, lexoi ajetin e Kur’anit: Dhe thonë: “Zoti ynë, ne i dëgjuam udhëheqësit tanë dhe të parët tanë, por ata na shmangën nga rruga e drejtë.” (Ahzabë, 67)

Kurse, në rekatën e dytë pasi mbaroi Fatihanë, imami vazhdoi të lexonte ajetin tjetër nga Kur’ani: “Zoti ynë, jepu atyre dënim të dyfishtë dhe mallkoi ata si është më së keqi!” (Ahzabë, 68)

Udhëheqësi i thotë imamit:

“Zgjate sa të duash dhe lexo çka të duash, pos këtyre dy ajeteve.”

## Xhamia që kushtojë një pikë uji



Një prej mbretërve kishte vendosur që të ndëronte një xhami në qytetin e tij. Por ai dëshironte që askush të mos e ndihmonte në këtë. Ai dëshironte që tërë xhamin të e ndëronte me forcat e tij vetjake pa ndihmën e askujt as nga ana materiale e as fizike. Për këtë arsye ua kishte tërhequr vërejtjen të gjithë banorëve të qytetit që të mos i ndihmonin në asnjë mënyrë.

Filloi me ndërtimin e xhamisë dhe kur e përfundoi ndërtimin e saj në të vuri si mbishkrim emrin e tij.

Një natë prej netëve derisa mbreti po flinte pa në ëndërr se një melaqe prej melaqeve kishte zbritur prej qiellit dhe e kishte fshirë emrin e tij ndërsa në vend të tij kishte shkruar emrin e një plake?

Mbreti u zgjua nga gjumi i shqetësuar dhe i trishtuar, menjëherë urdhëroi ushtarët e tij që të shkonin tek xhamia për të parë se a ishte emri i tij i shkruar apo ai me të vërtet ishte fshirë!

Ushtarët shkuan me nxitim dhe panë se emri i tij ende ishte aty, u kthyen dhe e përgëzuan mbretin duke e qetësuar dhe këshilluar se ajo çka kishte parë ishte vetëm ankth gjumi dhe asgjë më shumë.

Natën e dyte, mbreti përsëri pa të njëjtën ëndërr dhe prapë u zgjua i shqetësuar dhe i trishtuar, urdhëroi ushtarët e tij që të shkonin të kontrollonin për emrin e tij?

Ushtarët shkuan dhe u vërtetuan se emri i tij ishte ende i shkruar në xhami, u kthyen dhe e qetësuan përsëri mbretin duke i rikujtuar se ajo që kishte parë nuk ishte asgjë më shumë se një makth i keq gjumi.

Natën e tretë, mbreti përsëri pa të njëjtën ëndërr dhe përsëri u zgjua i trishtuar por kësaj radhe kishte arritur që të e mbante mend emrin e plakës që shkruhej në vend të emrit të tij. Urdhëroi ushtarët që të e sillnin plakën në prezencë të mbretit për të kuptuar se çka ishte puna e saj.

Ushtarët e gjetën plakën dhe e sollën tek mbreti, ishte një plakë e varfër dhe e gjorë e cila nga

frika e mbretit dridhej e tërë.

Mbreti e pyeti se pse kishte ndihmuar në ndërtimin e xhamisë...? Plaka e trishtuar dhe e frikësuar iu përgjigj mbretit: Zotëria juaj, unë e di se keni urdhëruar që askush të mos ndihmojë në ndërtimin e xhamisë dhe ju e dini se unë jam një plakë e gjorë dhe e varfër andaj nuk kam pasur mundësi që të bëjë një gjë të tillë??

Mbreti insistojë të e dinte të vërtetën dhe i kërkoi që për hir të Allahut të i tregojë se çka në të vërtetë ajo kishte bërë...?

Plaka kur e pa se mbreti nuk e kishte për qëllim ndëshkimin e saj sa e kishte për qëllim qetësimin e zemrës së tij nga makthi që e zinte në ëndërr, ajo vendosi të i tregojë të vërtetën.

Zotëria juaj, fillojë plaka rrëfimin e saj, derisa po ndërtohej xhamia një ditë prej ditësh kalova aty pran dhe e pash njëren prej kafshëve, që bartin mjetet për ndërtim, të lidhur me litar derisa dielli përcëllonte. Pran tij kishte një kove me ujë por që kafsha për shkak se ishte e lidhur nuk mundi të e arrinte edhe përkundër përpjekjeve të saj, andaj u afrova dhe ia ofrova kovën me ujë në mënyrë që të shuante etjen në atë vapë përcëlluese të verës. Kjo ishte e tërë që kam bërë për atë xhami, zotëria juaj, ishin këto fjalët e plakës së gjorë e cila priste vendimin e mbretit.

Mbreti i stepur nga kjo ngjarje tha " Ah i gjori unë, e ndërtova xhamin që të mbetej emri im i shkruar në të ndërsa ti ia shove etjen asaj kafshe për hir të Allahut andaj edhe Allahu e pranoi veprën tënde ndërsa nuk e pranoi timen ".

Si rezultat i kësaj mbreti urdhëroi që të fshihej emri i tij prej xhamisë dhe në vend të emrit të tij të shkruhej emri i plakës së gjorë.

Mësimi nga tregimi:

Mos e nënçmo asnjë vepër të mirë sado e vogël të jetë ajo sepse kurrë nuk mund ta dish se cila prej veprave do të jetë shkaktare që të te fus në xhenet apo të te shpëtoje prej zjarrit të xhehenemit.

## AI është Pranë nesh mbështetju Atij



Ishte hera parë që hyja në dhomën e prindërve që kur se vdiqën të dy bashkë aksidentalisht. Qëndrova pak çaste pa lëvizur dhe vështrova përreth sikur të kisha një shekull pa e parë atë dhomë.

Krevati dopio ishte i rregulluar. Kornizat në mur, dollapi, komodinat s’kishin aspak pluhur për çudi. Abazhuri ishte i ndezur. E fika dhe hapa dritaren. Më lindi një dëshirë e trishtuar: të shihja fotografitë. Shkova pranë sirtarit për t’i marrë duke kaluar pranë një pasqyre të madhe të vendosur në mur. Pasqyra kishte formë vezake me një kornizë argjendi plot dekoracione. Mora fotografitë e u ula t’i shihja në krevat. Sa shumë fotografi, sa shumë! Aty nëna buzëqeshte pafajshëm dhe babai e përqafonte. Diku tjetër nëna më puthte mua e diku tjetër unë atë.

Qava. Trupi më dridhej si të isha zhytur në dëborë. Lashë mënjanë albumin dhe mbulova fytyrën me duar. Sa shumë kujtime! Sa shumë lot! Nënë! Baba!

Diçka më preku lehtë krahun. Menjëherë më shkoi mendja te fantazmat. U ngrita shpejt e trembur, por kishte qenë perdja që lëkundej nga era. Megjithatë qëndroja në këmbë e trembur. “Nga më erdhi kjo frikë.”

Ndjeja ftohtë. Fshiva lotët dhe vendosa të dilja nga dhoma.

“S’kam pse të kem frikë. Do dal ngadalë, e qetë, do pi pak qumësht e do ndjehem më mirë!”

Fillova të ec drejt derës duke mu dridhur këmbët. Në gjoks më shtrëngonte një ndjenjë trishtimi e malli, përzier me frikë.

Perdet lëkundeshin, por frika s’më linte të mbyllja dritaren. Doja vetëm të ikja. Kalova pranë pasqyrës vezake, por sapo bëra një hap larg saj, u ktheva me nxitim.

“O Zot!”

Isha mësuar që gjithnjë në pasqyrë të shihja veten, por kësaj rradhe pashë nënën.

“Ç’po ndodh?!”

Qëndrova para pasqyrës e ngrirë me sytë përlotur, me buzë të lagura.

Vura duart në faqe, pastaj në flokë, pastaj nëpër trup dhe ajo bënte të njëjtat lëvizje si unë, bile mbante të njëjtin fustan. Vetëm fytyra na dallonte nga njëra tjetra.

“Si është e mundur?!”

Çudia gati po më mbyste. Iu afrova më afër pasqyrës.

“Nënë!”

Buzët e saj lëviznin njëherësh me të miat.

Më erdhi një mendim të dilja me vrap nga dhoma, ose të bërtisja fort e të vinte vëllai të më merrte, por asnjërën nga këto s’munda ta bëja. Diçka më pengonte. Zgjata dorën drejt pasqyrës që ta prekja. Ajo nuk lëvizi. Atëherë u tmerrova dhjetë fish. Fillova të qaja.

“Nënë! Mos më bëj keq, të lutem! Unë të dua shumë! Mos më bëj keq!”

Dridhesha dhe gati sa s’po më binte të fikët. Pranë nesh

Nëna në pasqyrë uli kokën mendueshëm dhe pastaj foli si e penduar:

-“S’desha të të trembja!”

Shtanga. Ia ngula sytë dhe vura re se ishte e trishtuar sikur dikush ta kishte fyer.

“Më fal, nënë, nëse të kam lënduar ndonjëherë!”

“Po, më ke lënduar.”

Unë fillova të qaja përsëri me dënesë, kokën ulur, duke u dridhur.

“Pse qan?”

“Më vjen keq! Më vjen keq për ty e për babin! Më vjen keq për gjitha ato gjëra që po ndodhin në këtë botë! Për gjitha këto padrejtësi! Oh! Nënë.

Çdo ditë vdesin të pafajshëm, të rinj, krejt papritur e, unë trishtohem...

Gjithë bota trishtohet, por prapë vazhdon ritmin vet. Por unë acarohem e më vjen të plas kur

shoh diellin të lindë përsëri e rrugët të vlojnë si zakonisht, sikur asgjë të mos ketë ndodhur.

Më duket sikur jam në një ëndërr të keqe e pres me padurim të zgjohem, por...kur çdo mëngjes më ndesh me të njëjtën realitet, e kuptoj trishtueshëm se kurrë s’do të ketë një zgjim final e të lumtur... Sa e vështirë për t’u pranuar!”

Nëna buzëqeshi pakëz:

“Është vetëm një provë, e dashur. Vetëm një provë e shkurtër. Bëhu e fortë e kaloje! Dhuroju të tjerëve mirësi nga mirësia që Zoti ka vendosur në zemrën tënde! Do të ketë një zgjim final, por ti duhet të jesh gati për të!”

Ndalova lotët. Bënte fresk dhe u solla të mbyll dritaren! Mos e mbyll! Mos mbyll asnjë dritare!

Bile, krijo të tjera!...dhe mbështetu te Zoti!”

Ktheva kokën... s’ishte më në pasqyrë.

“Nënë!”

Përsëri qava. U kujtova se desha ta pyes për shumë gjëra, për vdekjen, për botën e atjeshme.

Deshe të pyes nëse ishte mundur ta përqafoja ...por ajo kish ikur... Në dhomë ushtronin vetëm fjalët “mbështetu te Zoti!”,” mbështetu te Zoti!”

Dhe ...u përmenda. E pashë veten të ulur në shtrat me fotografi në duar. E kuptova që kisha fantazuar. E kisha çuar shumë larg imagjinatën time. Hodha sytë nga pasqyra që heshte indiferente dhe qesha.

“Sa budallaqë! Kam folur me veten!”

Lashë fotografitë dhe u ngrita të mbyllja dritaren.

“Mos e mbyll, i thashë vetes, - nuk duhet t’i mbyllësh dritaret, por të krijosh të tjera!”

Vështrova dhomën rreth e qark para se të dilja.

Era tundte perdet lehtë-lehtë dhe rrezet e diellit puthnin pasqyrën vezake. Më rrëshqitën ca lot, por gjeta forcë t’i thoja vetes:

“Mbështetu te Zoti!” dhe ndjeva që Ai është kudo, pranë nesh!

## Dhurata e bukur e maturantit



Një djalë i ri bëhej gati t'i mbaronte studimet. Për muaj të tërë ai kishte admiruar një veturë të bukur sportive në një sallon automobilash dhe duke e ditur se babai i tij mund pa problem t'ia blinte, i tha atij se jo ishte e tëra që e dëshironte për maturë. Derisa afrohej dita e diplomimit, djaloshi priste të shihte shenjat se babai ia kishte blerë veturën.

Ditën e diplomimit, babai e ftoi në zyrën e tij të punës dhe i tha se ndihej shumë krenar që kishte një djalë kaq të vyeshëm dhe i tregoi se sa shumë që e donte. Me këtë rast, ia dhuroi të birit një kuti dhurate të mbështjellë bukur. Kureshtar, mirëpo paksa edhe i zhgënjyer, djaloshi e hapi kutinë dhe brenda pa një Kur'an të dashur, të mbështjellë me lëkurë. I inatosur, e ngriti zërin kundër babait duke i thënë: “Me të gjitha ato para që ke, po ma jep një Libër të shenjtë?”. Doli me vrull nga shtëpia duke e lënë librin e shenjtë.

Për një kohë bukur të gjatë ky nuk kontaktoi më me të atin. Kaluan shumë vite dhe ky djaloshi u bë një njeri shumë i suksesshëm në biznes. Ai tanimë kishte një shtëpi të bukur dhe një familje të mrekullueshme. Mirëpo, dikur iu kujtua se babai duhej të ishte plakur dhe se ndoshta duhej të shkonte ta vizitonte. S'e kishte parë atë që nga dita kur diplomoi.

Para se të fillonte me përgatitjet për udhëtim, mori një telegram se babai i kishte ndërruar jetë dhe se i kishte lënë me testament krejt pronën e tij për trashëgim të birit. Ky duhej të shkonte menjëherë në shtëpi dhe të kujdesej për sendet që i kishte lënë i ati. Kur mbërriti te shtëpia e të atit, papritmas zemrën e tij e kaploi zija dhe keqardhja. Nisi të kërkonte letrat e rëndësishme të të atit dhe e gjeti atë Kur'anin akoma ashtu të ri e të paprekur, mu ashtu siç ia kishte dhuruar i ati vite e vite më parë.

Me lot në sy, e hap Kur'anin dhe fillon t'i shfletojë faqet e tij. Derisa lexonte pjesë nga Kur'ani, çelësi i veturës ra nga një mbështjellës i lidhur për anën e pasme të Kur'anit. Ai kishte një etiketë me emrin e shitësit, të të njëjtit shitës të veturës sportive të cilën ky e kishte shumë qejf atëkohë. Në etiketë ishte shënuar data e diplomimit të tij si dhe fjalët “E PAGUAR”.

Sa e sa herë ne nuk i vëmë re bekimet e Zotit nga arsyeja e thjeshtë se ato nuk janë paketuar ashtu si duam ne?!

## Rreze drite në errësirën e shpellës



Diku pas maleve Himalaja, jetonte një mbretëri e vogël, e cila udhëhiqej nga një mbret i urtë, i mençur dhe largpamës, por për fat të keq dergjej në shtrat nga sëmundja e gjatë. Duke ndjerë fundin e jetës, ai thirri djalin e tij të vetëm, i cili sapo kishte mbushur moshën e burrërisë, të cilit i tha:

“O bir! Unë ndjej se po jetoj ditët e mia të fundit dhe dua të jap një këshillë të vyer. Nëse rrethanat e jetës vijnë të tilla, saqë të neveritet jeta dhe nuk dëshiron të jetosh as dhe një ditë më shumë, shko tek shpella e errët pas pallatit mbretëror. Brenda në shpellë do të gjesh një litar të varur, gati për të varur veten dhe për të shpëtuar nga hallet e telashet.”

Akoma pa e mbaruar mirë fjalën e tij, mbreti mbylli sytë përgjithmonë.

Trashëgimtari i vetëm i mbretërisë dhe i pasurive, filloi të abuzojë me dëfrime dhe shpërdorime. Ai shoqërohej nga disa miq të ligj, për të cilët kushedi sa herë e kishte paralajmëruar i ati. Pas disa vitesh, mbreti i ri mbetet me gisht në gojë, skishte asnjë kacidhe dhe situata ekonomike në vend përkeqësohet. Sakaq, miqtë e braktisën dhe nuk shoqëroheshin më me të. Edhe miku më i ngushtë që kishte pasur, refuzoi ti japë qoftë dhe borxh.

Mbreti i ri dhe i përkëdhelur, i mësuar me të gjitha të mirat, e kishte të pamundur të ambjentohej me kushtet e vështira të jetës. Duke mos patur asnjë zgjidhje tjetër, atij iu kujtua porosia e babait. Me vete tha: Aaaahhhh more baba. Po, do të shkoj tek shpella jote të var veten.” Dhe ashtu bëri. Vajti tek shpella, e cila ishte e errët. Mezi gjeti litarin e varur, e vuri në qafë, ndërkohë që sytë i lëshuan disa pika loti të nxehtë dhe të fundit. Mandej, ai hodhi veten në greminën aty pranë.

Por, a thua vdiq?! A thua mbaroi gjithçka aty?! A ishte vërtet ai fundi i tij?!

Me tu hedhur për tu vetëvrarë, këmbët i prekën një vend të cekët, sakaq tërheqja e litari bëri të shemben përtokë një deng parash e monedhash floriri. Përbri tyre, ai gjeti një letër nga i ati ku i shkruante:

“O bir! Tani besoj se e kupton se jeta e kësaj bote është plot shpresë dhe rreze drite, nëse shkund pluhurin që të ka mbuluar sytë dhe heq dorë nga shoqëria e keqe. Kjo është gjysma e pasurisë time, të cilën e pata fshehur për ty. Reflekto dhe hiq dorë nga shpërdorimi dhe abuzimi!”/AO/

## Milingona, Bretkosa Dhe Sulejmani Alejhi Selam



(Një tregim fantastik që meriton të lexohet nga të gjithë)

Milingona, bretkosa dhe Sulejmani alejhi selam

Kjo është një ndër rrëfenjat e shumta që tregohen rreth profetit të Zotit, Sulejmanit alejhi selam. Siç dihet, ai gëzonte aftësinë për të komunikuar me gjallesat e tjera.

Thuhet se një ditë Sulejmani a.s qëndronte ulur në breg të liqenit. Në një moment ai sheh një milingonë me një kokër gruri duke e transportuar drejt liqenit. Me të mbërritur në breg, del një bretkosë e cila hap gojën ku hyn milingona. Mandej, bretkosa zhytet në ujë, ndërkohë që Sulejmani zhytet në mendime të çuditur nga ajo që i panë sytë. Më vonë, bretkosa doli sërish në breg, hapi gojën dhe milingona kërceu jashtë, por pa kokrrën e grurit.

Sulejmani a.s i thirri dhe e pyeti kush ishte, ku kishte vajtur dhe çfarë kishte bërë. Milingona iu kthye: "O profet i Zotit! Në thellësitë e këtij liqeni që të shohin sytë, gjendet një shkëmb, e brenda tij një zgavër boshe. Në këtë zgavër, jeton një krimb i verbër të cilin Zoti e ka krijuar në atë vend. Ai e ka të pamundur të dalë jashtë e të kërkojë ushqim. Prandaj, Zoti më ka ngarkuar mua ta furnizoj me ushqim. Është bretkosa ajo që më mban në gojën e saj, ku nuk më prek uji. Ajo më çon tek shkëmbi, hap gojën tek zgavra dhe unë i çoj krimbit kokrrën e grurit. Mandej, hyj sërish në gojën e bretkosës dhe ajo më nxjerr në breg."

Sulejmani alejhi selam e pyeti: "A ke dëgjuar prej tij ndonjë lutje të veçantë?"

Milingona i tha: "Po. E kam dëgjuar të thotë: "O Ti që nuk më harron me rizkun Tënd në zgavrën e këtij shkëmbi, brenda ujit të liqenit! Mos i privo as robërit e Tu besimtarë nga mirësitë e Tua të pafund!"

Prandaj njeriu duhet ta kërkojë rizkun dhe të mos demoralizohet nëse vonohet. Zoti që e ka krijuar njeriun, e di më mirë se çfarë është më e dobishme për të.



## Një tregim i bukur me engjullin e vdekjes!



### Tregohet se Allahu e pyeti melekun e vdekjes:

A ke qarë ndonjëherë kur ua ke marre shpirtin bijve të Ademit? Ai tha po, një herë kam qeshur, një herë kam qajtur dhe një herë jam friguar!

**Tha Allahu:** po cili ishte rasti kur ke qeshur? Meleku i Vdekjes: kam qeshur me një person të cilit i shkova të ia marr shpirtin e ai kishte qëlluar tek këpuctari dhe i thoshte këpuctarit: “Rregullomi këpucet që të me çojnë edhe një vit, kurse unë duke qeshur ia mora shpirtin duke mos e lejuar që t’i përdorë asnjëherë”.

**Tha Allahu:** po kur ke qajhtë?

**Tha:** Kam qajtur kur shkova të ia marr shpirtin një gruaje e cila kishte foshnjen e saj në krahë dhe ishte në shkretëtirë, ku nuk ishte askush. E prita ta lëshojë foshnjen në tokë dhe ia mora shpirtin duke qajtur dhe duke e lënë edhe fëmijën duke qajhtë.

**Tha Allahu:** po kur je friguar?

**Tha meleku:** Jam friguar kur shkova të ia marr një dijetarit shpirtin e nga shtëpia e tij dilte dritë e cila më kthente dhe më frigonte, gjithashtu, kur iu afrova dilte dritë nga ai, e kështu ia mora shpirtin.

**Allahu tha:** A e din ti, se kush ka qene ai dijetar që ia ke marrë shpirtin?

**Tha: Jo !**

**Tha Allahu:** Ai ka qenë fëmija i cili të ka bërë të qash kur ia more shpirtin nënës së tij në shkretëtirë, pastaj Unë u kujdesa për këtë fëmijë derisa u rrit dhe e mbaroi jetën e tij...

## Përgojimi – thashethemet



Një herë, një grua e kishte përgojuar fqinjin e saj. Për disa ditë fjalët e saj i dëgjoi i gjithë qyteti. Fqinji i saj u shqetësua shumë nga veprimi i saj, por nuk kishte çka të bënte.

Kaloi një kohë dhe gruaja e kuptoi se fjalët që i kishte përhapur ishin krejtësisht të pavërteta. E penduar për atë që kishte bërë, shkoi tek një dijetarë për të kërkuar këshillë që ta rregulloj gabimin e bërë.

"Shko në treg", i tha dijetari. "Bleje një pulë. There atë. Shpuploje, dhe puplat, një nga një, hedhi rrugës deri tek shtëpia jote".

Edhe pse e befasuar nga këshilla e dijetarit, gruaja veproi ashtu siç i tha ai. Të nesërmen ajo shkoi përsëri te dijetari.

Ai tani i dha një detyrë tjetër: "Tani kthehu mbrapa, mbledhi të gjitha puplat që i ke hedhur në rrugë dhe mi sjell ato që i ke mbledhur".

Gruaja shkoi në të njëjtë rrugë, të mbledh sa më shumë pendla, por fatkeqësisht, era i kishte bartur të gjitha. Pas disa orë kërkimi, ajo arriti t'i mbledhë vetëm tri pendla.

"A e sheh", tha dijetari. "Sa lehtë është që t'i hedhësh ato, por sa vështirë është që t'i mbledhësh përsëri. Kështu është edhe përgojimi dhe thashethemet. Nuk të nevojitet mund i madh t'i përhapësh ato, por kur e bënë, atëherë kurrë nuk mund ta rregullosh dëmin e bërë.

## Pikë për pike



Një nga studentët e hadithit vdiste me mall për kërkimin e dijes. Ai do të ulej aty ku mblidheshin dijetarët dhe do të mësonte prej tyre.

Kur kaloi një kohë, ai ndjeu se nuk kishte sukses, pasi nuk mundi të fitoj dituri. Kështu ai r arsyetonte me vete: "Unë nuk jam i denjë për këtë dituri."

Ai e tha këtë duke menduar se nuk kishte kapacitet dhe se nuk ishte i kualifikuar për kërkim të dijes.

Pasi kishte lënë sferën e dijes, një ditë kaloi tek një shkëmb në të cilën uji po e pikonte, rënie pikë për pikë . Pikimi i vazhdueshëm i ujit (me vite) e kishte dëmtuar shkëmbin në një pikë ku kishte bërë një vrimë në të. Njeri qëndroi atje për një kohë, duke e shqyrtuar dhe reflektuar, dhe mendoi, "Ky ujë, pavarësisht nga butësia e tij kishte një efekt mbi këtë shkëmb të vështirë. Mendja dhe zemra ime me siguri nuk janë më të fort sa ky shkëmb dhe as dituria më e butë se sa ky ujë. "

(Kjo i bëri një përshtypje të thellë dhe) ai ishte i vendosur për t'u kthyer mbrapa duke e kërkuar diturinë, të cilën e bëri dhe shkëlqeu në të.

FUNDI

I

PJESËS

SË

PËRE

VËZHDOJM NË PJESËN E DYTË



**TË DREJTAT E REZERVUARA**  
**Vetëm për [www.islamieshtedrit.com](http://www.islamieshtedrit.com)**